Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja

Viti i 85-të i botimit
Maj 2017/ Nr. 5

TETE VJET SHQIPËRIA NË NATO

Shqipëria është prezente në të gjitha misionet NATO-s

VJENË, DOSKOZIL-KODHELI

Nënshkruhet Plani Bilateral i Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes



"Saber Junction 17"

Forca Ajrore në stërvitjen e parë ndërkombëtare

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja

Botues:
Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:
http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja

REVISTA MBROJTJA
Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 85-të i botimit
Nr. 5/ 2017

© Ministria e Mbrojtjes
Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimi, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.



Përmbajtja

Numri 5

"SABER JUNCTION 17"

10 Forca Ajrore në stërvitjen e parë ndërkombëtare

DELIA DHE HOXHA

15 Ata e merituan plotësisht titullin "Dëshmor i Atdheut"

"AMARCORD

16 Rama përkujton 66 vjetorin e Aviacionit luftarak

CEREMONIA

31 65-vjetori i krijimit të Radiozbulimit Ushtarak

REPORTAZH NGA BRIGJET E JONIT

44 Fuqia akademike e diturisë në Akademinë e Forcave të Armatosura

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI
Saimir ALIJA

Redaktore korrektore:
Anila DODA


Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ



4 **KODHELI NË VJENË**

Doskozil-Kodheli: Nënshkruhet Plani Bilateral i Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli zhvilloi më 7 prill 2017, një vizitë zyrtare në Austri, me ftesë të ministrit...



6 **KODHELI -JOHN MCCAIN**

Senatori McCain në Tiranë, takime me ushtarakë

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe ambasadori Donald Lu pritën ditën e premte, më 14 prill 2017, në aeroportin...



8 **66 VJET AVIACION USHTARAK SHQIPTAR**

Forca, që ka qiellin fushën e saj të operimit

Forca Ajrore Shqiptare u krijua më 24 prill 1951. Në ditën e 66-vjetorit të krijimit të saj, realizuam me komandantin...



23 **GAZMEND ÇAÇI**

"Qytetar Nderi" i Përmetit

Ish lojtari i Ekipit Kombëtar të Basketbollit, Mjeshtri i Merituar i Sportit, Gazmend Çaçi, aktualisht Shef i Sektorit të Aktiviteteve, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ka marrë...

Doskozil-Kodheli: Nënshkruhet Plani Bilateral i Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli zhvilloi më 7 prill 2017, një vizitë zyrtare në Austri, me ftesë të ministrit Federal të Mbrojtjes dhe Sporteve të Austrisë, z. Hans Peter Doskozil.

Ministrja Kodheli nuk e fshehu kënaqësinë për vizitën në Vjenë dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Austria ka dhënë historikisht për vendin tonë, që nga shpallja e pavarësisë, deri në procesin e integrimit evropian.

> Ministrja Kodheli e cilësoi Austrinë si një partner të veçantë të NATO, dhe e falënderoi homologun Doskozil për rolin e vendit të tij në Kosovë, në kuadër të misionit të KFOR.

Në qendër të takimit mes dy ministrave ishte bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes, për të cilin u nënshkrua dhe Plani Bilateral i Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes mes Shqipërisë dhe Austrisë për vitin 2017, i cili parashikon forcimin e bashkëpunimit dypalësh në trajnim dhe arsimim.

Ministrja Kodheli e cilësoi Austrinë si një partner të veçantë të NATO, dhe e falënderoi homologun Doskozil për rolin e vendit të tij në Kosovë, në kuadër të misionit të KFOR.

Pjesë e bisedës ishin dhe sfidat e sigurisë gjatë viteve të fundit, siç është kriza e refugjatëve, për të cilën ministrja Kodheli tha se "Shqipëria nuk është përfshirë masivisht në rrugët e kalimit të refugjatëve drejt Evropës Qendrore, por ne jemi të gatshëm për të ndihmuar. Dhe po ndihmojmë."- tha ajo, duke përmendur pjesëmarrjen e vendit tonë në operacionin e NATO në detin Egje, me qëllim parandalimin e fluksit të emigracionit të paligjshëm, me anijen "Oriku", e cila jo më larg se dje e bëri këtë gjë me një gomone me 60 persona në bord.

Pas takimit tête-à-tête dhe të dy delegacioneve, dy ministrat iu përgjigjën edhe interesimit të



mediave, jo vetëm për çështjet e sigurisë në rajonin e Ballkanit, por edhe më gjerë.

Ministrja Kodheli dënoi ato që ajo i quajti "provokime në kufijtë e një shteti të pavarur si Republika e Kosovës", duke theksuar qëndrimin e Shqipërisë për këtë çështje, si një vend anëtar i NATO.

E pyetur për zhvillimet më të fundit sa i përket krizës në Siri, ministrja Kodheli dënoi me forcë përdorimin e armëve kimike, të cilat siç tha ajo, "janë një problem shqetësues për të gjithë, pavarësisht se ku përdoren, si një armë rreptësisht e ndaluar nga të gjitha konventat e Kombeve të Bashkuara."

Gjatë vizitës së saj në Vjenë, ministrja Kodheli u prit në një takim edhe nga sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, OSBE, z. Lamberto Zannier, me të cilin diskutoi për zhvillimet aktuale politike në vendin tonë.





SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I OSBE TAKON KODHELIN:

Lamberto Zannier: OSBE mbështet reformat e nisura

Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së, Lamberto Zannier, u takua me ministren e Mbrojtjes së Shqipërisë, Mimi Kodheli, më 7 prill 2017, gjatë vizitës së saj dypalëshe në Austri.

Sekretari i Përgjithshëm dhe ministrja shkëmbyen pikëpamje për zhvillimet aktuale në Shqipëri dhe më gjerë në rajon, si dhe diskutuan për bashkëpunimin e Shqipërisë me OSBE-në.

Zannier ripohoi mbështetjen e fortë të OSBE-së për reformat e nisura në Shqipëri dhe gatishmërinë e Organizatës për të vijuar të ndihmojë procesin zgjedhor në vend, ndër të tjera edhe përmes vëzhgimit të zgjedhjeve të ardhshme kuvendore.

Sekretari i Përgjithshëm solli ndër mend kontributin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për shkatërrimin në mënyrë të sigurt të municioneve konvencionale të tepërta dhe lëndëve kimike të rrezikshme në vend dhe shkëmbeu pikëpamje me ministren për sfidat transnacionale, përfshirë sigurinë kibernetike, dhe për mënyrat se si mund të ndihmojë OSBE-ja në trajtimin e tyre.



Kodheli pret senatorin John McCain

Senatori McCain në Tiranë, takime me ushtarakë

Senatori McCain u takua me personelin ushtarak shqiptar të trajnuar në programe të ndryshme të qeverisë amerikane.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe ambasadori Donald Lu pritën ditën e premte, më 14 prill 2017, në aeroportin "Nënë Tereza", senatorin dhe ish-kandidatin për president të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, John McCain cili është takuar më pas me personalitetet zyrtare më të larta në vend si me Presidentin dhe Komandantin e Pergjithshëm të Forcave të Armatosura Bujar Nishani, kryeministrin Edi Rama, kryetarin e Kuvendit Ilir Meta dhe kreun e opozitës, Lulzim Basha.

Gjatë qëndrimit të senatorit McCain në Rinas, ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli e njohu me progresin e arritur në fushën e mbrojtjes dhe angazhimin e vendit tonë për të vijuar në këtë drejtim, të bindur





se jemi në rrugën e duhur.Senatori McCain u takua edhe me personelin ushtarak shqiptar të trajnuar në programe të ndryshme të qeverisë amerikane. Gjatë bashkëbisedimit të tyre, ministrja e Mbrojtjes risolli në vëmendje edhe njëherë misionet ku Forcat e Armatosura të Shqipërisë janë përfshirë duke nisur nga misioni në detin Egje, deri tek misionet në Afganistan dhe vijoi më tej me stërvitjet e përbashkëta me aleatët. Gjithashtu ministrja Kodheli u ndal edhe te kontributi i vendit tonë si pjesë e koalicionit global kundër ISIS, kontribut të cilin ministrja Kodheli e cilësoi të duhur dhe të drejtë. Shqipëria jep kontributin e saj në misionin paqeruajtës Resolute Support në Afganistan dhe ishte ndër vendet e para që iu bashkua koalicionit ndërkombëtar kundër ISIS, nën lidershipin e SHBA dhe jep një kontribut aktiv në këtë koalicion.

Për takimin me kryeministrin Rama, ky i fundit shkruan në Facebook "120minuta të paharrueshme me një mik të madh të shqiptarëve dhe një mbështetës besnik të Shqipërisë në rrugën e reformave që bëjnë shtet".

Në takimin në presidencë, PresidentiNishani, ka vënë në dukje se Shqipëria do të vazhdojë të japë kontributet e të përmbushë përgjegjësitë e saj ushtarake dhe financiare në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, bëjnë me dije burime zyrtare të zyrës së shtypit pranë Presidencës. "Jemi krenarë që jemi aleatë besnikë, të denjë e të sinqertë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga mbështetja e të cilave frymëzohemi edhe për lirinë e demokracinë tonë", theksoi Presidenti Nishani, duke e siguruar Senatorin McCain se vendi ynë dhe Forcat e Armatosura shqiptare do të vazhdojnë ta luajnë këtë rol edhe në të ardhmen.Kreu i Shtetit shqiptar dhe Senatori McCain diskutuan edhe për situatën e Ballkanit, ku u vlerësua roli dhe kontributi i Shqipërisë dhe kombit shqiptar për konsolidimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, paqes dhe stabilitetit të përbashkët me orientimin dhe synimin e integrimit e të gjithë vendeve dhe popujve në rajon në bashkësinë euroatlantike.

Në takimin e tyre, Kryetari i Kuvendit Meta dhe Senatori McCain ndanë bindjen e përbashkët se Shqipëria si anëtare e NATO-s dhe aleate besnike e SHBA duhet të rrisë kontributin e saj buxhetor në fushën e mbrojtjes, duke nënvizuar se investimi në fushën e sigurisë dhe kontrollit të kufijve ndihmon forcimin e stabilitetit dhe klimën e investimeve ekonomike në rajonin e Ballkanit.

Podgoricë: Rama-Markoviç

Rama: Mali i Zi në NATO një arritje historike

Më 3 prill2017, Kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë zyrtare në Malin e Zi, ku u takua me homologun e tij malazesDushko Markoviç. Në konferencën e përbashkët per shtyp, kryeministri Rama vlerësoi faktin që Mali i Zi do të jetë antari i 29-të i NATO-s, me një domethënie të rëndësishme për Malin e Zi, rritjen e sigurinë ne rajon por edhe per vete strategjine e NATO-s. Nga ana e tij kryeministri i Malit të Zi vlerësoi rolin dhe mbeshtetjen e Shqipërisë për antarësimin e Malit të Zi në NATO. "Fqinji ynë i shtrenjtë, Mali i Zi, deklaroi në Podgoricë kryeministri Edi Rama, do të bëhet anëtari i 29-të i NATO-s. Është një arritje për të cilën Shqipëria ka bërë gjithçka ka mundur në mbështetje të Malit të Zi. Është një arritje historike jo vetëm për Malin e Zi, por për vetë rajonin tonë. Me futjen e Malit të Zi në NATO, e gjithë vija bregdetare e këtij krahu të Jonit dhe Adriatikut është zonë e NATO-s".



Kryeministri Rama është ndalur edhe në rolin e shqiptarëve në Mal të Zi. "Jam shumë i inkurajuar për faktin se miku ynë dhe Kryeministri i Malit të Zi, sëbashku me forcat e tjera të këtij koalicioni qeverisës i ka dhënë një shtytje serioze përpara marrëdhënieve me shqiptarët këtu në Malin e Zi, në drejtim të përmbushjes së të drejtave të tyre legjitime të përfaqësimit, të drejtave administrative, ekonomike, kulturore, si dhe një përfshirje edhe më të mirë të tyre në shoqëri. Ne jo vetëm e kemi mirëpritur marrëveshjen e arritur ndërmjet partive të koalicionit qeverisës dhe veçanërisht, marrëveshjes me faktorin politik shqiptar, por kemi bindjen se inkurajimi i mëtejshëm i kësaj marrëdhënieje është edhe një faktor shumë i rëndësishëm stabiliteti për Malin e Zi. Ashtu sikundër i jemi mirënjohës, pasi ky është një diskutim që e kemi çelur prej disa kohësh, gjatë vizitës time të parë këtu në Podgoricë, lidhur me hapat e marra deri tani për marrëveshje të gjerë e me afate konkrete dhe dialogun demokratik me faktorin shqiptar, duke patur parasysh miratimin e planit hapësinor të Komunës së Ulqinit dhe miratimin e ndryshimeve, plotësimeve, për të organizuar territorin në funksion të hapjes së rrugës së krijimit të Komunës së Tuzit, si komunë e pavarur. Shumë faleminderit për këtë ndjeshmëri".

"Të jeni të bindur që shqiptarët e kuptojnë këtë ndjeshmëri, edhe si një detyrim për të qenë kontribuues të fuqishëm në rrugën e Malit të Zi si anëtar i NATO-s dhe drejt integrimit të plotë në Bashkimin Europian", deklaroi Rama.

Rama tha se "kemi vendosur të organizojmë mbledhjen e përbashkët të dy qeverive në Shkodër në muajin tetor, si fillimin e një cikli të ri marrëdhëniesh dhe e një përpjekjeje të re për të intensifikuar marrëdhëniet, në funksion të përmirësimit të jetës ekonomike dhe sociale të qytetarëve tanë, duke shfrytëzuar potencialet e përbashkëta që janë të mëdha dhe posaçërisht, duke i dhënë gjithë kësaj hapësire ndërkufitare një vëmendje më të madhe, të përbashkët, në funksion të rritjes ekonomike dhe cilësisë së jetës shoqërore. Nuk ka diskutim se ne mbetemi fqinj të dashur dhe të afërt me njëri-tjetrin dhe se rruga jonë e përcaktuar qartë, për të qenë krahpërkrah në koalicion e shteteve të botës së lirë demokratike, është një rrugë pa kthim, ku ne jemi të vendosur të çojmë përpara këtë marrëdhënie që është strategjike, në funksion të ardhmërisë së fëmijëve këtu në Malin e Zi dhe pak më tutje, në Shqipëri".

Kurse Kryeministri malazez Dushko Markoviç duke falënderuar Ramën për mbështetjen e Shqipërisë në rrugën euro-atlantike të vendit, tha se "Nuk ka çështje të hapura mes Malit të Zi dhe Shqipërisë. Do të mbajmë mbledhjen e përbashkët të qeverive në tetor. Dy vendet tona gëzojnë marrëdhënie të mira. Ne i përkasim botës së vendeve të lira".

TETE vjet Shqipëria në NATO

Shqipëria është prezente në të gjitha misionet NATO-s

"20% e Forcës sonë të Armatosur ka qenë në terren jashtë kufijve tanë"

Me rastin e 8-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe ai i Punëve të Jashtme z. Ditmir Bushati zhvilluan më 4 prill 2017, një bashkëbisedim me studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës.

Në fjalën e saj ministrja Kodheli solli në vëmendje punën e Forcave të Armatosura, puna e përditshme e të cilave siç tha ajo, jo domosdoshmërisht ndihet siç ndihen shërbimet e tjera që shteti sjell. Ajo përmendi praninë e Forcave të Armatosura pranë qytetarëve brenda vendit, por theksin e vuri te pjesëmarrja në misionet ndërkombëtare që rrjedhin si detyrim i të qenit vend anëtar i NATO. "20% e Forcës sonë të Armatosur ka qenë në terren jashtë kufijve. Shqipëria është prezent në të gjitha misionet NATO, ka dyfishuar prezencën e saj në Afganistan, ka dyfishuar prezencën e saj në KFOR në Kosovë, është prezent në misionin e NATO në detin Egje, ku për herë të parë Shqipëria merr pjesë në një mision detar dhe është prezent në të gjitha strukturat komandë të NATO, kudo ku NATO me strukturat e saj është prezent." - tha ministrja Kodheli.

Edhe ministri Bushati vlerësoi pjesëmarrjen e Shqipërisë në misionet e NATO gjatë këtyre viteve, por edhe kontributin e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit. "Shqipëria është një vend që ka marrë vlerësime të larta përsa i përket jo thjesht disponimit politik, por edhe disponimit konkret, me kontribute konkrete në luftën kundër terrorizmit dhe pavarësisht se një gjë e tillë është bërë brenda apo jashtë kornizës së NATO, në çdo lloj rrethane është bërë me partnerë kryesorë, që janë anëtarë kryesorë në Aleancë, çka në një farë mënyre apo në një tjetër, përllogaritet si kontribut që bën një vend në luftën kundër terrorizmit." - u shpreh z. Bushati, i cili vlerësoi punën e Forcave tona të



Armatosura edhe në operacione apo probleme që në vendet e tjera zgjidhen nga komuniteti.

Në këtë kuadër, ministrja Kodheli foli edhe për kontributin e vendit tonë në koalicionin global kundër Daesh, ose të ashtuquajturit Shtet Islamik, ku përmendi ndihmën konkrete të vendit tonë me armatim për luftëtarët kurdë, e cila sipas saj përcaktoi fatet e betejës për Mosulin. Pjesë e bisedës ishte edhe buxheti i Mbrojtjes, për të cilën ministrja Kodheli tha se Shqipëria është në nivelin mesatar të vendeve të tjera të NATO, por në rrugën e duhur për ta arritur detyrimin prej 2%.

Gjithashtu, ministrja Kodheli përfitoi nga rasti të ftojë studentët për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura dhe bashkë me ministrin Bushati iu përgjigjën pyetjeve të tyre, që kishin të bënin kryesisht me rolin e Forcave tona të Armatosura përkrah vendeve të tjera të NATO dhe me politikën e jashtme të Shqipërisë. Në takim morën pjesë edhe disa pjesëtarë të Forcave tona të Armatosura, pjesëmarrës në misione ndërkombëtare, të cilët treguan përvojën e tyre në këto misione dhe ndjesinë e të qenit pjesë e FA shqiptare.

Shqipëria, tani një vënd që prodhon siguri

Presidenti Bujar Nishani ka uruar 8-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, ku shprehet se nga një vend i konsumimit të sigurisë, vendi ynë tashmë është prodhues i sigurisë.

"Tetë vite më parë, Shqipëria arriti të bëhej me meritë pjesë e Aleancës më të madhe politike-ushtarake që ka njohur njerëzimi, duke u shndërruar në saje të reformave të ndërmarra, edhe të mbështetjes së pakursyer të aleatëve tanë, veçanërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga një vend konsumues të sigurisë, në një vend që jo vetëm prodhon siguri, por jep kontributin e vet të qenësishëm në ruajtjen, lartësimin dhe promovimin e vlerave dhe parimeve botërore të hapësirës së lirisë e demokracisë anembanë botës", thuhet në mesazhin e Nishanit.



Për kreun e shtetit, anëtarësimi i Shqipërisë në NATO në 2009 është arritja më e madhe historike "dhe merita e suksesi u takon të gjithëve që kontribuuan e vazhdojnë të kontribuojnë me dinjitet, duke bërë që flamuri kuq e zi të valëvitet krenar në Bosnje dhe Hercegovinë, Irak, Afganistan kudo ku trupat paqeruajtëse dhe misionet e Aleancës shërbejnë me profesionalizëm e përkushtim".

"Saber Junction 17"

Forca Ajrore në stërvitjen e parë ndërkombëtare

Ekuipazhi i një helikopteri "Cougar" i Forcës Ajrore merr pjesë në stërvitjen shumëkombëshe "Saber Junction 17", Gjermani

Të hënën paradite, datë 24 prill 2017, u përcoll drejt Gjermanisë ekuipazhi i një helikopteri "Cougar" të Forcës Ajrore për të marrë pjesë në stërvitjen shumëkombëshe "Saber Junction 17" e drejtuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në përcjelljen e pilotëve dhe teknikëve të bordit drejt të parës stërvitje jashtë vendit, e cila përkon me 66-vjetorin e krijimit të Forcës Ajrore, ishte e pranishme ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade Dedë Prenga, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantë të forcave, atashe ushtarakë në vendin tonë dhe ish-pilotë.



Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, vlerësoi pjesëmarrjen e ekuipazhit shqiptar në këtë stërvitje ndërkombëtare, e cila, siç tha ai, "tregon rritjen dhe pjekurinë profesionale të ekuipazheve tona dhe përvetësimin nga ana e tyre të standardeve më të përparuara të Aleancës."

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli shprehu krenarinë për Forcat Ajrore që nga dita e krijimit e deri më sot, me nisjen e "shqiponjave tona 'Cougar' për të marrë pjesë për herë të parë në një stërvitje që do të zhvillohet jashtë kufijve të atdheut." Ministrja Kodheli uroi të gjithë pilotët dhe ish-pilotët për 66-vjetorin e krijimit të Forcës Ajrore të Shqipërisë dhe foli për misionet në të cilat do të marrë pjesë Forca Ajrore, duke falënderuar ata që bënë të mundur pjesëmarrjen e Shqipërisë në një mision të tillë. "Dua të shpreh vlerësimin tim më të lartë, respektin për përpjekjet, sakrificat, kurajën, djersën dhe gjakun e derdhur për suksesin e Forcës Ajrore në përmbushje të misionit dhe detyrave të ngarkuara. Prandaj sot shpreh mirënjohjen për të gjithë brezat e ushtarakëve, që kanë punuar apo vazhdojnë të punojnë me të njëjtin përkushtim, me të njëjtën sakrificë, më të njëjtin vetëmohim. Pilotët që do të fluturojnë drejt Gjermanisë, do të ngrihen për të kapur lartësi të reja suksesi e arritjesh, duke u bashkuar dhe marrë pjesë në dy stërvitje të rëndësishme, 'Saber Junction 17' dhe 'Combined Resolve VIII', me aleatët tanë strategjikë forcat amerikane, në kuadër të bashkëpunimit ushtarak dypalësh midis vendeve tona. Falënderoj Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit të Mbrojtjes dhe Atasheun e SHBA në Tiranë për realizimin e kësaj pjesëmarrje'", u shpreh Kodheli, e cila solli në vëmendje se pjesëmarrja e Forcës Ajrore në këto stërvitje jashtë vendit, vjen pas shtimit të pranisë dhe kontributit të Forcës Tokësore dhe asaj Detare në misionet ndërkombëtare. Pjesëmarrja në stërvitjen "Saber Junction 17" i shërben drejtpërdrejt përgatitjes në përmbushje të detyrimeve ndaj Aleancës, për të vendosur në të ardhmen, në gatishmëri të plotë dy helikopterë Cougar, për t'u bërë pjesë e operacioneve të NATO. Stërvitja shumëkombëshe "Saber Junction 17" zhvillohet në qendrat e përbashkëtatë trajnimit në Hohenfels dhe Grafenwoehr të Gjermanisë nga data 24 prill deri në 20 maj 2017.

FLORAN DELIA DHE DONALD HOXHA

Ata e merituan plotësisht titullin "Dëshmor i Atdheut"

Në mjediset e Bazës Ajrore Farkë, u zhvillua me 6 prill 2017, ceremonia e përkujtimit dhe nderimit të dy dëshmorëve të atdheut, kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, të cilët ranë 1 vit më parë në krye të detyrës. Të panishëm në ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Dedë Prenga, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade, Tonin Marku, Sekretari i Përgjithshëm Z. Arjan Kraja, komandantët e Forcave, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, Komandanti i Bazës Ajrore Farkë, Kolonel Kuto Hasani, kryetari i shoqatës së "Aviatorëve të Shqipërisë", z. Kujtim Serani, kryetari i shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit", gjeneral brigade ® z. Astrit Jaupi, familjarë të dëshmorëve, miq, kolegë dhe të afërm.

Ceremonia u hap nga komandanti Forcës Ajrore general brigade Vladimir Avdiaj, i cili ndër të tjera tha se: "ekuipazhi i përbërë nga Kapiten Floran Delia,Toger Donald Hoxha u nisën në fluturim me mision stërvitor ditën e 6 Prillit, por ky fluturim nuk do të ishtë i zakonshëm pasi ata nuk u kthyen më por u bashkuan përjetësisht me Dëshmorët e tjerë të Aviacionit Shqiptar".

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, në fjalën e saj e cilësoi këtë si një ditë të dhimbshme për të gjithë: bashkëpunëtorët, shokët dhe kolegët, miqtë dhe dashamirësit e Floranit dhe Donaldit, por siç tha ajo, "veçanërisht e vështirë sot është për familjarët, për prindërit, fëmijët, motrat,vëllezërit, bashkëshortet. Unë i bashkohem pikëllimit të dhimbjes së familjeve Delia dhe Hoxha. Nuk ka nderim dhe respekt, fjalë apo ceremoni të lehtësojë dhimbjen tuaj, por ne shpresojmë se zemrat tuaja mbushen me krenarinë



> Kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, ranë në krye të detyrës në mesditën e 6 prillit të vitit 2016 gjatë një misioni stërvitor në liqenin e Shkodrës

për ta dhe mirënjohjen tonë për atë që ata përfaqësonin dhe përfaqësojnë", u shpreh ajo.

Më tej, ministrja Kodheli vlerësoi profesionalizmin dhe sakrificat, jo vetem të dy dëshmorëve më të rinj, por të të gjithë aviacionit shqiptar. "Kapiten Floran Delia dhe Toger Donald Hoxha shkëlqyen në profesionalizmin, devocionin dhe pasionin e tyre, për të cilat ata u respektuan, vlerësuan dhe promovuan edhe për të cilën do të kujtohen në të ardhmen. Historia e suksesit të Forcës Ajrore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, është shkruar me sakrificat, përkushtimin dhe vetëmohimin e pilotëve dhe ushtarakëve të zotë. Pjesa më e madhe e juaja dhe këta dëshmorë, me sakrifica, aftësi dhe profesionalizëm kryen detyra të vështira, në shërbim të qytetarëve shqiptarë, në situata emergjente apo fatkeqësish, ditën apo natën", vijoi më tej ministrja Kodheli, e cila hodhi poshtë çdo dyshim për shpalljen dëshmorë të dy pilotëve.

Në 1-vjetorin e rënies së kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, salla kryesore e kësaj baze u pagëzua me emrin e dy dëshmorëve, ku ministrja Kodheli zhvilloi një bisedë me të afërmit e dëshmorëve. Kapiten Floran Delia dhe toger Donald Hoxha, ranë në krye të detyrës në mesditën e 6 prillit të vitit 2016 gjatë një misioni stërvitor në liqenin e Shkodrës, duke e çuar në 41 numrin e dëshmorëve të aviacionit shqiptar. Në njëjtën ditë në Kuçovë, në qytetin e lindjes, u zhvillua ceremonia përkujtimore për toger Donald Hoxha, ku u vendosën buqeta me lule pranë bustit të Dëshmorit të Atdheut.

Rama përkujton 66 vjetorin e Aviacionit luftarak



Kryeministri Edi Rama ka përkujtuar më 24 prill në rubrikën e tij në Facebook, Amarcord, 66 vjetorin e e themelimit të Aviacionit luftarak.

"AMARCORD

Sot, forcat e armatosura shqiptare kremtojnë 66 vjetorin e themelimit të Aviacionit luftarak, premisat e të cilit ngjizën më 1914, kur në kohën e qeverisë së Princ Vidit, u porosit blerja e tre avionëve sulmues Löhner Daimler.Ndër vite është kurajo dhe energjia e pilotëve shqiptarë që e kthyen këtë armë në një njësi legjendare, si edhe heroizmi i 46 dëshmorëve të dalë prej saj. Nderim oficerëve dhe pilotëve, që në kushte mjerimi dhe izolimi gjatë diktaturës dhe fill pas saj, mirëmbajtën dhe riparuan me sa mundën instrumentat e sovranitetit tonë ajror, duke dhënë shpesh edhe jetën në krye të detyrës", shkruan kryeministri Rama.



Ndër vite është kurajo dhe energjia e pilotëve shqiptarë që e kthyen këtë armë në një njësi legjendare, si edhe heroizmi i 46 dëshmorëve të dalë prej saj.

Historia e Aviacionit Ushtarak, një histori jete njerëzore

Në datën 24 prill 2017, në ambientet e Garnizonit Rinas, u zhvillua ceremonia me rastin e kremtimit të 66 vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar, si dhe përcjelljes së helikopterit "Cougar", ekuipazhit fluturues dhe inxhiniero-teknik në stërvitjen "Suber Junction 17".

Në ceremoninë e rastit merrnin pjesë Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, Gjeneral brigade Dedë Prenga, komandantët e forcave, atashe ushtarake, drejtorë të drejtorive në SHPFA, përfaqësues së shoqatës "Familjet e Dëshmorëve të Aviacionit," përfaqësues të shoqatës të "Aviatorëve të Shqipërisë", veteranë, etj.

Në këtë 66 vjetor të Armës së Aviacionit një përshëndetje e veçantë iu bë të pranishmëve nga Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli. Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Ministrja Kodheli u u shpreh ndër të tjera: "Është nder dhe kënaqesi të marr pjesë në këtë ceremoni të 66 vjetorit të krijimit të Aviacionit Ushtarak Shqiptar. Dua të shpreh vlerësimin tim më të lartë, respektin për përpjekjet, sakrificat, kurajën, djersën

dhe gjakun e derdhur për suksesin e Forcës Ajrore në përmbushje të misionit dhe detyrave të ngarkuara. Prandaj sot shpreh mirënjohjen për të gjithë brezat e ushtarakëve, që kanë punuar apo vazhdojnë të punojnë me të njëjtin përkushtim, me të njëjtën sacrificë, më të njëjtin vetëmohim".

Në fjalën e rastit, Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj theksoi se: "Historia e Aviacionit Ushatarak Shqiptar, nuk u shkrua vetëm me përkushtim mund dhe sakrifica por edhe me gjakun e dëshmorëve të shumtë të cilet dhanë jetën në krye të detyrës në moshën më të bukur" Një falenderim i veçantë shkoi për veteranët e Aviacionit të cilët hodhën themelet dhe bazat e forta në të cilat marim forcën dhe ven-



dosmërinë të rreshtohemi me dinjitet përkrah ushtrive të NATO-s. "E kemi zgjedhur këtë ditë të shënuar, vijoi në fjalën e tij gjeneral Avdiaj, për të përcjellë në Gjermani një nga helikopterët tanë "Cougar", ku bashkë me ekuipazhin fluturues dhe atë inxhinierë teknik do të marrin pjesë në stërvitjen shumëkombëshe "Saber Junction 17". Në përfundim të fjalës së tij Gjeneral Avdiaj i uroi suksese në stërvitje ekuipazhit si dhe mbarësi dhe shëndet dhe lumturi gjithë veteranëve, personelit ushtark dhe civil të Forcës Ajrore.

Aviacioni u krijua duke përmbushur aspiratat e të gjithë ushtarakëve, rruga e suksesit nisi më një avion në Laprakë dhe vijoji me krijimin e Regjimentit të Kuçovës. Në këtë 66 vjetor vleresoj përpjekjet kurajon, djersën gjatë përmbushjes së misionit , mirënjohje për brezat dhe falenderim për lidershipin ndër vite. Në përfundim të fjalës të saj Ministrja e Mbrojtjes, uroi gëzuar 66 vjetorin gjithë ushtarakëve civilëve që kanë shërbyer në Aviacionin Ushtarak Shqiptar, si dhe fluturim të mbarë ekuipazhit të helikopterit "Cougar". Në emër të shoqatës së "Aviatorëve të Shqipërisë", përshëndeti kryetari i kësaj Shoqate, gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, ish-komandanti i Forcës Ajrore dhe ish-pilot i mirënjohur i Armës së Aviacionit. Në përfundim të ceremonisë u bë një foto e përbashkët me efektivat pjesëmarrës në stërvitje, si dhe u përshëndet nisja e helikopterit për në stërvitje.

KOMANDA E FORCËS AJRORE

Forca Ajrore amerikane trajnon personelin logjistik të FA

Nga datat 18-20 prill 2017, në Komandën e Forcës Ajrore u zhvillua trajnimi nga një ekip i Forcës Ajrore amerikane nga Baza Ajrore Ramstein, Gjermani me specialistë të logjistikës nga Forca Ajrore dhe Komanda Mbështetëse. Ekipi amerikan u prit nga komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, i cili vlerësoi bashkëpunimin dypalësh dhe asistencën që pala amerikane jep në fushën e logjistikës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte familjarizimi i pjesëmarrësve për përgatitjen e paletave dhe dokumentacionin e nevojshëm më qëllim përdorimin sa më eficent të programeve të transportit (ngarkim - shkarkim) dhe mirëmbajtjes së materialeve logjistike për reduktimin e varësisë nga transporti tregtar për mbështetje me transport ajror. Nga pala amerikane gjatë këtyre ditëve u brifua mbi: sistemet software të përdorura për rritjen e eficencës për transportin ajror, SOP dhe udhëzimet për zhvillimin e procedurave të transportit ajror si dhe familjarizimin me avionët C-17, C-130 dhe C-5 e specifikat në lidhje me ngarkesat e tyre. Po ashtu gjatë këtij trajnimi u zhvilluan dhe veprime praktike mbi mënyrën e paketimit të materialeve logjistike dhe transportin e tyre me avionë ushtarakë mallrash. Ky aktivitet trajnues ndihmon në përmirësimin e mëtejshëm të praktikave më të mira të personelit logjistik të Forcës Ajrore në përputhje me standardet e NATO-s.



66 vjet Aviacion Ushtarak

Forca, që ka qiellin fushën e saj të operimit





Intervistë me gjeneralbrigade Vladimir Avdiaj, komandant i Forcës Ajrore

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Forca Ajrore Shqiptare u krijua më 24 prill 1951. Në ditën e 66-vjetorit të krijimit të saj, realizuam me komandantin e Forcës Ajrore, gjeneralbrigade Vladimir Avdiaj, këtë intervistë për Revistën "Mbrojtja".

Z. gjeneral, Aviacioni Ushtarak Shqiptar ka përvjetorin e tij të 66-të, si vjen Forca Ajrore shqiptare, që ju drejtoni, në këtë përvjetor?

Aviacioni Shqiptar është një armë e lavdishme, ku kanë derdhur djersën dhe mundin shumë ushtarakë të shquar të Ushtrisë Shqiptare. Në rrugën e gjatë 66 vjeçare të kësaj arme, kemi çfarë të kujtojmë dhe shumë të reflektojmë. Kjo rrugë e gjatë ka patur edhe vështirësitë e saj, të cilat me përkushtim, vendosmëri dhe profesionalizëm janë kaluar më së miri nga personeli pilot dhe ai inxhiniero-teknik që shërbeu ndër vite në këtë forcë. Forca Ajrore Shqiptare tashmë ka një histori të ndritur dhe emrat e personelit të tij janë të gdhendur në memorien e gjithsecilit prej nesh, për ndjenjën e lartë të profesionalizmit që i karakterizonte. Brezi i ri që tashmë është rreshtuar në radhët e Forcës Ajrore ka një lajtmotiv dhe themele me baza të sigurta për të ecur dhe çuar përpara atë eksperienë teknike dhe operacionale që na lanë trashëgim brezat e mëparshëm. Sot Forca Ajrore shqiptare rreshtohet denjësisht përkrah forcave të tjera ajrore, aleate në NATO. Implementimi i planeve të zhvillimit të Forcës Ajrore, ka bërë që si infrastruktura ashtu edhe teknika, të modernizohen duke na bërë të ndihemi pjesë integrale e aleancës. Ky modernizim në teknikë është shoqëruar edhe me trajnimin e personelit në shkollat prestigjoze. Tashmë Forca Ajrore shqiptare është një aset i çmuar kombëtar. Personeli i saj operon me të njëjtat standarde si forcat ajrore homologe në NATO.

Ju thatë se Forca Ajrore Shqiptare operon dhe fluturon me të njëjtat standarde si ushtritë e NATO-s, le t'i kthehemi dhe njëherë misionit dhe detyrave që ka kjo forcë. Kush janë konkretisht ato?

Misioni i Forcës Ajrore është sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për vëzhgimin dhe kontrollin e sovranitetit të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me NATO-n, mbështetjen në operacionet luftarake e joluftarake, HNS dhe ato të kërkim-shpëtimit SAR, si dhe realizimin e komandim-kontrollit të mjeteve ajrore në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Forca Ajrore ka për detyrë të paralajmërojë në kohë mbi rrezikun ajror mbi bazën e aseteve kombëtarë dhe të NATO-s. Ajo stërvit, pajis dhe mban në gatishmëri forcat, sistemet, pajisjet, mjetet dhe infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen e operacioneve luftarake dhe joluftarake. Monitoron vëzhgimin e hapësirës ajrore të RSH mbi bazën e sigurimit dhe integrimit të informacionit nga burime kombëtare



dhe NATO. Kontrollon hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me NATO dhe agjensinë e Albcontrol, nëpërmjet QKR (CRC) dhe përdorimit të kapaciteteve kombëtare dhe të NATO-s bazuar në Artikullin 5. Gjithashtu Forca Ajrore koordinon veprimet me Albcontrol. sha dhe NATO-s për realizimin e "policimit ajror" në hapësirën ajrore të RSH në kohë paqe sipas procedurave dhe rregullave të ICAO, Eurokontrollit dhe NATO.

Detyra të tjera janë edhe mbështetja e forcave e tjera në operacione luftarake, pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta humanitare në ndihmë të popullsisë (tërmete, përmbytje, zjarre, aksidente të rënda, bllokime rrugësh nga dëbora, ndihmë mjekësore, etj), kryerja e operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR) me interes kombëtar, policimit ajror dhe operacioneve të NATO në vendin tonë.

Forca Ajrore Shqiptare mbështet me shërbim meteorologjik aktivitetin e saj por edhe komandat dhe njësitë e tjera të Forcave të Armatosura, institucionet e tjera në RSH në kohë paqe, emergjenca të ndryshme si dhe në operacione luftarake. Po ashtu Forca Ajrore zhvillon kapacitetet operacionale të mundshme të saj për të kontribuar dhe përfituar nga përdorimi i aseteve të sistemit NATINAMDS-Sistemi i Integruar i Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s.

Z. gjeneral, cila është rruga e zhvillimit të kësaj Force, kush është objektivi kryesor i punës së personelit të Forcës Ajrore shqiptare?

Forca Ajrore Shqiptare, si strukturë e rëndësishme e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë kryen me rigorozitet dhe përkushtim të gjitha detyrat e ngarkuara që rrjedhin nga misioni i kësaj Force përcaktuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Kjo forcë me strukturat dhe repartet e saj është përpjekur me gjithë mundësitë, e në shumë raste ka kaluar dhe në caqet e pamundësisë për të realizuar në kohë dhe më së miri misionin e saj. Rruga e zhvillimit të kësaj Force ka qenë e gjatë dhe e mbushur me suksese dhe realizime.

Objektiv kryesor i punës së personelit të Forcës Ajrore shqiptare realizimi i misionit të kësaj force, menaxhimi, kualifikimi dhe trajnimi i personelit pilot, teknik, aeroshpëtues, kontrollor ajror, vrojtues meteorologjik, etj, rritja e shkallës së gatishmërisë operacionale, programimi i punës për përballimin e emergjencave civile, si dhe forcimi i shkallës së sigurisë dhe gatishmërisë në repartet e saj. Me prioritet nga Forca Ajrore Shqiptare është parë përgatitja e planeve dhe e programeve të ndryshme, duke patur si qëllim përgatitjen e personelit të aftë për të operuar me strukturat e NATO-s, hartimi i programeve të stërvitjes e modernizimit të kësaj force sipas standardeve të kërkuara me qëllim rritjen e nivelit operacional, si dhe bashkëpunimi dhe realizimi i stërvitjeve të përbashkëta.

Zhvillimi i stërvitjes ajrore me qëllim rritjen e profesionalizmit në punë kanë bërë që Forca Ajrore shqiptare të përmbushë me përgjegjësi detyrat e ngarkuara. Forca Ajrore merr pjesë në mbështetjen e stërvitjeve të përbashkëta me Forcat Tokësore, Forcat Detare dhe strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, në të cilat ka spikatur profesionalizmi dhe i përkushtimi i efektivave të saj. Gjithashtu edhe pjesëmarrja në Emergjencat Civile është një tregues kuptimplotë i humanizmit dhe profesionalizmit të këtij personeli. Vlen të përmenden këtu sa e sa misione ku helikopterët e Forcës Ajrore kanë marrë pjesë në emergjencat e përmbytjeve apo të izolimit nga dëbora, në fikjen e vatrave të zjarrit, në transportimin e të plagosurve gjatë aksidenteve të ndryshme, etj. Me kalimin e helikopterëve të Grupit të Transportit Mjeksor dhe të Sektorit të Helikopterëve të Repartit Special "Renea", në Forcën Ajrore, lista e detyrave themelore të saj është zgjeruar dhe është bërë edhe më specifike.

Modernizimi i Forcës Ajrore me helikopterë të tipit COUGAR dhe EC-145, janë një investim dhe angazhim për përmbushjen e standardeve të Forcës Ajrore. Bazuar në teknikën e re moderne dhe cilësitë e saj, ne synojmë rritjen e kapaciteteve operacionale për të qenë të aftë për zhvillimin e operacioneve luftarake e joluftarake në kondita të ndryshme të kohës dhe motit dhe të ndërveprueshme me ushtritë e aleancës.

Z. Avdiaj, Forca Ajrore, ka pasur një pasqyrim të gjerë të aktivitetit të saj, që dhe ju e përmendët më lart, në shtypin ushtarak por dhe jo vetëm. Mund të na flisni më konkretisht për strukturat përbërëse të forcës që ju drejtoni?

Baza Ajrore Farkë është aseti operacional i Forcës Ajrore, e cila mban peshën kryesore dhe luan rol të rëndësishëm në realizimin e misionit dhe detyrave të ngarkuara për Forcën Ajrore shqiptare. Kjo bazë kryen detyra dhe misione që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe detyra të tjera në mbështetje të Emergjencave Civile, apo edhe në mbështetje të agjensive të tjera shtetërore.

Baza Ajrore, Farkë, me kapacitetet e veta kryen mbështetjen me transport të mesëm të trupave, materialeve dhe evakuim shëndetësor në operacione luftarake dhe joluftarake, operacione humanitare dhe të shërbimit SAR si dhe detyra të tjera në interes të operacionit. Ajoka për detyrë që në bashkëveprim me strukturat e Forcës Ajrore dhe të forcave të tjera të Forcave të Armatosura të sigurojë mbështetjen ajrore në operacionet e përbashkëta. Në kuadër të realizimit të misionit të saj kjo bazë kryen detyra kryesore sic janë sigurimi i gatishmërinë luftarake të mjeteve fluturuese që ka në përdorim në përputhje me nivelet operacionale të përcaktuara, merr pjesë dhe mbështet stërvitjet e ndryshme "Joint" me Forcat e Armatosura, realizon transport të trupave dhe materialeve ushtarake në operacione

luftarake, transport VIP, mbështet dhe kryen operacionet humanitare në ndihmë të popullsisë (emergjencat civile dhe fatkeqësitë natyrore), ku përmbushja e këtyre e detyrave si luftarake dhe atyre stërvitore bëhet në përputhje me standardet e ICAO, Eurokontroll dhe NATO.

Baza Ajrore Farkë, kryen edhe detyra të zbulimit dhe rikonicionit me interes kombëtar dhe NATO në drejtim interesi, monitorim sipas situatave të kufirit detar dhe tokësor në interes të detyrave speciale si dhe interes të vendimmarrjeve të shpejta, zhvillon më vete ose në bashkëpunim me të tjerët operacionet e kërkim-shpëtimit,(SAR). Për vetë natyrën e operacioneve ku angazhohet personeli i kësaj baze, besoj se opinion i gjerë publik tashmë i di aftësitë operacionale dhe profesionale të tyre. Ata janë kudo dhe kurdo në ndihmë të njerëzve në nevojë. Përveç pjesëmarrjes dhe stërvitjes ushtarake dhe individuale të ekuipazheve fluturuese të kësaj baze, janë bërë të shpeshta edhe pjesëmarrjet në operacione SAR apo në ndihmë të popullsisë në raste të bllokimit të zonave nga dëbora apo edhe përmbytjeve. Modernizimi i Bazës Ajrore Farkë me teknikë perëndimore, ka ecur paralelisht edhe me trajnimin e ekuipazheve fluturuese dhe të mirëmbajtjes së këtyre helikopterëve në kompanitë dhe shkollat më me emër në fushën e fluturimeve.Është për tu vlerësuar përkushtimi dhe profesionalizmi që i karakterizon këto ekuipazhe, të cilët operojnë sipas standardeve të NATO-s, si dhe standardeve të Aviacionit Civil.



Pra, është Baza Ajrore e Farkës, janë pikërisht pilotët e kësaj njësie ata të cilët, me veprën e tyre, kanë bërë publikun të mbajë frymën në emergjencat civile sidomos të këtij dimri?

Baza Ajrore Farkë është repart i traditave për emergjencat. Kjo bazë, personifikohet edhe si reparti i emergjencave civile, pasi ka dhënë një kontribut të shquar në ndihmë të popullsisë në emergjencat civile, sa herë që në vend ka patur përmbytje, fatkeqësi natyrore, bllokim të zonave malore nga dëbora etj.Farka është një njësi që ka tradita të shquara në operacionet humanitare e emergjencat civile, të cilat kanë çuar në perfeksionimin dhe rritjen e aftësive profesionale të ekuipazheve fluturuese.

Në ditët më të vështira njerëzit në më të shumtën e rasteve i drejtojnë sytë nga qielli, ose për tiu lutur Zotit që gjithçka të shkojë sa më mirë, ose për të pritur ndonjë ndihmë që mund t'ju vijë nga "lart". Themi nga qielli pasi shpresa e tyre e vetme në këto situata të vështira është ndihma me anë të helikopterëve të Forcës Ajrore, të cilët qiellin e kanë fushën e tyre të operimit. Të mos flasim pastaj për transportimin e të sëmurëve i cili është misioni më i vështirë i pilotëve, pasi nga njëra anë është dëshira e mirë për të shpëtuar të sëmurin dhe nga ana tjetër vështirësia që i ofron terreni në ulje-ngritje, i ndërthurur ky me kapriçiot e motit, etj.Ata janë njerëz si gjithë të tjerët, por që ndryshe nga këta të tjerë, ata i karakterizon një zemërgjerësi dhe një shpirt i sakrificës. Kështu ndodh me ta në çdo mision apo emergjencë të shkaktuar në çdo krahinë të Shqipërisë për shkaqe nga më të ndryshmet.

Po t'i pyesësh ata se, pse janë kaq të gatshëm të rrezikojnë për të kryer me çdo kusht këto detyra të vështira, do të befasohesh tek të thonë me aq modesti se: "Misioni ynë është t'u vijmë në ndihmë njerëzve në nevojë", por ata vlerësojnë faktin se, janë të parët që duhet ta bëjnë një gjë të tillë, prandaj dhe motoja e Forcës Ajrore është: "MISIONI, ËSHTË I PARI".

Si është Gatishmëria Operacionale dhe Stërvitja e Forcës Ajrore, a jeni ju pjesëmarrës në stërvitjet e përbashkëta me vendet e aleancës?

Forca Ajrore kryen fluturime me misione operacionale, detyra speciale, si dhe fluturime me misione stërvitore për realizimin e stërvitjeve ajrore të planizuara në fillim të vitit, stërvitjeve të përbashkëta me strukturat e Forcave të Armatosura, stërvitjeve të përbashkëta me vendet partnere, si dhe mbështet me helikopter stërvitjet e strukturave të tjera të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Stërvitjet e përbashkëta me vendet e aleancës kanë qenë "Joint-Effort 2016" dhe "Albanian Lion 2016", por gjithashtu kemi pjesëmarrjen për herë të parë të Forcës Ajrore shqiptare me një helikopter COUGAR dhe personelin e saj pilot dhe mbështetës në dy stërvitje të NATO-s në Gjermani. Dhe pikërisht më datë 24 prill 2017, ditë që përkon me 66 vjetorin e krijimit të Aviacionit Shqiptar, Forca Ajrore dërgoi për herë të parë në një stërvitje shumëkombëshe e cila realizohet në kuadër të rritjes së ndërveprueshmërisë ndërmjet Forcave Aleate të NATO-s. Forca Ajrore është simbol i bashkëpunimit të frytshëm me aleatët Euro-Atlantikë, gjë kjo e vërtetuar edhe në stërvitje të përbashkëta ku ata kanë shfaqur dinjitet e profesionalizëm në realizimin e misioneve.

Pjesëmarrja e Forcës Ajrore në stërvitjet shumëkombëshe që përmendëm më lart, "Suber Junction 17" dhe "Combined Resolve VIII", do të shërbejë për aftësimin dhe shkëmbimin e ekperiencës ndërmjet vendeve të Aleancës për të qenë të gatshëm për përballimin e sfidave që na sjell koha. Këto stërvitje janë në funksion të përmbushjes së detyrimeve tona kushtetuese duke i aftësuar ekuipazhet tona fluturuese që të operojnë me të njëjtat standarde dhe manuale si Forcat e tjera Ajrore anëtare të NATO-s dhe duke u ndjerë të barabartë me ta.

Stërvitja "Saber Junction 17" dhe "Combined Resolve VIII" janë vetëm fillimi i pjesëmarrjes së Forcës Ajrore në stërvitjet e drejtuara nga NATO dhe SHBA. Me anë të pjesëmarrjes në këtë stërvitje synohet jo vetëm përmirësimi i aftësive profesionale ushtarake, por kjo është edhe një mundësi e mire për të promovuar bashkëpunimin dy dhe shumëpalësh, si dhe shkëmbimet kulturore midis vendeve. Stërvitje të tilla kontribuojnë në rritjen e ndërveprueshmërisë, zbatimit të procedurave standarde të Aleancës dhe përmirësimit e zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive operacionale në kryerjen e operacioneve luftarake në një mjedis të përbashkët dhe shumëkombësh. Me anë të pjesëmarrjes në këto stërvitje personeli fluturues dhe ai mbështetës, do të përfitojnë sa më shumë nga kjo mundësi që u jepet për të përmirësuar aftësitë teknike dhe profesionale me anë të përdorimit të procedurave dhe standardeve të Aleancës, por edhe uroj të japin më të mirën e mundshme, me angazhimin e tyre maksimal në realizimin e misioneve të caktuara.

Përveç stërvitjeve që përmenda më sipër, Forca Ajrore ka kryer edhe stërvitjet e përbashkëta në mbështetje të forcave të tjera dhe autonomet, sistërvitje komplekse në rajonet e Fekenit dhe Bizës, stërvitje kompaktësimi në rajonin Rreth-Greth, Kavajë, stërvitje humanitare dhe stërvitje komplekse në rajonet Zall Herrit dhe Feken,

stërvitje "DURRËSI SAREX " në Gjirin e Durrësit dhe stërvitja "IMPONIMI" në Gjirin e Vlorës.

Ju folët për pjesëmarrje në stërvitje të përbashkëta me vendet e Aleancës, por si është Forca Ajrore në raport me standardet e teknikës dhe të personelit të Aleancës?

Forca Ajrore Shqiptare disponon helikopterë modernë COUGAR (helikopterë të gjeneratës së IV), të konfigurimit transport trupash, SAR (Search And Rescue), dhe MEDEVAC (Medical Evacuation). Në zbatim të projektit të modernizimit të flotës ajrore shqiptare me helikopterë COUGAR, është zbatuar edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar, Francën dhe Turqinë për trajnimin e personelit pilot, teknik dhe shfrytëzues të këtij helikopteri. Rezultat i këtyre marrëveshjeve janë realizimi i shumë programeve trajnuese ku përmendim: në Forcat e Armatosura Franceze është realizuar trajnimi i pilotëve për simulator, pranë kompanisë "Eurocopter" Francë u trajnuan pilotë dhe teknikë për helikopterin COUGAR, në kompaninë "FB Helioservice" në Mbretërinë e Bashkuar janë trajnuar gjithsej 12 pilotë për helikopterët shumëfunksionalë, 2 aeroshpëtues dhe 2 operatorë SAR.

Përveç Bazës Ajrore të Farkës?

Baza Ajrore Kuçovë është një tjetër strukturë në përbërje të Forcës Ajrore. Misioni i Bazës Ajrore Kuçovë, është që me kapacitetet e veta të kryejë trajnimin e personelit të Forcës Ajrore, të mbështesë me transport të trupave dhe materialeve, në operacione luftarake, joluftarake dhe humanitare. Gjithashtu kjo Bazë mbështet dhe krijimin e kapaciteteve aeroportuale për mbështetje HSN dhe policim ajror të RSH me NATO. Aktualisht Baza Ajrore e Kuçovës, përveç detyrave që burojnë nga misioni i saj, ka mbështetur me infrastrukturën e saj, realizimin e misioneve të ndryshme civile për avionë të enteve të ndryshme për uljen dhe operimin në këtë bazë.

Misioni i Policimit Ajror realizohet nën Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore Raketore të NATO-s. Si realizohet monitorimi i hapësirës ajrore shqiptare?

Qendra e Kontroll Raportimit në përbërje të Forcës Ajrore me kapacitetet e veta dhe të NATO-s, realizon dhe integron informacionin e vëzhgimit për krijimin e pikturës ajrore si dhe mbështet sigurimin e kushteve për kryerjen e funksioneve të QKR (CRC), si pjesë e sistemit NATINAMDS, policimit ajror, kryerjen e kontrollit të mjeteve ajrore. Detyrat që realizon kjo qendër janë: Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme operacionale me strukturën e C2 ajrore të NATO dhe sistemit NATINAMDS, mbështetja me komandim dhe drejtim të Forcës Ajrore në operacion, mbështetje në operacione të përbashkëta në kuadrin e Forcave të Armatosura, ato humanitare në ndihmë të popullsisë, mbështetje të operacioneve të kërkim-shpëtimit (SAR),si dhe drejtimin e mjeteve ajrore të forcës në stërvitje dhe operacione të ndryshme.

Aktualisht Qendra e Kontroll Raportimit është një strukturë kyçe në përbërje të Forcës Ajrore, e cila operon 7/7 dhe 24/24 dhe luan një rol shumë të rëndësishëm në kordinimin, ekzekutimin dhe komandim kontrollin e operacioneve ajrore. Funksionimi i kësaj qendre sipas parametrave dhe standardeve të NATO-s, përbën strukturën bazë të integrimit në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Mbrojtjes Raketore të Aleances (NATINAMDS).

Kjo strukturë realizon menaxhimin e të gjithë fluksit të informacionit ajror si nga burime kombëtare civile dhe ushtarake, ashtu edhe nga burimet ndërkombëtare/ rajonale. Në këtë kontekst theksoj faktin që menaxhimi i informacionit ajror që do të hyjë në këtë Qendër nëpërmjet rrjetev të sigurta dhe speciale, do të vijë nga burime të një teknologjie të lartë të CRC homologe. Nëpërmje ngritjes dhe funksionimit të Qendrës së Kontroll Raportimit, synohet ti jepet zgjidhje menaxhimit të rasteve të "Platformave Renagate", të cilat përbëjnë një problem serioz në kohët e sotme, si për strukturat politike vendimmarrëse, ashtu edhe ato ushtarake.

Statusi i Qendrës së Kontroll Raportimit si strukturë kombëtare ajrore dhe aset i rëndësishëm në zinxhirin e komandim-kontrollit ajror të Aleancës, i jep mundësinë të jetë një kontribuese e rëndësishme për planizimin dhe ekzekutimin operacioneve ajrore të Aleancës, realizimin e Policimit Ajror, shkëmbimin e pamjes ajrore dhe



kordinimin e të gjitha aktiviteteve ajrore në operacionet humanitare dhe në operacionet në Emergjencat Civile. Seriozitet është kushtuar edhe për përgatitjen dhe aftësimin e personelit të kësaj qendre të cilët janë trajnuar dhe çertifikuar sipas standardeve të NATO-s. Ata janë trajnuar në disa vende aleate të NATO-s dhe vazhdojnë të trajnohen me kurse afatshkurtra, me qëllim që ti përgjigjen teknologjisë moderne dhe sfidave të kohës.

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është një tjetër strukturë e Forcës që ju drejtoni, diçka më shumë se si operon kjo strukturë dhe sa e rëndësishme është ajo?

Shërbimi Meteorologjik Ushtarak është një tjetër aset i veçantë dhe me vlerë i Forcës Ajrore, i cili me kapacitetet e veta siguron informacion të nevojshëm të konditave meteorologjike për mbështetjen e operacioneve luftarake dhe joluftarake, humanitare dhe shërbimit SAR në interes të Forcave të Armatosura dhe të institucioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë. Me anë të këtij shërbimi realizohet marrja e informacionit të saktë mbi gjendjen dhe parashikimin e motit për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe parashikohen në kohë në bazë të metodave bashkëkohore fenomenet e rrezikshme atmosferike sipas standardeve ndërkombëtare dhe të NATO. Shërbimi Meteorologjik Ushtarak mbështet me informacion METEO operacionet e Forcave të Armatosura dhe trupave të vendeve aleate në rast nevoje brenda vendit, gjithashtu jep asistencë me të dhëna meteorologjike për sigurimin e fluturimeve ajrore, lundrimeve detare apo rastet e emergjencës civile. Aktualisht Shërbimi Meteorologjik Ushtarak, është strukturë e cila operon pa ndërprerje për realizimin e misionit të saj. Ajo aderon në OBM (Organizata Botërore e Meteorologjisë) dhe shkëmben informacion meteorologjik me strukturat kombëtare dhe ndërkombëtare. Është për tu përmendur në këtë rast edhe konferenca e organizuar vjeshtën e vitit të kaluar në kuadër të Oganizatës Botërore të Meteorologjisë, ku vendi ynë ishte vend organizator i kësaj konference. Informacioni METEO që jepet nga SHMU-ja, shfrytëzohet jo vetëm nga strukturat e njësitë ushtarake por edhe nga ente të tjera joushtarake.

Përkushtimi dhe profesionalizmi i personelit që shërben në këtë strukturë, e bën këtë shërbim të vlerësueshëm dhe të dobishëm edhe nga institucionet e tjera të vendit tonë.

Z. gjeneral, si është bashkëpunimi i Forcës Ajrore me institucionin e Albcontrol?

Forca Ajrore gjithmonë është karakterizuar nga fryma e bashkëpunimit me institucionet e tjera qofshin këto vendore apo lokale. Nisur edhe nga misioni që kjo Forcë realizon kanë ekzistuar marrëdhënie të ndërsjellta mirëkuptimi dhe bashkëpunimi midis Forcës Ajrore dhe Albcontrol. Në sajë të këtij bashkëpunimi me Albcontrol ka ekzistuar gjithmonë koordinim dhe bashkëpunim në zgjidhjen e detyrave. Për mbarëvajtjen e punës në Forcën Ajrore, por edhe të Albcontrol është parë si zgjidhje krijimi i një pozicioni për koordinatorët ushtarakë në ambientet e Albcontrol. Ky proces ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e profesionalizmit, shkëmbimit të eksperiencës, si dhe trajnimit të personelit ushtarak nga inxhinierët dhe teknikët e institucionit të Aviacionit Civil. Po ashtu gjatë vitit zhvillohet edhe seminare të përbashkëta trajnimi me qëllim rritjen e efektivitetit dhe koordinimit të veprimeve, si dhe në mënyrën e raportimit dhe analizimit të situatës ajrore.

Faleminderit

Gjeneral brigade Prenga në Komandën e KFOR-it

KFOR-i, misioni më i suksesshëm i NATO-s

Gjeneral Prenga vlerësoi kontributin e KFOR, si misioni më i suksesshëm i NATO në dy dekadat e fundit si dhe ndihmën në ndërtimin e institucioneve të sigurisë. Nga ana e tij.

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Dedë Prenga, zhvilloi një vizitë një ditore në Komandën e Operacionit të NATO-s në Kosovë. Gjatë kësaj vizite gjeneral brigade Prenga u prit dhe pati një takim me Komandantin e KFOR, gjeneralmajor Giovanni Fungo në Komandën e KFOR, ku u diskutua rreth situatës së përgjithshme në Kosovë, si dhe u vlerësua roli i KFOR në ruajtjen e stabilitetit dhe krijimin e një atmosfere të qetë në Kosovë e rajon.

Gjeneral Prenga vlerësoi kontributin e KFOR, si misioni më i suksesshëm i NATO-s në dy dekadat e fundit si dhe ndihmën në ndërtimin e institucioneve të sigurisë. Nga ana e tij, gjeneral Fungo vlerësoi maksimalisht kontributin e Shqipërisë në operacionin KFOR, duke veçuar dhe vlerësuar performancën e kontingjentit të FARSH si dhe vendimin e shtimit të kontributeve me personel nga ana jonë. Axhenda e gjeneral Prengës ka vijuar me një takim me kontingjentin shqiptar në KFOR, ku është pritur nga përfaqësuesi ynë ushtarak si dhe ka falënderuar personelin tonë atje për kontributin dhe prezantimin dinjitoz në këtë mision kaq të rëndësishëm për kombin shqiptar.

Gjatë qendrimit në Kosovë, gjeneral Brigade Prenga pati edhe një vizitë të shkurtër në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ku u prit nga Drejtori i Drejtorisë për Operacione në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneral brigade Zymer Halimi, zëvendës komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli dhe shefi i Operativës nga Komanda e Forcave Tokësore, kolonel Bashkim Shillova. drejtori i Operacioneve në FSK gjeneral brigade Zymer Halimi dhe zëvendëskomandanti FT-së të FSK-së gjeneral brigade Gëzim Hazrolli. Vizita është realizuar në kuadër të bashkëpunimit ushtarak në mes dy vendeve. Me këtë rast oficerët e lartë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u njohën me arritjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës në të gjitha fushat e angazhimit, operacional dhe taktik, procesin e transformimit të FSK-së dhe sfidat e saj.



Zhvillohet stërvitja CPX/CAX "Biza17-01"

Në stërvitjen CPX/CAX "Biza17-01" në periudhën 10-20 prill 2017, morën pjesë një grup ushtarakësh nga Forca e Sigurisë së Kosovës.

Forca Tokësore (FT) në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e Simulimit (QS) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, zhvilloi nga data 10-20 prill 2017 ushtrimin stërvitor CPX/CAX "Biza17-01". Në ceremoninë e hapjes së këtij trajnimi, merrnin pjesë: zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Dedë Prenga, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, shefi i Shtabit i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes kolonel Selim Troci, komandanti i Qendrës së Simulimit kolonel Dilaver Hoxha, drejtorë drejtorish nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Shtabi i Forcës Tokësore etj.

Fjalën e hapjes e mbajti kolonel Dilaver Hoxha, i cili bëri fillimisht një përmbledhje të misionit dhe detyrave kryesore që realizon qendra që ai drejton dhe më pas, vazhdoi me prezantimin e ushtrimit stërvitor "Biza 17-01".

Duke marrë fjalën për të përshëndetur ceremoninë, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral Prenga, fillimisht falënderoi Qendrën e Simulimit për punën shumë të mirë që ata kanë bërë jo vetëm sot, por edhe gjatë stërvitjeve të tjera të këtij lloji dhe, më pas, shprehu falënderimet e tij të veçanta edhe për efektivin e Forcës Tokësore, që do t'i nënshtrohet këtij trajnimi. Ai kërkoi nga të gjithë pjesëmarrësit angazhim maksimal, seriozitet dhe nivel të lartë profesionalizmi, gjatë gjithë periudhës stërvitore.

Ceremonia e fillimit të "Biza 17-01", u përshëndet gjithashtu edhe nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, i cili falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për punën mjaft të mirë që është bërë deri tani, për masat shumë të mira organizative dhe për disiplinën e treguar. Një falënderim dhe mirënjohje të veçantë gjeneral Cahani adresoi edhe për ushtarakët nga Forca e Sigurisë së Kosovës, pjesëmarrës në këtë ushtrim.



Ai shprehu besimin, se ky trajnim, do të jetë një mundësi mjaft e mirë edhe për shkëmbimin e eksperiencës me njëri - tjetrin.

CPX/CAX "Biza17-01", ishte një ushtrim stërvitor virtual i nivelit taktik, që u zhvillua në Qendrën e Simulimit në garnizonin "Skënderbej" duke pasur si audiencë primare Batalionin II të Këmbësorisë së Forcës Tokësore, i cili në këtë stërvitje veproi me strukturën organizative të grup-batalionit të lehtë të këmbësorisë. Kjo stërvitje, një ndër të veçantat e saj kishte pjesëmarrjen e një grupi prej 12 ushtarakësh nga Forca e Sigurisë së Kosovës, tregues ky i rritjes së nivelit të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve tona.

BATALIONI I I-RË I KËMBËSORISË I FORCËS TOKËSORE

100 forca dhe mjete në stërvitjen e koduar "Naraçi-17

Mbi 100 forca dhe mjete të Batalionit të Parë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore, u angazhuan për rreth 72 orë nga data 5-7 prill 2017, në stërvitjen kompaktësuese të koduar "Naraçi-17. Kjo stërvitje, u zhvillua në rajonin stërvitor të Vau të Dejës, ku ndodhet i dislokuar b1kFT me pjesëmarrjen e efektivëve nga të tre kompanitë e këmbësorisë së këtij batalioni. Qëllimi i "Naraçi-17", ishte të vlerësohej organizimi e drejtimi i efektivit nga ana e komandantit të togës e kompanisë, shkalla e përvetësimit të programit të stërvitjes nga efektivi, si dhe kompaktësimi i stërvitjes në nivel toge.

Ndër temat dhe mësimet kryesore, që u aplikuan dhe u zbatuan me sukses gjatë kësaj stërvitje, ishin: organizimi i efektivit të togës gjatë veprimeve në rast kushtrimi; lëvizja në rrugëkalim me mjete dhe në këmbë; ndalesat; sulmi,mbrojtja; rikonicioni,veprimet në prapavije të armikut etj. Komandanti i b1k n/kolonel Ali Mali, së bashku me Shtabin e këtij batalioni, kishin marrë të gjitha masat për zhvillimin, jo vetëm sa më normal të stërvitjes "Naraçi-17", por edhe për arritjen e synimit dhe objektivave të saj, të cilat në mënyrë të përmbledhur kërkonin që nëpërmjet aplikimit të Procedurave të Drejtimit të Trupave,të arrihej që të aftësoheshin drejtuesit e stërvitjes për drejtimin e veprimeve të togës në mbrojtje, sipas standarteve dhe procedurave të vlerësimit të NATO-s. Po kështu, një tjetër synim, ishte arritja e kompaktësimit të veprimeve të efektivit, në përbërje të skuadrës dhe të togës. Për vlerësimin e stërvitjes "Naraçi-17", me qëllim realizimin e një vlerësimi sa më real dhe sipas standarteve të NATO-s, për të tilla stërvitje, u përdor metoda e vlerësimit CREVAL. Në përfundim të analizës së kryer pas përfundimit më sukses të "Naraçi-17", rezultoj se kjo stërvitje bëri të mundur rritjen e nivelit profesional të drejtuesëve të saj të të gjitha niveleve. Gjatë zhvillimit të stërvitjes kompaktësuese në nivel toge, u aftësuan drejtuesit e stërvitjes me konceptet dhe procedurat standarte të drejtimit të luftimit, sipas standarteve të NATO-s. Ky personel drejtues, arriti të njohë konceptet dhe pikëpamjet mbi veprimet e kundërshtarit në situata të ndryshme politike dhe etnike, duke zbatuar skenarin e stërvitjes. Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të stërvitjes, u vu re se mobilizimi dhe disiplina e efektivit të Batalionit të Parë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore ishte në nivele maksimale.



Toger Gerta Elezi

NË RAJONIN GJIRI I VLORËS

Stërvitja "Vlora Sarex 17", sipas direktivës 075003 të NATO-s

Morën pjesë dy helikopter: një "COUGAR" dhe një helikopter AB 206, një ambulancë Ajrore dhe tre anije dhe personel me mjetet e qendrës shëndetësore Pashaliman

Në datën 11 Prill 2017, në rajonin Gjiri i Vlorës, u zhvillua stërvitja "Vlora Sarex 17",

Strukturat pjesëmarrëse në këtë stërvitje ishin Forca Ajrore, Forca Detare, QNOD(Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare), QKKSH (Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit), si dhe të gjitha strukturat bashkëvepruese në stërvitje. Në këtë stërvitje morën pjesë Gjeneral Brigade Vladimir Avdiaj, komandanti i Forcës Ajrore,General major Ylber Dogjani, komandanti i Forcës, Gjeneral Brigade Tonin Marku, Drejtor i Drejtorive në SHP,si dhe përfaqësues nga J-3 në SHP.Në fillim të kesaj stërvitje gjeneral brigade Vladimir Avdiaj theksoi se zhvillimi i stërvitjeve të tilla rrisin shkallën e bashkëveprimit midis strukturave dhe aftëson shtabet për të planizuar dhe ekzekutuar stërvititje sipas direktivës 075003 të NATO-s.

Forcat dhe mjetet pjesëmarrëse, si dhe strukturat bashkëpunuese në këtë stërvitje sipas fushave të përgjegjësisë, demonstruan aftësitë për ushtrimin e autoritetit të tyre në veprimet e përbashkëta për kryerjen e operacioneve të Kërkim Shpëtimit (SAR) në det në përgjigje të fatkeqësive dhe krizave të ndryshme humanitare. Për realizimin e kësaj stërvitje, Forca Ajrore mori pjesë me dy helikopter një "COUGAR" për në operacionet e Kërkim-Shpëtimit, dhe një helicopter AB 206 si ambulancë Ajrore. Gjithashtu në këtë stërvitje Forca Detare mori pjesë me tre anije dhe personelin me mjetet e qendrës shëndetësore Pashaliman.

Stërvitja u zhvillua në bazën e një



skenari ku një mjet lindrimi 10-12 vetësh në bord ka pësuar difekt në motor. Kërkohet ndihma e institucioneve shtetërore për gjetjen dhe dhënien e ndihmës për personat në rrezik.Gjithashtu u krye operacioni i Kërkim Shpëtimit "SAR" në det duke angazhuar asetet ajrore dhe detare për të shpëtuar jetën e personave në nevojë si dhe u bë evakuimi i tyre drejt ambienteve spitalore rajonale.

QENDRA STËRVITORE E KOMANDËS MBËSHTETËSE

Tre kurse për 41 efektivë ushtarakë



Në mjediset e Qendrës Stërvitore (QS) të Komandës Mbështetëse kanë përfunduar tre kurse profesionale me rëndësi për karrierën e nënoficerit në Forcat e Armatosura: Kursi i armatimmunicionit, Kursi profesional për xhenier si dhe Kursi i investigimit pas shpërthimit të lëndëve plasëse. Të gjitha këto kurse mundësojnë përmbushjen e detyrës dhe ngjitjes në karrierën e nënoficerit si dhe rritje profesionale për këtë kategori të rëndësishme ushtarakësh të FA.

Komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Sylaj falënderoi në mënyrë të veçantë instruktorët amerikanë për asistencën e dhënë në kursin e investigimit pas shpërthimit të lëndëve plasëse, gjithashtu falënderoi kursantët për disiplinën e lartë që kanë treguar gjatë zhvillimit të kurseve, si edhe garantoi se stafi i instruktorëve të QS do të jetë i angazhuar maksimalisht në ndihmë të kursantëve.

Trajnimi i personelit të strukturave të Komandës Mbështetëse dhe të FA është një nga prioritetet kryesore të kësaj komande. Stafi mësimdhënës dhe drejtuesit e QS së KM tashmë kanë përvojën e duhur në të gjitha fushat trajnuese dhe janë të angazhuar maksimalisht në ndihmë të kursantëve me synimin që nga kjo qendër stërvitore të dalin ushtarakë të trajnuar në nivel të barabartë dhe konkurrentë me kolegët e tyre në ushtritë e Aleancës. Në këtë kurs morën pjesë gjithsej 33 efektivëve të Komandës Mbështetëse si dhe 8 efektivë nga Policia e Shtetit.

Betohen ushtarët e rinj të Forcave të Armatosura

Shkolla e Bunavisë që nga krijimi në vitin 2003, ka trajnuar mbi 20 mijë ushtarë aktivë, kadetë, nënoficerë dhe oficerë të FA-së.



Në mjediset e Shkollës së Trupës në Bunavi u zhvillua më 1 prill 2017, ceremonia e betimit të rekrutëve që sapo përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale Bazë, si dhe u certifikuan ushtarët që përfunduan Kursin e Stërvitjes Individuale të Avancuar.Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral brigade Dedë Prenga, komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandantë forcash, drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të rekrutëve.

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, në fjalën e saj u shpreh se ishte një kënaqësi krejt e veçantë të ishte e pranishme në këtë ceremoni, si dhe foli për transparencën dhe meritokracinë gjatë këtij procesi. "Para tre muajsh, falë rezultateve dhe meritave tuaja, u përzgjodhët për t'iu bashkuar Forcave tona të Armatosura. Për këtë proces nuk ka më emra të dalë nga fundi i listës në fillim të saj apo fitues anonimë që vijnë në Forcën e Armatosur të Republikës së Shqipërisë vetëm sa për të marrë rrogën. Ajo epokë ka mbaruar dhe tani secili prej nesh dhe secili prej jush merr atë që i takon, për t'u bërë anëtarë të denjë të Forcave të Armatosura",- u shpreh znj. Kodheli, e cila nuk la pa përmendur sfidat me të cilat ushtarët e rinj do të përballen. "Është e dukshme që ju tashmë jeni transformuar nga qytetarë të devotshëm edhe në ushtarakë të aftë dhe me karakter, që dinë të orientohen në mjedisin sfidues ushtarak, i cili vërtet ka problemet e saj, sakrificën, devotshmërinë, por njëkohësisht vërtitet rreth misionit dhe detyrave të mirëpërcaktuara. Ju tashmë certifikoheni jo vetëm si ushtarë të Forcave tona të Armatosura, por njëkohësisht dhe si ushtarë të Aleancës më të fuqishme ushtarake të globit, atë të NATO. Në të ardhmen, një pjesë e mirë e juaja do të kenë mundësinë për të shërbyer në angazhimet dhe operacionet e saj."

Ministrja Kodheli u shpreh e kënaqur edhe për përzgjedhjen gjinore ku 5 vajza dhe 182 djem përfunduan me sukses Stërvitjen Individuale Bazë dhe 6 vajza dhe 128 djem në Stërvitjen Individuale të Avancuar. Ajo gjithashtu përmendi edhe kandidatët për nënoficerë të sapocertifikuar. "Po ashtu shumëllojshmëria dhe cilësia e grupit rritet edhe nga prezenca e 7 kadetëve, prej të cilëve 5 vajza, që sot certifikohen si kandidatë për oficerë", theksoi ministrja e Mbrojtjes.

Në fund të fjalës së saj znj. Kodheli përmendi edhe një herë punën dhe përkushtimin e kuadrove dhe gjithë efektivit jo vetëm për stërvitjen, por edhe për përmirësimin e kushteve të punës, stërvitjes, jetesës dhe pushimit, mjediseve sportive, ato stërvitore dhe i siguroi se mbështetja e saj personale apo e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë e vijueshme jo vetëm për këtë strukturë, por për të gjithë Forcat e Armatosura. "Politikat mbështetëse të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për motivimin mbështetjen dhe përkujdesjen e personelit ushtarak dhe familjeve të tyre, krahas modernizimit të Forcave të Armatosura, intensifikimit të stërvitjes, pajisjes me teknikë dhe armatim të ri, dëshmon edhe një herë se kjo gjë që jemi duke bërë, është ajo e duhura. Shtesat e pagave sipas gradave dhe funksioneve, është një tjetër risi që nga ky moment do të prekë xhepat e gjithkujt në Forcat e Armatosura. Kjo ka bërë sot që kërkesat për t'u bërë pjesëtarë të Forcave Tona të Armatosura të vijë gjithmonë e në rritje dhe cilësia e atyre që futen në këtë trupë, të jetë gjithmonë e më e mirë, gjithmonë e më e lartë",vlerësoi znj. Kodheli.

Komandanti i Shkollës së Trupës, kolonel Ilir Dauti, ia kushtoi ceremoninë ushtarëve të rinj të rreshtuar, të cilët siç tha ai "për 11 javë stërvitje në Bunavi demonstruan zellin, sakrificat, durimin dhe motivimin, bashkëpunimin e përkushtimin për të realizuar objektivat e programit të stërvitjes Bazë dhe asaj të Avancuar".Shkolla e Bunavisë që prej krijimit të saj në vitin 2003, ka trajnuar me programin e stërvitjes Bazë dhe të Avancuar, por edhe ka testuar dhe certifikuar, mbi 20 mijë ushtarë aktivë, kadetë, nënoficerë dhe oficerë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



Kadetët e FSK-së shkëmbim përvoje në KDS

Në ambjentet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu priti në takim një ekip me instruktorë dhe kadetë nga Qendra e Studimeve Ushtarake të Forcës së Sigurisë të Kosovës me pjesëmarrje dhe të Komandantit të Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Ruzhdi Kuçi. Komandanti i KDS Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu i uroi grupit të instruktorë dhe kadetëve të FSK mirëseardhjen në KDS dhestrukturat e saj, duke ju dhënë dhe mesazhin, se vetëm duke mësuar sa më shumë mund të arrini të keni suksese dhe ta çoni më përpara FSK dhe vendin tuaj.

Kapiten Blerim Cufaj me detyrë Zv. Komandant i Qendrës së Studimeve Ushtarake përshëndeti në emër të grupit të instruktorëve dhe kadetëve duke i përsjellë falenderimet në emër të Komandantit të KDS Gjeneral Brigade Enver Cikaqi, për mbështetjen dhe bashkëpunimin me KDS e FSK sidomos në shkëmbimin e eksperiencave në fushën e arsimim-stërvitjes. Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Ruzhdi Kuçi, theksoi se: dhe pse është hera e parë që vini në këto ambjente, jeni të mirëpritur në çdo kohë dhe dyert e AFA janë të hapura dhe në të ardhmen për të mësuar dhe shkëmbyer përvojë në fushën e arsimimit dhe stërvitjes. Vizita e ekipit me instruktorë dhe kadetë nga QSU e FSK në vendin tonë kishte si qëllim shkëmbimin e përvojave dhe njohurive me strukturat e Shtabit të Përgjithshëm të FA, Institucionet Arsimore të KDS dhe Komandat e Forcave.

Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse

Ushtarët profesionistë: Filloi kursi i formimit profesional

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse filloi kursi i formimit profesional të ushtarëve profesionistë. Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gaspër Lala, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Besnik Sylaj si dhe komandantët e reparteve vartëse të KM.

Hapja e kursit Stërvitja Individuale e Avancuar (SIA) në specialitetet logjistikë, transport, mirëmbajtje, administrim e ligjshmëri u mundëson atyre përvetësimin e dijeve specifike sipas fushave të veprimit ku ata shërbejnë.



67 kursantë që do të ndjekin kursin, të ndarë në 3 grupe mësimore do i shoqërojë një program stërvitor prej dhjetë javësh për përgatitjen dhe ngritjen e tyre profesionale duke i pajisur ata me njohuri teorike, praktike, teknike e menaxhuese si dhe aftësi drejtuese e komanduese sipas specialiteteve. Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse, aktualisht me 134 kursantë, e konsoliduar në mësimdhënie, përgatitjen dhe kualifikimin e kursantëve në shumë specialitete, si dhe duke zbatuar matricën e saj vjetore të arsimimit, do vazhdojë punën e saj në nxjerrjen e një brezi kursantësh me nivel të lartë profesional.

Për 17 kursantë fillon kursi EOD niveli I

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua më 3 prill 2017, ceremonia e fillimit të kursit EOD niveli I, si dhe kurset Furnizim dhe Transport - Mirëmbajtje. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gaspër Lala, shefi i zyrës së ODC, nënkolonel Robert Johnston, si dhe komandantët e strukturave të KM.

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gaspër Lala në fjalën e tij falënderoi në mënyrë të veçantë shefin e zyrës së ODC nënkolonel Robert Johnston për bashkëpunimin e deritanishëm me Komandën Mbështetëse, duke u ndalur në objektivat që do të arrihen me Kompaninë EOD, si dhe theksoi se "Kursi EOD niveli I është kurs funksional nëpërmjet të cilit realizohet formimi profesional i ushtarakëve të FA duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e operatorit EOD niveli i dhe ndëroperatorit EOD Niveli II në operacionet EOD për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit në operacione luftarake dhe jo luftarake". Kolonel Lala u shpreh se angazhimet e Kompanisë EOD kanë sjellë si detyrim zhvillimin e kapaciteteve operacionale të kësaj kompanie. Aktualisht Specialistë të kësaj



kompanie janë të angazhuar në mision ndërkombëtar në Mali si dhe pritet të marrin pjesë në përbërje të forcave të NATO në Letoni. Në këtë kurs marrin pjesë rreth 17 kursantë nga të gjitha strukturat e Komandës Mbështetëse të përzgjedhur për t'u trajnuar për këtë lloj kursi. Ky kurs përfundon më datë 20 qershor 2017, ndërsa kurset e tjera profesionale janë me afate një mujore.

Gjithashtu nga Komanda Mbështetëse do të jetë prioritet përgatitja dhe kualifikimi i Kompanisë EOD dhe do të arrihet që në këtë nënrepart të mos ketë asnjë ushtarak që mos të ketë certifikatën e EOD në një nga tre nivelet të marra në kurset e Qendrës Stërvitore.

GAZMEND ÇAÇI

“Qytetar Nderi” i Përmetit

Ish lojtari i Ekipit Kombëtar të Basketbollit, Mjeshtri i Merituar i Sportit, Gazmend Çaçi, aktualisht Shef i Sektorit të Aktiviteteve, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, ka marrë titullin “Qytetar Nderi” i Përmetit. Më 22 prill, ditën e shtunë, titulli iu dorëzua mjeshtrit të këtij sporti në një ceremoni mjaft të veçantë, të zhvilluar pikërisht në Pallatin e Sportit të qytetit ku lindi ikona e basketbollit shqiptar, në prani të Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama.Titulli sportistit të shquar iu dorëzua për meritat e tij të jashtëzakonshme në sportin e basketbollit, jo vetëm brenda, por dhe jashtë vendit.

Kryeministri Rama e quajti një nder shumë të madh, jo vetëm për qytetin e Përmetit, por për mbarë kombin kontributin e Gazmend Çaçit në basketbollin shqiptar, ndërsa vlerësoi edhe figurat e tjera shquara të basketbollit shqiptar ndër vite. “Nder shumë i madh që sot, në Përmet të jemi bashkë për këtë ceremoni të merituar për Gazin, por besoj dhe Gazi është me fat që kanë ardhur ta shoqërojnë në këtë ceremoni të gjithë këta burra, që i kanë dhënë shumë nder dhe lavdi basketbollit shqiptar në vite të vështira. Jam i bindur që sikur këta të ktheheshin mbrapsht edhe



> Kryeministri Rama e quajti një nder shumë të madh, jo vetëm për qytetin e Përmetit, por për mbarë kombin kontributin e Gazmend Çaçit në basketbollin shqiptar, ndërsa vlerësoi edhe figurat e tjera shquara të basketbollit shqiptar ndër vite.



njëherë në atë kohë, vetëm unë do ngelesha këtu në Shqipëri, të gjithë do kishin ikur, se do luanin me ekipe të mëdha. Gaz, çdo të mirë dhe Kryetarit të Bashkisë komplimente që bëri gjënë e duhur për Përmetin. Është një nderim i madh, por dhe për ty është nder i madh të jesh "Qytetar i Përmetit", u shpreh Kryeministri Edi Rama.

Vetë ish-rekordmeni, i cili ka fituar plot 20 kampionate, duke shënuar rreth 20 pikë në çdo ndeshje, Gazmend Çaçi tha se ndihet i vlerësuar për këtë titull. "Dua të falenderoj të gjithë këto figura të mëdha të basketbollit shqiptar, të Ekipit Kombëtar dhe të gjithë Shqipërisë."Pas ceremonisë, ish



basketbollistët më në zë të Shqipërisë, si Vaso Shaka, Bashkim Milo, Qemal Shalsi, Besnik Çela, Edgar Prifti, Artan Kuqo e të tjerë emra të mëdhenj të basketbollit shqiptar, të ndarë në dy ekipe kanë zbritur në parket për një ndeshje nostalgjie.





Nga Roma në Napoli

Ushtarakët tanë në strukturat e larta të NATO-s

Vizita në Kolegjin e Mbrojtjes zhvillohet në kuadër të programit mësimor të KLO-së për tu njohur me historinë e krijimit të tij, misionin, si dhe kontributin e vazhdueshëm që kanë dhënë në përgatitjen e ushtarakëve dhe politikanëve të nivelit të lartë. Kolegji i Nato-s është hapur më 9 nëntor 1951 në Paris.

Nga data 10 deri më 13 prill 2017, Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu dhe Kursi i Lartë i Oficerëve, zhvilloi një vizitë në dy institucione të rëndësishme të NATO-s, në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s në Romë dhe në Komandën e Forcës së Bashkuar në Napoli, Itali. Kjo vizitë zhvillohet në kohën kur Kursi i Lartë i Oficerëve ka përfunduar disa nga modulet e këtij kursi dhe aktualisht vijon në modulin e operacioneve, modulin e lidershipit dhe të historisë.

Gjatë kësaj vizite Komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjenerale Brigade Shehu e shoqëruar nga Atasheu ushtarak Shqiptar Kolonel Ylli Pulaj u prit nga Zëvëndës Komandanti i kolegjit Gjeneral Major Pascal Valentin, i cili pasi i uroi mirëseardhjen në kolegjin e mbrojtjes e njohu shkurtimisht Gjenerale Brigade Shehu me misionin, strukturën, kurset që zhvillohen në drejtim të edukimit, kërkimeve, seminareve, workshopeve dhe simpoziumeve me tematika të vecanta por që janë aktualitete të mjedisit të ri të sigurisë. Nga ana e saj Gjenerale Shehu, falenderoi Gjeneral Major Pascal Valentin, për pritjen e ngrohtë dhe miqësore si dhe për konntributin që ky kolegj ka dhënë dhe vazhdon të japë në përgatitjen e ushtarakëve të nivelit të lartë. Gjatë takimit u shkëmbyen mendime rreth situatës aktuale në lidhje me problemet e sigurisë që shqetësojnë vendet anëtare të Nato-s.

Më pas Kursi i Lartë i Oficerëve ndoqi disa leksione nga Dr Jeffrey A. Larsen, Dr Thierry Tordy dhe zoti Jean-Dominique Dulière me fokus kryesor menaxhimin e krizave, konceptet bazë të menaxhimit të këtyre krizave, sfidat e menaxhimit të krizave, rolin e organizatave jo qeveritare në këtë proces etj. Gjatë dhënies së këtij cikli të leksioneve dolën në pah tre detyrat kryesore ku janë të fokusuar strukturat e Nato-s, mbrojtja kolektive, menazhimi i krizave si dhe menazhimi i krizave operacionale. Lektorët duke folur për fazat



e menazhimit të krizave sollën në vëmendjen e auditorët rëndësinë e madhe që ka sot përgatitja e lartë e strukturave ushtarake për të qenë prezent jashtë vendit të tyre për të dhënë kontribute të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar si dhe në vendosjen e paqes, kontribute të cilat Forcat tona të Armatosura i kanë dhënë dhe vijojnë ti japin dukë qenë prezent në Afganistan, Bosnje, Kosovë, Gjeorgji etj, në krah të SHBA-së dhe vendeve anëtare të NATO-s. Vizita në Kolegjin e Mbrojtjes zhvillohet në kuadër të programit mësimor të KLO-së për tu njohur me historinë e krijimit të tij, misionin, si dhe kontributin e vazhdueshëm që kanë dhënë në përgatitjen e ushtarakëve dhe politikanëve të nivelit të lartë. Kolegji i Nato-s është hapur më 9 nëntor 1951 në Paris. Pasi Franca u tërhoq nga Nato, në vitin 1966 Kolegji u vendos në Romë dhe vitin e kaluar ka mbushur plot 50 vjet në këtë vend. Idea e hapjes së këtij Kolegji ka qenë e Gjeneral Dwight D. Eisenhower.

Një vizitë mjaft të rëndësishme dhe mbreslënëse ishte ajo në Komandën e Forcës së Bashkuar në Napoli, Itali. Në këtë vizitë Komandantja e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjenerale Shehu, u prit nga Admirale Michelle Howard, Komandantja e Komandës së Forcës Bashkuar. Admirale Howard pasi i uroj mirëseardhjen Gjenerale Shehu bëri një përmbledhje të përgjithshme rreth misionit të Komandës, organizimit dhe misioni i saj. Gjenerale Shehu falenderoi Komandanten e Komandës së Forcës Bashkuar për pritjen e organizuar, e njohu shkurtimisht me strukturën e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, misionin e saj, puna që po bëhet në drejtim të hartimit të doktrinave sipas standarteve të NATO-s si dhe me kurset që zhvillohen në këtë institucion të rëndësishëm për Forcat e Armatosura Shqiptare. Më pas të dy gjeneralet biseduan rreth sfidave të sigurisë për të ardhmen.

KLO u prit në një takim të shkurtër nga Shefi i Shtabit i Komandës së Forcës së Bashkuar Gjeneral Leitnant Luciano Portolano, i cili shprehu kënaqësinë që një kurs i lartë ushtarak nga Shqipëria viziton këtë komandë. Gjeneral Leitnant Portolano në fjalën e tij të mirëseardhjes foli me nota të larta vlerësimi për ushtarëkët shqiptarë, për trimërinë e tyre, aftësitë



kontribuese, fleksibilitetin e tyre, intelegjencën cilësi këto që Gjeneral Portolano i kishte parë gjatë qëndrimit të tij me mision në Afganistan. Më pas Gjenerali shkurtimisht u fokusua në bashkëpunimin shumë të mirë që ekziston midis anëtarëve të aleancës, besimin e ndërsjelltë, bashkëpunimin dhe përpjekjet e përbashkëta si celësin e suksesit të kësaj aleance të madhe politiko-ushtarake. Më tej nga nënkolonel Franck Faubladie, Nënkolonele Esmihane Duraku dhe nënkolonel Marko Coccia kishin përgatitur për ekipin shqiptar disa brifingje me tematika të ndryshme, lidhur me misionin, detyrat, organizimin dhe përgjegjësitë e Komandës së Forcës së Bashkuar, procesi i planizimit në NATO si dhe një brifing për direktivën strategjike të Nato-s. E vecanta e këtyre brifuesve ishte se një nga brifuesit nënkolonele Durbaku është pjesë e FA Shqiptare, e cila pa dyshim kishte kënaqësinë të brifonte para kolegëve shqiptarë. Gjatë brifingut të saj ajo u fokusua në planizimin e krizave, menaxhimin e tyre duke i cilësuar këto si një pikë e nxehtë dhe sfidë për të ardhmen. KLO u njoh nga prezantuesit me rreziqet dhe kërcënimet me karakter ushtarak dhe jo ushtarak si dhe me punën që po bëhet për përgatitjen e Forcave të Reagimit të Shpejtë të NATO-s, pjesë e të cilave do të jenë dhe efektivë të Forcave tona të Armatosura, të cilat kanë hartuar planet, programet e stërvitjes dhe të kompletimit me paisje për të qenë të gatshëm dhe prezent aty ku do të jetë NATO.

Gjatë ditëve të qëndrimit në Itali ekipi shqiptar vizitoi dhe disa vende historike si Vatikanin, Koloseumin një ndërtesë jashtëzakonisht mbreselënëse, e cila vazhdon të qëndrojë si një monument i lavdishëm i Perandorisë Romake si dhe disa vende të tjera historike në Romë. Vizita në Kolegjin e Mbrojtjes së NATO-s dhe në Komandën e Forcës së Bashkuar në Itali, për Kursin e Lartë të Oficerëve ishte një risi për informacionet dhe përvojën e fituar në përgjithësi dhe atë të menaxhimit të krizave në vecanti. Me këtë rast Kursi i Lartë i Oficerëve shpreh mirënjohjen dhe konsideratën e lartë për Ministren e Mbrojtjes Zonjën Mimi Kodheli, Shtabin e Përgjithshëm të FA, Komandanten e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjenerale Brigade Manushaqe Shehu, të cilët bënë të mundur realizimin e kësaj vizite duke rritur më tej njohuritë tona profesionale në fushën ushtarake, si dhe në atë të lidershipit. Një falenderim i vecantë është për Kolonel Ylli Pulaj Përfaqësuesi Ushtarak Shqiptar në Itali dhe Nënkolonel Fatmir Neziraj me detyrë në Komandën e Forcës së Bashkuar në Napoli për masat e marra nga ana e tyre për koordinimin e aktivitetit.

Nënkolonel Shpëtim Hysa
Kursant në KLO

Specialistët EOD pas Malit përgatiten për Letoni

Struktura speciale për eliminimin e materialeve të rrezikshme (EOD) të batalionit xhenier në Komandën Mbështetëse ka vijuar angazhimin maksimal për eliminimin e materialeve me rrezikshmëri të lartë, pothuajse në gjithë territorin e vendit.

Për një periudhë të shkurtër kohe specialistët EOD janë angazhuar në 17 operacione të kësaj natyre duke identifikuar, grumbulluar e asgjësuar municione mjaft të rrezikshme që nga bomba aviacioni, predha artilerie të kalibrit të madh, granata, municione të kalibrave të ndryshëm



etj. Harta e operacioneve fillon në Tiranë (Komisariati nr. 4, Kombinat, fshati Ibë, Shëngjergj), në Durrës (Porto - Romano, Komanda e FD), në Shkodër (fshati Golem, Laç, Vau i Dejës), në Krujë (fshati Nuaj), në Lezhë (Shëngjin), në Elbasan (fshati Gjegjan), në Korçë dhe në Gjirokastër (fshatrat Picarë, Kordhoc). Efektiv të kësaj strukture prej ditësh vijojnë punën në mbështetje të IKMT në qytetin e Vlorës si dhe të projektit të gazsjellësit TAP. Kjo strukturë është prioritet i KM dhe i FA dhe përveç angazhimit brenda vendit ajo kontribuon me përfaqësues në Mali, Afrikë dhe vijojnë përgatitjet për përfaqësimin në Letoni.



Ishulli i Sazanit hapet për turistët në sezonin veror

Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes nënshkruan më 5 prill, një marrëveshje bashkëpunimi për lejimin e turistëve për vizita turistike në ishullin e Sazanit. Marrëveshja që ka për qëllim zhvillimin e turizmit dhe promovimin e tij, u firmos nga ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli dhe ajo e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi.

Në fjalën e saj ministrja Ekonomi falënderoi ministren Kodheli për gatishmërinë e treguar për të kontribuar në rritjen e turizmit në vendin tonë, duke vënë në dispozicion të tij, pronat që administrohen nga Ministria e Mbrojtjes. "Falënderoj zonjën Kodheli pasi mundësuam një gjë shumë të mirë për turizmin gjithëvjetor shqiptar. Jemi në prag të fillimit të sezonit turistik veror dhe tour operatorët shqiptarë, agjencitë turistike kërkojnë të kenë më shumë produkte turistike për turistët dhe një kërkesë e vazhdueshme që kam bërë është aksesi që mund të kenë në ishullin e Sazanit. Fakti që ne lejojmë turistët të kalojnë në ishullin e Sazanit disa çaste turistike kur konsumojnë turizëm në vendin tonë, padyshim që është një lehtësim i madh për turizmin vendas. Një nga kushtet që turistët kanë pasur vazhdimisht në vëmendjen e tyre, ka qenë siguria, kështu unë ju falënderoj shumë për këtë vëmendje të veçantë që bëtë për vënien në përdorim të ishullit të Sazanit dhe për të nxitur më tej përdorimin atraksionin turistik Sazan." - tha ministrja Ekonomi.

Nga ana e saj ministrja Kodheli e konsideroi turizmin si një degë shumë të rëndësishme të ekonomisë shqiptare dhe për këtë shprehu gatishmërinë për të vënë në dispozicion të turistëve, asetet e Ministrisë së Mbrojtjes që ndodhen në vendet turistike, duke e vënë theksin te siguria. "Turizmi, përveçse është një pjesë shumë e rëndësishme të ardhurash për produktin mbarëkombëtar, sigurisht që duhet të reflektojë edhe një fytyrë që është fytyra e sigurisë që gjejnë turistët kur vijnë në vendin tonë. Sot bota, sidomos brigjet e Mesdheut janë të trazuara dhe të shqetësuara për shkak të gjithë ngjarjeve gjeopolitike në këtë zonë dhe shumë turistë sot preferojnë të mos frekuentojnë vende me një rrezikshmëri të lartë. Ajo çka ne duhet të sigurojmë është siguria e bregdetit tonë, gjë për të cilën ne punojmë çdo ditë. Por njëkohësisht për vetë faktin që shumë nga repartet ushtarake ndodhen në vende të spikatura të një bukurie të veçantë natyrore siç është bredeti shqiptar, ne duhet dhe mund të krijojmë mundësinë e vizitimit të këtyre zonave edhe nga turistët, e cila e bën sigurisht më atraktiv të gjithë qëndrimin e tyre" - u shpreh ministrja Kodheli.

Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mundësohet lejimi i turistëve për kryerjen e vizitave turistike në ishullin e Sazanit, i cili është pronë në përgjegjësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Turistët lejohet të kryejnë vizita turistike në ishullin e Sazanit, gjatë sezonit turistik veror në periudhën 1 maj 2017 deri më 31 tetor 2017. Marrëveshja përcakton gjithashtu edhe orarin dhe zonat që mund të vizitohen në këtë ishull.

Nëndetësja turke "TCG I. INONU" në portin e Durrësit

Eshtë viti i pestë që një nëndetëse turke zhvillon vizitë portuale në Durrës

Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëveprimi dhe trajnimi i përbashkët midis Forcës sonë Detare dhe Flotës-Turke.

NGA SHEFQETKËRCELLI

Nëzbatimtëplanittëbashkëpunimit midis ForcësDetareShqiptaredheasajtëTurqisë, nga data 30 mars deri 2 prill 2017, zhvillojnjëvizitëportualenëportin e Durrësit nëndetësja turke "TCG I.INONU". Qëllimi i kësaj vizite ishte bashkëveprimi dhe trajnimi i përbashkët midis Forcës sonë Detare dhe FlotësTurke. Anijaturke u shoqëruanëujërattona territorial ngaMotovedeta R-118, me Komandant-Kap. Lt. AlketCullhajdhe "ARCHANGEL-0, me KomandantLt. PrengGjergji,me VB nëKepin e Palit. Nëmolin 4 tëportitDurrës, "TCG I.INONU" u pritngakuadrotëForcës e Flotilj esDetare,kryesuarngaShefi i Shtabittë FD, KapiteniRanguttë II-tëArsenMullaj, përfaqësuestëAutoritetit e SigurisëPortualeDurrës, tëPolicisëUshtarake, subjekteve private, etj. Mbasbregëzimittë ND, Komandanti i NëndetësesTurkeKapiteniRanguttë II-të, Ersoy Akca, i shoqëruar nga kuadrokryesorë të saj,zhvilloivi zita e takime me autoritetet e pushtetit vendor e qëndror të Durrësit.

Takimin e pare ushtarakët turq e patën me Drejtorin e Kabinetit të Bashkisë Durrës, zotin Lavdosh Beqiraj, pastaj në Prefekturën e Durrësit,ku u pritën nga Prefektizoti Roland Xhelilaj dhe stafi i ti jdhe me zotin Alfred Mullaraj, Kryetar i Këshillit të qarkut Durrës. Gjatë takimeve u evidentua miqësia tradicionale midis dy popujve, resurset ekonomike dhe turistike të Durrësit, rëndësia e bashkëpunimitushtaraknëkuadrin e NATO-s, përforcimin e paqes e sigurisënërajon, etj.

Mbas këtyre takimeve me Autoritetet Civile, Komandanti i anijes Kapiten i Rangut të II-të, Ersoy Akcai shoqëruar nga kuadrotë "TCG I.INONU",zhvilloi një vizitë në Komandën e ForcësDetare. Drejtuesit e anijesturke u pritënngaKomandanti i ForcësDetare, GjeneralmajorYlberDogjani, Zv. Komandantii FD, KapiteniRanguttë I-rëSubiZenelajdheShefi i Shtabit i ForcësDetare,Kapiten i Ranguttë II-tëArsenMullaj. Mbasi i uroimirëseardhjennë-Portin e Durrësit, GjeneralDogjanivlerësoibashkëpunimin e deritanishëmmesdyflotavedhefushatspecifikenëtëardhmen, siarësimimi e trajnimi i personelitdetar, stërvitjet e përbashkëta, etj.

Ushtarakëtturqfalenderuanpërpritjen e bërëngaautoritetetshqiptaredhetheksuan se,mirëpresin çdo project bashkëpunimi me interestëdypalëve.

Në ditët e qëndrimit në port, nëndetësen turke e vizituan personalitete të larta Civile, diplomatike, ushtarake të Turqisë dhe Shqipërisë, Gjithashtu personeli i anijes vizitoi objektet muzeale dhe kulturoretëDurrësit,Krujës,Shkodrës,etj. Krahaskëtyreaktiviteteve nendetesja turkezhvilloistërvitjetëpërbashkët me personelindheanijetëFlotiljesDetare, gjithashtudhenjëndeshjefutbolli midis ekipittë FD dhe ND, kufitoiekipiynëdolifitues. Nendetesja Turke"TCG I. INONU" u larguangaporti i Durrësitmë2 prill 2017.

Theksojmë se është vití i pestëqënjë nendetëse turkezhvillonvizitëportualenëDurrës.







FORCA DETARE
Stërvitja ndërinstitucionale "Durrësi SarEx 17"

Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve kryesore stërvitore të Forcave të Armatosura për vitin 2017, në Komandën e Forcës Detare u zhvillua konferenca kryesore planëzuese për stërvitjen ndërinstitucionale "Durrësi SarEx 17". Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin përfaqësues të Forcës Detare e cila është edhe organizatore e kësaj konference, përfaqësues nga Forca Ajrore, Forca Tokësore, Drejtoria e Operacioneve në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Policia e Kufirit dhe Migracionit Durrës si dhe Antikontrabanda Detare.

Gjatë kësaj konference u zhvillua planëzimi i çështjeve kryesore për zhvillimin e stërvitjes Durrësi SarEx 2017, e cila është një stërvitje që angazhon institucionet e sipërpërmendura në veprime të përbashkëta për kryerjen operacioneve të kërkim shpëtimit (SAR), në përgjigje të fatkeqësive apo krizave të ndryshme humanitare në det, si dhe zbatimin e ligjshmërisë në hapësirën detare. Qëllimi kryesor i stërvitjeve të tilla është rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që kanë interesa në det, në dobi të ndalimit të aktivitetit kriminal si dhe përgjigjen në raste krizash apo situatash të ndryshme detare. Konferenca fillestare është zhvilluar 30 mars ndërsa ajo përfundimtare koordinuese ishte më datë 3 maj 2017 po në Komandën e Forcës Detare. Stërvitja do të zhvillohet 10-11 maj 2017 në rajonin e Durrësit dhe drejtuese e saj është Forca Detare.

Akademia e Forcave të Armatosura

33 kadetë, në 27 javë për tu bërë oficer në AFA

Në Akademinë e Forcave të Armatosura në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes u hap Kursi i Arsimimit të Përgjithshëm i Kandidatëve për Oficer. Kursi ndiqet nga 33 kadetë, të cilët vijnë nga rradhët e Forcave të Armatosura si dhe nga jeta civile pasi kanë përfunduar Stërvitjen Individuale të Avancuar.

Të gjithë kadetët kanë përfunduar studimet universitare të nivelit të Parë Bachelor. Programi i Kursit implementohet për herë të dytë në Akademi dhe vlen për tu theksuar fakti se komplet programi po zhvillohet nën drejtimin e instruktorëve dhe pedagogëve të Departamentit të Përgatitjes së Oficerit të Ri, si dhe nga pedagogët e Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Programi është konceptuar dhe përfshin tre fusha kryesore: fushën e arsimimit të përgjithshëm ushtarak, fushën e edukimit dhe përgatitjes ushtarake si dhe përgatitjen fiziko-luftarake.



Kursi i Arsimimit të Përgjithshëm i Kandidatëve për Oficer është hapi i parë në piramidën e arsimit ushtarak të Oficerit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Kursi është intensiv dhe zgjat 27 javë. Kursi është konceptuar në tre faza, ku secila fazë ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e plotë të kadetëve. Kursi i Arsimimit të Përgjithshëm i kandidatëve për Oficer do të përfundoj më datën 3 nëntor 2017.

Merita Alimuçaj



Garnizoni "Skëndërbej"- Qendra e Simulimit "Biza 17 – 01"

Nga datat 10 deri më 20 prill 2017 në Qendrën e Simulimit në garnizonin "Skëndërbej" u zhvillua stërvitja komando-shtabi e asistuar me kompjuter, e koduar "Biza 17-01". Qëllimi i kësaj stërvitje, ishte vlerësimi dhe përgatitja e Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) per certifikim sipas CREVAL dhe aftësimi i shtabit të tij për zbatimin e Procesit te Vendimmarrjes Ushtarake, në planizimin dhe drejtimin e operacioneve të spektrit të plotë. Kjo stërvitje, shërbeu edhe për kompaktësimin e të gjithë elementëve të GBKL, e cila është një strukturë që ngrihet për detyrë (Task Force) dhe ka si bërthamë b2k të FT, të cilës i atashohen njësi mbështetëse me luftim dhe shërbime nga repartet e tjera te FT, KM dhe AISM.

Krahas trupave tona, në stërvitjen "Biza 17-01" morën pjesë dhe përfaqësues të një kompanie këmbësorie të FSK-së. Stërvitja simuluese, ishte eksperiecë e re për ta dhe shërbeu për shkëmbimin e përvojës mes dy paleve, si dhe për rritjen e ndërveprueshmërisë duke përdorur koncepte dhe gjuhë operacionale të njëjtë.

Qendra e Simulimit, në bashkëpunim me shtabin e FT, kishte ideuar një situatë fiktive në zhvillimin e operacioneve mësymëse në rajonin e Bizës, gjatë një operacioni ndërkombëtar të drejtuar nga NATO. Pas planizimit të detajuar, proces i cili u ndoq hap pas hapi nga Vleresues-vëzhguesit e QS, të gjitha veprimet e njësive për përmbushjen e detyrës u simuluan ne kompjuter me anën sistemit JCATS (lojës kompjuterike). Këtu vlen të theksohet, se pas nje asistence rreth 4 vjeçare nga CUBIC, Qendra e Simulimt organizoi dhe zhvilloi këtë stërvitje me kapacitetet e drejtuesve tanë, duke treguar të njejtin përkushtim, profesionalizëm dhe aftësi organizative.

Fryma e bashkëpunimit, shkëmbimi i njohurive, profesionalizmi i treguar dhe ndërveprueshmëria e të gjithë nënreparteve të GBKL, arriti që të përmbusheshin të gjithë objektivat e stërvitjes, duke hedhur një hap para drejt konsolidimit të kësaj strukture që në vitin 2018, duhet të jetë plotësisht e aftë dhe e ndërveprueshme për t'u vënë në dispozicion të NATO-s, në kuadër të Forcës së Reagimit të NATOs (NRF).

Gjatë zhvillimi të stërvitjes, trupat pjesëmarrëse u vizituan nga Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës në Tiranë nënkolonel Enver Dugolli, i cili foli me superlativa për këtë ekperiencë dhe për bashkëpunimin vëllazëror mes vendeve tona.

Stërvitja u inspektua gjithashtu edhe nga zv/shefi i Shtabit të Përgjithshem të FARSH gjeneral brigade Dedë Prega, i cili vlerësoi me nota të larta këtë stërvitje dhe falenderoi të gjithë aktorët e përfshirë, për profesionalizmin e treguar dhe rezultatet e larta në "Biza 17 – 01".

Toger Ledjan Shreta
Specialist i BCU, b2kFT

Qendra Stërvitore e KM
Kurse intensive për gjashtë grupe mësimore

Në Qendrën Stërvitore të KM vijojnë kurset intensive gjashtë grupe mësimore. Kursi EOD niveli I me efektivë nga strukturat e KM dhe nga Policia e Shtetit; Kursi i Nënoficerit niveli I furnizim, transport-mirëmbajtje; Kursi i Avancuar i Nënoficerit për furnizimin dhe transport - mirëmbajtje; Kursi i gjuhës angleze niveli I. Në Batalionin e Mbështetjes Rajonale vijojnë stërvitjet e kompanisë së shpëtimit si dhe kompanisë së mjeteve të rënda. Gjithashtu vijojnë stërvitjet edhe në të gjitha detashmentet e mbrojtjes rajonale si Kukës, Burrel, Korçë, Gjirokastër. Qëllimi: testimi i të gjitha kapaciteteve për përballimin e emergjencave të mundshme. Në Batalionin e Xhenios, struktura e EOD vijon stërvitjen intensive paradislokuese pasi do të jetë pjesë e FP Letoni. Stërvitja shoqërohet me veprime praktike në terren. Në kuadrin e FP stërviten edhe një grup i CIMIC.



65-vjetori i krijimit të Radiozbulimit Ushtarak

Në mjediset e auditorit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua më 26 prill 2017, ceremonia e 65 - vjetorit të krijimit të Kompanisë së Radiozbulimit, sot Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), pjesë e strukturave të Forcave të Armatosura.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri z. Idlir Peçi, komandantë forcash, punonjës të AISM dhe veteranë të Radiozbulimit. Drejtori i Përgjithshëm i AISM, kolonel Bardhyl Kollçaku, vlerësoi punën në vite të kësaj strukture dhe ndau me të pranishmit kuriozitete në lidhje me rolin e Kompanisë së Radiozbulimit të Forcave të Armatosura, në informimin e ngjarjeve historike brenda edhe jashtë vendit.



Në fjalën e saj, ministrja e Mbrojtjes shprehu konsideratën dhe respektin e saj të veçantë për arritjet ushtarake të këtij shërbimi ndër vite dhe risolli edhe njëherë në kujtesë situatat e vështira në të cilën ushtarakët e asaj kohe duhet të përballeshin: "Pjesën e historisë, arritjeve dhe sukseseve unë gjithnjë ua lë historianëve dhe drejtuesve ndër vite. Kam respekt dhe konsideratë të veçantë për të gjitha arritjet mirëfilli ushtarake të këtij shërbimi. Keni punuar në kushte të vështira duke përballuar njëkohësisht edhe armikun e jashtëm edhe paranojën e politikës izoluese."

Më tej, ministrja Kodheli rikujtoi momentin që mori detyrën e ministres së Mbrojtjes dhe vuri në dukje ndryshimin e madh që ka përdorimi i këtij shërbimi dje dhe sot. "Kur kam nisur punën si ministre e Mbrojtjes, thuajse katër vjet më parë, vija nga opozita e përgjuar nga agjencia juaj, e përndjekur nga pajisjet tuaja, e kërcënuar nga hija e zezë e keqpërdorimit të një shërbimi inteligjent ushtarak. Politikanë të opozitës së këtij vendi, së bashku me shumë diplomatë perëndimorë, përjetonim realitete pinoçetiane në shekullin e 21-të, në zemër të Evropës, në një vend NATO. Dhe që askujt mos t'i ndodhte ajo që i bëhej opozitës së para 2013, pata si objektiv kryesor pastrimin e së keqes nga agjencia juaj."

Duke vënë theksin te burimet e mira njerëzore që kjo agjenci ka, ministrja Kodheli i kërkoi shërbimit të zbulimit të sinjaleve dhe komunikimeve rritjen e përkushtimit dhe profesionalizmit, me qëllim bashkëpunimin sa më të ngushtë me strukturat aleate, për t'iu përgjigjur sfidave të kohës. "Duhet që shërbimin e zbulimit të sinjaleve dhe komunikimeve ta shndërrojmë realisht në një pjesë të integruar serioze e profesioniste të strukturave të ngjashme të NATO, organizatës përmes së cilës ne garantojmë mbrojtjen e përbashkët. Personeli juaj operon më profesionalitet në shtabet dhe komandat e NATO dhe shpesh marr falënderime për punën tuaj." Kompania e Radiozbulimit u krijua 65 vjet më parë si një strukturë e Forcave të Armatosura, e njohur në atë kohë si "Kompania e kapjes së komunikimeve fonike dhe elektronike që vijnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë."

Batalioni i Xhenios

EOD: Pesë operacione kundër municioneve të rrezikshme

Struktura speciale për eliminimin e materialeve të rrezikshme (EOD) të Batalionit Xhenios në Komandën Mbështetëse ka vijuar angazhimin maksimal në eliminimin e materialeve me rrezikshmëri të lartë, pothuajse në gjithë territorin e vendit. Gjatë këtyre ditëve, specialistët EOD janë angazhuar në 5 operacione duke identifikuar, grumbulluar e asgjësuar municione mjaft të rrezikshme që nga municionet luftarake të gjetura në thellësinë e ujërave pranë portit të Shëngjinit, të identifikuara nga palombarët e Forcës Detare, predha kundërtanke, djegore të ndryshme, predhe murtaje 82mm të aktivizuar, granata, municione të kalibrave të ndryshëm etj. Harta e operacioneve fillon në Shëngjin (Lezhë), Qafë Prushi të Hasit, fshati Leshnje (Njësia Administrative Vithkuq, Korçë), në Golem (Kavajë) si dhe në fshatrat Picarë, Kordhoc (Gjirokastër). Efektivë të kësaj strukture prej ditësh



vijojnë punën në mbështetje të projektit të gazsjellësit TAP në qytetin e Korçës. Kjo strukturë është prioritet i KM dhe i FA dhe përveç angazhimit brenda vendit ajo kontribuon me përfaqësues në Mali, Afrikë dhe vijojnë përgatitjet për përfaqësimin në Letoni.

NË DETIN EGJE

"Oriku P-132" shpëton një gomone me 51 emigrantë sirianë



Mëngjesin e ditës së premte, datë 21 prill 2017, rreth orës 07.40 me orën lokale turke, anija Oriku P-132 gjatë patrullimit në rajonin e përgjegjësisë identifikoi një mjet lundrues me persona në bord, i cili ishte nisur nga brigjet e Turqisë në drejtim të bregdetit grek. Pas njoftimit të Anijes Komandë, Rojes Bregdetare turke dhe FRONTEX, anija Oriku ka ofruar ndihmë në rajonin e ku ndodhej gomonia me emigrantë deri në mbërritjen e anijes MAI 1102 të FRONTEX dhe Rojes Bregdetare turke. Në orën 08:37, të po asaj dite, gomonia me emigrantë, u mor në dorëzim nga anija MAI 1102 e FRONTEX, e cila bëri imbarkimin e tyre në bordin e saj. Sipas informacioneve të marra numri i personave në total ishte 51, nga të cilët 17 gra dhe 12 fëmijë. Të gjithë personat janë me kombësi siriane. Gjatë misionit të saj në Egje, anija "Oriku" ka realizuar disa operacione shpëtimi të suksesshme.



Panairi i 4-të i Mbrojtjes dhe Hapësirës Ajrore

Demolli në Kroaci, takim me presidenten Kitaroviq

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli me ftesë të ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq, qëndroi për një vizitë zyrtare në Kroaci për të marrë pjesë në panairin e 4-të të Mbrojtjes dhe Hapësirës Ajrore të Detit Adriatik(ASDA 2017), i cili u mbajt në Split. Ministri Demolli gjatë qëndrimit atje, zhvilloi më 27 prill 2017, një takim edhe me presidenten e Republikës së Kroacisë, zonjën Kolinda Grabar-Kitaroviq. Në takimin e përbashkët ministri Demolli dhe presidentja kroate, znj. Grabar-Kitaroviq, biseduan për marrëdhëniet e mira në mes dy vendeve, me theks të veçantë në fushën e sigurisë, si dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë. Ministri Demolli, në kuadër të vizitës së tij, pritet të vazhdojë agjendën e takimeve me personalitete të rëndësishëm të shtetit kroat dhe shteteve tjera pjesëmarrëse.

DEMOLLI-KRSTIQEVIQ
Marrëdhëniet ushtarake do të vazhdojnë

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës(MFSK), zotëri Haki Demolli u takua më 28 prill 2017, në Split me Ministrin e Mbrojtjes të Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq. Ministri Demolli fillimisht falënderoi Ministrin Damir Krstiqeviq për ftesën si dhe për gjithë angazhimin e tij personal dhe të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kroacisë në drejtim të avancimit të marrëdhënieve miqësore ndërmjet Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë. Nga ana e tij, ministri Demolli, tha gjithashtu; "se roli i Kroacisë si vend anëtar i NATO-s, përkatësisht roli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura Kroate, është jashtëzakonisht i rëndësishëm krahas edhe partnerëve tjerë strategjik, për ngritjen, avancimin si dhe anëtarësimin e Republikës së Kosovës në iniciativa dhe organizma rajonal dhe më gjerë të sigurisë.



Gjithashtu, ministri Demolli, u shpreh se Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës si dy institucione për të cilat Republika e Kosovës është duke u angazhuar që t'i avancojë në mandat dhe detyra, dhe duke qenë se për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura përveç vullnetit të brendshëm nevojitet edhe transparencë për procesin si dhe mbështetje nga partnerët strategjik të Republikës së Kosovës dhe vendeve siç është Kroacia e cila ka mbështet FSK-në, që nga ngritja e saj dhe vazhdon të jetë një prej vendeve që ofron shumë përkrahje. Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes të Kroacisë, zotëri Damir Krstiqeviq falënderoi ministrin Demolli, për vizitën si dhe shprehu gatishmërinë që marrëdhëniet e mira bilaterale ndërmjet dy institucioneve dhe dyja shteteve do t'i avancojnë më tutje edhe me një përkushtim edhe më të madh edhe në të ardhmen.

Ambasadori britanik Ruairi O'Connell:

Ushtria bëhet vetëm me ndryshime Kushtetuese

Kosova është betuar edhe para NATO-s që transformimin e FSK-së në ushtri do ta bëjë me ndryshimet kushtetuese. Andaj, duhet ta mbajë këtë betim në mënyrë që të ruhet partneriteti me faktorin ndërkombëtar. Kështu ka thënë për Ekonomia Online, ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O'Connell, duke shtuar se siguria e Kosovës varet nga partneriteti me NATO-n.



Ai thekson se është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme që marrëveshjet e Kosovës me NATO-n që transformimi i FSK-së të bëhet në bazë të ndryshimeve kushtetuese të respektohen. "Është shumë e rëndësishme për Kosovën që nëse ajo jep betimin për diçka ta respektojë atë. Ne kemi qenë gjithmonë pranë Kosovës për krijimin e strukturave të sigurisë qoftë FSK-së, ose një ushtrie në të ardhmen. Ne për FSK-në kemi dhënë një kontribut të vazhdueshëm që nga viti 2008 dhe do të vazhdojmë ta bëjmë. Mendoj që do të kemi edhe lajme të mira në ditët në vazhdim. Por mendoj që është shumë e rëndësishme që premtimet që dha Kosova të respektohen dhe më vjen mirë që po duket që do të respektohen tash", ka thënë ai.

I pari i Britanisë së Madhe në Kosovë, ka vlerësuar lart punën e FSK-së, duke thënë se ajo e ka plotësuar dhe zbatuar në plotëni mandatin dhe se është bërë shembull për çdo kosovar.

"Duke parë FSK-në unë jam shumë krenar për atë që kanë arritur deri tash. Ata kanë plotësuar dhe zbatuar mandatin, por gjithashtu ata janë bërë shembull për çdo kosovar që çfarë mund të arrihet me punën e palodhshme dhe vendosmërinë. Jemi shumë krenar për oficerët e FSK-së që janë shkolluar në akademitë britanike. NATO-ja është pranë Kosovës dhe do të mbetët e betuar për sigurinë e saj, andaj është shumë e rëndësishme që të ruhet dhe promovohet ky partneritet", ka thënë.

30 trupa ushtarakë nga Britania arrijnë në Kosovë

Ekipi nga Mbretëria e Bashkuar i përbërë nga rreth 30 trupa ushtarake ka arritur në Kosovë për t'iu bashkuar forcave të NATO-s në Kosovë, për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë, mbrojtjen dhe lirinë e lëvizjes. Ky zbarkim njëvjeçar i trupave do të mbështesë misionin e KFOR-it, pas një kërkese të NATO-s për mbështetje shtesë për KFOR-in nga aleatët. Roli i tyre specifik do të jetë mbështetja e KFOR-it në inteligjencë, mbikëqyrje dhe operacione gjurmuese. Ekipi britanik do të jetë i vendosur në selinë e KFOR-it në Prishtinë, thuhet në njoftimin e Ambasadës britanike. Sekretari i Mbrojtjes, Michael Fallon, me këtë rast ka thënë: "Ky zbarkim i trupave vërteton faktin që ne mbesim plotësisht të angazhuar që të mbështesim sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. NATO mbetet një gurthemel i mbrojtjes sonë, dhe duke mbrojtur sigurinë e Evropës ne forcojmë sigurinë tonë".





Kosova do blejë helikopterë

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, mësohët se ka caktuar një ekip ndërministror për të krijuar kushtet për blerjen e disa helikopterëve të cilët do t'i përgjigjen nevojave të shtetit. Në këtë takim ishin të pranishëm zëvendëskryeministri i parë, Hajredin Kuçi, ministrat Haki Demolli, Imet Rrahmani, Skender Hyseni, komandanti i FSK-së, gjeneral-lejtnant, Rrahman Rama si dhe drejtori i Policisë, Shpend Maxhuni, ekipi ndërministror ka prezantuar para kryeministrit Isa Mustafavlerësimetadekuate rreth kësaj çështje. Kryeministrilsa Mustafa theksoi se pajisja e institucioneve shtetërore me helikopterë dhe ngritja e kapaciteteve ajrore, që nuk kanë ekzistuar deri më tani, është domosdoshmëri për t'u përballur me situata tëemergjencave civile apo situatave tjera brenda vendit

FSK-ja pjesë e Kartës së Adriatikut A5-SHBA

Në Shkup të Republikës së Maqedonisë u mbajt takimi i drejtorëve për politika të mbrojtjes dhe drejtorëve të politikave të jashtme. Takimi u mbajt në kuadër të Kartës së Adriatikut A5-SHBA, nën kryesimin e Maqedonisë, për vitin 2017. Në këtë takim në emër të Ministrisë për FSK-në, mori pjesë drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, z. Faruk Geci. Gjatë këtij takimi u diskutuan temat lidhur me situatën e sigurisë në rajon dhe sfidat e sigurisë globale. Gjithashtu në këtë takim u shtrua edhe çështja e anëtarësimit të Kosovës në këtë iniciativë, pas kërkesës zyrtare të Kosovës për anëtarësim gjatë vitit të kaluar.



Akademia Ushtarake Mbretërore në Sandhurst

Hasanaj fitoi medaljen "Kadeti më i mirë ndërkombëtar"



Nëntoger Xhevahir Hasanaj fitoi medaljen "Kadeti më i mirë ndërkombëtar" në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Rrahman Rama në kuadër të vizitës zyrtare në Mbretërinë e Bashkuar, mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të kadetëve- oficerë në Akademinë Ushtarake Mbretërore në Sandhurst, ku pritet të diplomojnë nëntogerët e FSK-së; Xhevahir Hasanaj dhe Arlind Bajrami.

Kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar zonja Theresa May ishte ajo e cila i inspektoi kadetët dhe në emër të lartmadhërisë së saj Mbretëreshës Elisabetë, ndau medalje për nëntogerin Xhavihir Hasanaj si dhe certifikata për kadetët të cilët mbaruan studimet atje.

Me rastin e dhënies së medaljes oficerit të FSK-së, Xhevahir Hasanajt, kadetit me rezultatet më të larta nga të gjithë oficerët-kadetë ndërkombëtarë, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama tha se, rezultati i shkëlqyer i oficerit të FSK-së ka rëndësi të veçantë jo vetëm për Forcën e Sigurisë së Kosovës por edhe për gjithë Kosovën. "Jam i privilegjuar që gjendem sot, këtu, në cilësinë e komandantit, për të nderuar këtë ngjarje madhështore të organizuar nga kjo Akademi me nam, e cila çdoherë po nxjerr oficerë që po na bëjnë krenarë me rezultatet e tyre",- tha gjeneral Rama.

Në këtë ceremoni përveç komandantit të FSK-së, gjeneral Rama, ishte i pranishëm edhe Presidenti i Republikës, zotëri Hashim Thaçi; ambasadori i Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar, zotëri Lirim Graiçevci; pastaj kolonel Xhevahir Geci, ushtrues detyre i komandantit të Brigadës për Reagim të Shpejtë(BRSH), nënkolonel Ali Krasniqi, shef i Departamentit për Bashkëpunim e Siguri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe nënkolonel Gregor Lindsay.

Pas 12 muajsh shkollimi në Akademinë Mbretërore Ushtarake në Sandhurst të Britanisë së Madhe, sot oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Xhevahir Hasanaj fitoi medaljen "Kadeti ndërkombëtar më i mirë". Kjo është hera e dytë që një oficer kadet nga Kosova fiton çmim si kadeti më i mirë ndërkombëtar, duke pasur parasysh që në vitin 2015 nëntoger Ismail Hoxha pati fituar shpatën e argjendtë.

Parlamenti malazez

Mali i Zi ratifikon anëtarësimin në NATO

Parlamenti malazez miratoi, më date 28 prill 2017, anëtarësimin e vendit ballkanik në aleancën ushtarake NATO, në një kthim historik drejt Perëndimit dhe mes protestave të shumta nga Rusia dhe opozita proruse në vend. Ligjvënësit votuan unanimisht, 46 pro dhe asnjë kundër, në ish-kryeqytetin Cetinje, aty ku gjendet edhe selia e Presidencës së Malit të Zi, për të ratifikuar Traktatin e pranimit në aleancës ushtarake perëndimore. Pas votimit, deputetët u ngritën në këmbë dhe duartrokitën mes brohoritjeve vendimin historik.

Parlamenti malazez ka 81 anëtarë, por ligjvënësit e opozitës proruse e bojkotuan këtë seancë. Disa qindra mbështetës të opozitës u mblodhën pranë bashkisë përpara votimit. Mali i Zi ka një ushtri të vogël prej rreth 2.000 trupash, por zotëron një pozicion strategjik gjeografik, gjë që i jep NATO-s kontrollin e plotë të daljes në detin Adriatik. Edhe vendet e tjera me dalje në Adriatik, - Shqipëria, Kroacia dhe Italia, - janë gjithashtu pjesë e aleancës.

Rusia është irrituar së tepërmi nga zgjerimi i NATO-s në Mal të Zi, një zonë interesi historik për Moskën. Vetëm pak kohë më parë, Mali i Zi akuzoi zyrtarisht Rusinë se fshihej pas përpjekjes së dështuar për grusht shteti në tetor, që pretendohet se kishte për synim rrëzimin e qeverisë së ish-kryeministrit Djukanoviç dhe pengimin e anëtarësimit të vendit fqinj në NATO. Por Kremlini e ka hedhur poshtë këtë akuzë.

Kryeministri aktual, Dusko Markoviç u ka thënë ligjvënëse se anëtarësimi në NATO ishte një garanci për sigurinë në të ardhmen e Malit të Zi,



progresin ekonomik dhe stabilitetin rajonal. "Ky Parlament dhe anëtarët e tij kanë privilegjin historik për të marrë një vendim që do të mbahet mend për sa kohë që të ketë një Mal të Zi dhe malazezë", tha Markoviç. "Kjo ditë do të shënohet si një ndër më të shkëlqyerat në historinë tonë".

"Krah për krah që nga 1 korriku i vitit 1878, kur në Kongresin e Berlinit u diskutua për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Malit të Zi si shteti 27-të i asaj kohe, deri në 13 korrikun e vitit 1941, kur Mali i Zi renditet në koalicionin e madh antifashist për të mbrojtur qytetërimin botëror, deri në 21 majin e vitit 2006 kur populli i Malit të Zi vendosi të ripërtërijë shtetësinë e atdheut të tyre, të rrëmbyer me padrejtësi të madhe dhe mashtrim pothuajse pas një shekulli të plotë. Sot të gjitha këto dhe shumë data të tjera të ndritshme të historisë tonë, ia bashkangjesim vendimit për anëtarësimin e Malit të Zi në Aleancën Veri Atlantike - shoqërinë e 28 vendeve që përfaqësojnë forcën kryesore dhe vlerat e botës moderne", tha Markoviç.

"Republika më e vogël dhe më e prapambetur e ish-Jugosllavisë, u shkatërruara nga jehona e luftërave të përgjakshme ballkanike të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, e tërhequr jasht vullnetit të saj në luftën e çmendur të Serbisë me forcat e NATO-s në Kosovë. Mali i Zi ka pasur të gjitha gjasat të mbetet në fund të historisë së Ballkanit në rrugën e saj të gabuar", tha Markoviç. Në seancën ishin edhe lideri i PDS Milo Gjukanoviç, kryetarja e Gjykatës së Lartë Vesna Medenica, Prokurori special Milivoje Katniç, Kryeprokurori Ivica Stankoviç, guvernatori i Bankës Qendrore të Malit të Zi Radoje Zhugiç si dhe përfaqësues të trupit diplomatik. Vendi me 620,000 mijë banorë historikisht ka qenë i ndarë mes ndjekjes së politikave pro-perëndimore dhe aleancës me aleatët ortodoksë, Serbinë dhe Rusinë. Mali i Zi e fitoi pavarësinë nga Serbia në vitin 2006.



Mali i Zi-Sllovaki: Do forcohet bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes

Drejtori i Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes, Z. Ivica Ivanoviq, u takua më 21 prill 2017, me Ambasadorin e Republikës së Sllovakisë në Mal të Zi, romake Hloben. Ambasadori Hloben vlerësoi arritjet shquar të Malit të Zi në integrimin Euro-Atlantik, duke theksuar se vendi i tij mbështet fuqishëm qëllimet e politikës së jashtme të Malit të Zi, dhe do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe të Ushtrisë së Malit të Zi në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Drejtori Ivanoviq informoi ambasadorin për progresin e Malit të Zi në zbatimin e prioriteteve të zhvillimit, si dhe ato që lidhen me politikën e jashtme dhe rajonale.

Ata ranë dakord se shkëmbimi i përvojave në fushën e integrimit në NATO është i një rëndësie të madhe për Malin e Zi. Drejtor Ivanovic ka falënderuar për mbështetjen që Republika e Sllovakisë për të Malit të Zi në trajnimin e personelit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Malit të Zi. Ambasadori Hloben shprehu bindjen se bashkëpunimi i mëtejshëm mes dy vendeve në fushën e mbrojtjes do të forcohet në mënyrë të konsiderueshme, ajo sigurisht që tregon vizitës së ardhshme të Ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Sllovakisë e Malit të Zi si një anëtar i ardhshëm i NATO-s.

Ljubisha Jokiç pret ambasadoren amerikane Uyehara

Shefi i Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral-nënkoloneli Ljubisha Jokiç ka pritur Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Mal të Zi, znj. Margaret Ann Uyehara. General Jokiq i shprehu mirënjohjen ambasadores për ndihmën që SHBA kanë ofruar dhe përmodernizimin e Forcave të Armatosura të Malit të Zi dhe për anëtarësimin në NATO duke u shprehur se bashkëpunimi i dy vendeve në fushën e sigurisë ndaj kërcënimeve dhe sfidave bashkëkohore do të vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme. Ambasadori Uyehara përgëzoi Shefin e Mbrojtjes së Forcave të Armatosura të Malit të Zi, gjeneral-nënkoloneli Ljubisha Jokiç, për emërimin e tij në detyrë dhe shprehu deshirën për bashkëpunim nidis dy vendeve në periudhën e ardhshme. Ambasadori theksoi se SHBA do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të fortë për Malin e Zi në rrugën e integrimeve euroatlantike.



Dita e NATO-s festohet në Mal të Zi



"Festimi i 4 prillit, dita e themelimit të NATO-s, do të bëhet një traditë, për Ushtrinë e Malit të Zi. Kjo është një datë që do të bëhet pjesë e historisë së të ardhmes së Malit të Zi, siç dëshmon fakti se vendi ynë është duke menduar për veten, për të ardhmen e tij dhe sigurinë e qytetarëve të tij për herë të pare", tha ministri i Mbrojtjes i Malit të Zi, z. Predrag Boshkoviq, në ceremoninë, me të cilin Ministria e Mbrojtjes, kujtoi, festoi dhe evidentoi këtë datë historike, kur ministrat e jashtëm të Shteteve të Bashkuara dhe 11 vendeve të Europës perëndimore nënshkruan Traktatin e Atlantikut të Veriut për themelimin e NATO-s në Uashington, DC në vitin 1949. Ministri Boshkoviq theksoi se objektivat kryesore të politikës së jashtme të Malit të Zi, të cilat janë integrimi euroatlantik dhe anëtarësimi në NATO, po arrihet në mënyrën më të mirë. "Më e rëndësishmja, për Malin e Zi e që i ka munguar shpesh për shekuj me radhë, domethënë paqja, stabiliteti dhe siguria", tha ministri malazez i Mbrojtjes. Ministri Boshkoviq, kujton se "Mali i Zi, shteti më pak i zhvilluar në ish-Jugosllavi, do të bëhet pjesë e bashkësisë së vendeve më të zhvilluara, vetëm 26 vjet pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, jo vetëm nga një këndvështrim ekonomik, por më tepër nga pika e respektimit të të drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe çdo gjë që bëhet nga shoqëria moderne e sotme e begatë dhe e avancuar. Sot, këtë mëngjes, në fronin e Ministrisë së Mbrojtjes të Malit të Zi në Podgoricë, flamuri i NATO-s u ngrit solemnisht në krah të flamurit të Malit të Zi, dhe kjo ditëe këtij viti është me një rëndësi të veçantë, në funksion të anëtarësimit të ardhshëm të Malit të Zi në NATO".

Ministri i Mbrojtjes Predrag Boskovic dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjenerallejtënant Ljubisha Jokiç ndoqën demostrimet ceremoniale të anëtarëve të Ushtrisë Gardës së Nderit të Malit të Zi dhe përshëndetën dy flamuj në prani të anëtarëve të Ministrit dhe Shtabit të Përgjithshëm



Presidenti bullgar Rumen Radev

Farcat e Armatosura janë në një moment kthese

Në fjalimin e vet në lidhje me 105 vjetorin e krijimit të Akademisë Ushtarake "G.S. Rakovski" presidenti Rumen Radev doklaroi se, forcat e armatosura të Bullgarisë janë në një moment kthese nga zhvillimi i vet për shkak të mungesës së largpamësisë politike, të një mungese të financimit dhe sporadike. Presidenti rikujtoi se sipas raportit llagaridhënës të fundit të ministrisë ushtarake, forcat e armatosura janë në gjendje vetëm pjesërisht të kryejnë detyrat e veta nëpër misianet, të cilat rrjedhin nga detyrimet kushtetuese mbi garantimin e sigurisë, savranitetit dhe tërësisë territoriale. Për evitimin e tendencave negative udhëheqja shtetërore ndërmarr masa, tanimë është garantuar financimi i projekteve të rëndësishme dhe Bullgaria do të ndjekë politikën earritjes së 2% shpenzime për mbrojtjen nga Produkti i Brendshëm Bruto, 20% prej të cilëve për invostimo", shtoi udhëheqësi i shtetit.

Koncerni suedes SAAB

Tetë gjuajtës "Gripen" me vlerë 757 milionë euro

Në mbledhjen e vet, qeveria teknike e bullgarisë miratoi konkluzionet përfundimtare të kamisionit të specializuar, të krijuar për blerjen e gjuajtësve të rinj për aviacionin luftarak bullgar. Në vend të parë komisioni ka klasifikuar një afertë të Suedisë për gjuajtës të rinj "Gripon" të kancernit SAAB. Vendimi është marrë nga qeveria teknike në ditët e fundit të mandatit të saj të kufizuar, por duhet thënë se grupi i punës është emëruar me urdhër të kryeministrit Bojko Borisov gjatë kohës së mandatit të tij të dytë.



Oferta suedeze është preferuar para afertës së Partugalisë për gjuajtësit e përdorur amerikanë F-16 dhe afertës së Italisë gjithashtu për gjuajtës të përdorur "Eurafightor". Vendimi për vendin me të cilin do të zhvillohen bisedime do të mirret nga qeveria e re e cila do të marrë mandatin këto ditë, produkt i zgjedhjeve të reja parlamentare të zhvilluara para pak ditësh e që do të kryesohet përsëri nga Bojko Borisov. Bullgaria ka shprehur qëllimin e saj për të blerë gjithsejt 8 gjuajtës për rreth 757 milionë euro dhe është pjese e modernizmit të Forcave Ajrore 2018-2020.



Stërvitje e përbashkët bullgaro -amerikane

Ministria e Mbrojtjes e Bullgarise bëri të ditur se në avio-bazën Graf Igantievo të Bullgarisë Jugoremë 26 prill u ulën gjuajtësit F-15C të Forcave Ushtarake-Ajroreamerikane që po marrin pjesë në stërvitjen e përbashkët bullgaro-amerikane të flutu-rimit "Shqipanja trake 2017". Që ngamuaji prill deri në qershor ekuipet e specializuara nga të dyja vendet do të trajnojnë në avio-bazën procedurat për permirësimin e pracedurave të sigurimit logjistik dhe të mirëmbajtjes së farmacioneve nga jashtë. Qëllimi është që të arrihet një pajtueshmëri më e lartë aporative e farcave ushtarake-ajrore të Bullgarisë me aperacionet nën kujdesin e NATO-s.



Bruksel: Takimi multilateral Maqedoni-NATO

Më 25 prill në selinë e NATO-s në Bruksel u mbajtën konslultimet e rregullta multilaterale midis Republikës së Maqedonisë dhe Aleancës së NATO-s, takim ku morrën pjesë zv/ministri i mbrojtjes, Bekim Maksuti, sekretari shtetërore i Ministrisë së Mbrojtjes, Elizabeta Çupovska-Ristova dhe një delagacion i lartë i Ministrisë dhe Armatës së Republikës së Maqedonisë.

„Në selinë e NATO-s në Bruksel, bashkë me sekretarin shtetëror Çupovska-Ristova dhe delegacionin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe ARM-së morrëm pjesë në konsultimet multilaterale (PARP) mes Republikës së Maqedonisë dhe Alenacës. Në këto konsultime sërish konfirmuam se theks strategjik i Republikës së Maqedonisë është anëtarësimi i vendit tonë në NATO. Me bashkëbiseduesit prekëm të gjitha çështjet lidhur me reformat dhe me të gjithë që është arritur gjatë vitit të kaluar, si dhe të gjitha sygjerimet, gjegjësisht vërejtjet qëllimmira nga ana e NATO-s lidhur me atë se si duhet të lëvizim përpara deri në anëtarësimin e plotë në Aleancë," tha zv/ministri Maksuti. Sekretari shtetëror Çupovska-Ristova, theksoi se në konsultimet e sotme në selinë e Aleancës i është kushtuar respekt i veçantë Maqedonisë për kontributin në operacionet paqeruajtëse të udhëhequra nga NATO, Bashkimi Evropian dhe Kombet e Bashkuara.

„Në mënyrë të konsiderueshme është mbështetur fakti se Republika e Maqedonisë ka bërë përparim në bashkëpunimin rajonal në një numër të projekteve që zbatohen në nivel rajonal, siç është i i vitit 2016, hapja e selisë së Forcave Mjekësore Ballkanike me seli të përhershme në Republikën Maqedoni. Ky projekt përfshin disa prej vendeve të Ballkanit në mënyrë që të arrihet shpërndarje e këtyre forcave rast të nevojave të krizës ose situata të tjera në të gjithë rajonin e Ballkanit.

Përveç kësaj, vëmendje i është kushtuar edhe procesit të modernizimit dhe pajisimit të Armatës, i cili është në zhvillim e sipër," tha Çupovska-Ristova. Përndryshe, konsultimet e sotme në selinë e Aleancës në Bruksel janë në funksion të pritjeve të Republikës së Maqedonisë për hapjen e ciklit të 18-të të Planit Aksional për Anëtarësimin e ardhshëm në NATO (MAP), me ç'rast në këtë seksion, vendi është vlerësuar jashtëzakonisht për kontributet përkatëse që ka realizuar në të gjitha qëllimet e partneritetit.

ZORAN JOLEVSKI-TIMOTHY MCGUIRE

Poligoni ushtarak "Krivolak" në funksion të SHBA-së

Ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski në takimin me zëvendës komandantin e Forcave Tokësore të SHBA për në Evropë, gjeneral-major Timothy McGuire, theksoi bashkëpunimin dhe partneritetin e shkëlqyer me SHBA në fushën e mbrojtjes. Ai shtoi se pjesëmarrja e përbashkët në stërvitje, si dhe pjesëmarrja në misionet paqeruajtëse, siç është Misioni „Mbështetje e Vendosur" në Afganistan, janë konfirmim për partneritetin midis dy vendeve. Ministri Jolevski u shpreh veçanërisht i kënaqur për mundësinë për stërvitje të përbashkëta në Maqeodni midis njësiteve elite të SHBA-së dhe Regjimentit për Operacione Speciale të ARM-së, aktivitete të cilat janë rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer të vendosur me Komandën e Forcave Speciale të SHBA-së në Evropë.

Gjeneral-major McGuire me këtë rast përshëndeti vendimin e ministrit Jolevski për të dërguar oficerë të rinj të cilët do të jenë liderë të ardhshëm dhe bartës të



vendimeve në Armatë. Ai informoi ministrin Jolevski se edhe këtë vit një kadet maqedonas është pranuar në Akademinë e Forcave Ajrore në Kolorado. Poashtu, bashkëbiseduesit shprehën gatishmërinë për intensifikimin e mëtejmë të bashkëpunimit i cili do të kontribuojë në krijimin e një brezi të ri të fuqishëm të oficerëve liderë. Në takim u bisedua edhe lidhur me mundësitë për shfrytëzim të kapaciteteve të poligonit ushtarak "Krivolak" dhe mbajtjen e stërvitjeve të përbashkëta në të midis Armatës së Republikës së Maqedonisë dhe forcave tokësore të SHBA-së.

Gjithashtu, u fol edhe për kontributin e Armatës së Republikës së Maqedonisë në misionet paqeruajtëse dhe planet e ardhshme për angazhim plotësues në misionet e mbështetura nga Kombet e Bashkuara të cilat pritet të fillojnë në gjysmën e dytë të këtij viti. Gjatë ditës, gjeneral-major McGuire është takuar me shefin e SHP të ARM-së, gjeneral-nënkolonel Metodija Veliçkovski, ndërsa më pas është mbajtur edhe takim pune me grupet punuese lidhur me trajnimet dhe aktivitetet e ardhshme stërvitëse bashkë me forcat tokësore të SHBA-së për në Evropë.

Sfida e Maqedonisë, anëtarësimi në NATO

Më 4 prill 2017, në Shtëpinë e ARM-së në Shkup, në bashkë-organizim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Këshillit Euro-Atlantik, tradicionalisht, përmes një konference për shtyp u shënua 4 prill–Dita e NATO-s, apo ditën kur 68 vjet më parë u nënshkrua Traktati i Uashingtonit dhe u formua Aleanca e Atlantikut të Veriut.

Në konferencën për shtyp, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski u ndal në çdo gjë që NATO do të thotë për botën moderne dhe objektivat strategjik të Republikës së Maqedonisë, duke përfshirë anëtarësimin në NATO. "Aleanca Atlantikut të Veriut sot është shumë e rëndësishme për ruajtjen e paqes në botë, promovimin e marrëdhënieve mid-is popujve, parandalimin e luftërave, promovimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendeve", theksoi ministri.



Ministri Jolevski tha se në vitin 2016 Maqedonia ka dëshmuar veten si një lider në bashkëpunimin rajonal në mbrojtje. Vitin e kaluar është marrë vendimi që komanda e SEEBRIG – Brigada Europiane Juglindore nga 2020 deri në 2027 të stacionohet në Maqedoni, ndërsa në Shkup u hap selia e Forcave Mjekësore Ballkanike, e cila është organizata e parë rajonale me seli të përhershme në Republikën e Maqedonisë. Ministri gjithashtu përmendi Qendrën Rajonale për Marrëdhënie me Publikun, si qendër partnere e NATO-s. Akademia Ushtarake merr karakter rajonal – pothuajse 1/3 e kadetëve vijnë nga rajoni. Përveç kësaj, këtë vit Maqedonia kryeson iniciativat A-5, në kuadër të cilave do të propozohet iniciativa të tilla si bashkëpunimi A-5 të mund të përdoret për koordinimin më të fortë të qendrave trajnuese rajonale, dhe kjo organizatë rajonale mund të përdoret për dërgim të përbashkët të paqeruajtësve në misionet e OKB-së.

Lidhur me Republikën e Maqedonisë, ministri shtoi se kontributi i gjatë në operacionet e kryesuara nga NATO dhe përfshirja në mekanizmat partneritare nga viti 1995 ka kontribuar në zbatimin e reformave të mbrojtjes dhe rritjen e kapaciteteve kombëtare." Ne kemi ndërtuar ushtri të denjë për respekt, një ushtri që është e gatshme në çdo kohë për të përmbushur detyrat e veta kushtetuese dhe një ushtri që në mënyrë të barabartë bartet me aleatët tanë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare", tha ministri, duke shtuar se Armata e Republikës së Maqedonisë ka arritur ndërveprimin e kërkuar dhe plotësimin e kritereve për anëtarësim në NATO.

Jolevski theksoi se Maqedonia po vazhdon të punojë në përmirësimin e kapaciteteve të Armatës, dhe si shembull përmendi procesin e modernizimit që është duke u zhvilluar. Investimi i 317 milionë eurove për dhjetë vjet ka filluar të japin fryte–në rrjedhë është prokurimi i pajisjeve të reja, në përputhje me standardet e NATO-s për pjesëtarët e Regjimentit për Operacione Speciale, ndërsa procesi i riparimit të helikopterëve ka filluar dhe është duke ecur sipas dinamikës së planifikuar. Ministri theksoi se sa i përket buxhetit, 20% e fondeve për mbrojtje të këtij viti janë të destinuara për modernizimin. „Maqedonia në të ardhmen do të veprojnë në mënyrë konstruktive dhe do të marrë hapat e nevojshëm për të mbrojtur sigurinë kombëtare dhe sigurinë në rajon dhe më gjerë. Unë jam i bindur se përpjekjet tona do të vlerësohen siç duhet dhe se Maqedonia do të marrë vendin e merituar gjatë si anëtare e plotë e Aleancës, me çka shtetet anëtare do të tregojnë qasjen e tyre serioze për sigurinë në rajon," konkludoi ministri Jolevski në fjalimin e tij. Në konferencën për shtyp mes të tjerëve kanë marrë pjesë gjithashtu ambasadorët, amerikan Jess Bailey, kroat Danijela Barashiq dhe spanjoll, Ramon Abaroa Carranza, si dhe Kryetari i Këshillit Euroatlantik të Maqedonisë, Ismet Ramadani.



NATO mblidhet në Ohër, për situatën kibernetike

"Rëndësi të veçantë është të kuptojmë trendet globale lidhur me shfrytëzimin e hapësirës kibernetike nga ana e ISIS dhe organizatave tjera terroriste, si dhe aspektet politike, teknologjike, juridike dhe strategjike të këtij veprimi".

"Sikur rajonet e tjera nëpër botë, edhe Evropa Juglindore ballafaqohet me sfida që kanë të bëjnë me radikalizim dhe terrorizëm në hapësirën kibernetike, për të cilën nevojitet reagim nga NATO dhe vendet partnere. Për ne me rëndësi të veçantë është të kuptojmë trendet globale lidhur me shfrytëzimin e hapësirës kibernetike nga ana e ISIS dhe organizatave tjera terroriste, si dhe aspektet politike, teknologjike, juridike dhe strategjike të këtij veprimi. Nuk është më pak e rëndësishme as ndërlidhja rajonale, bashkëpunimi, dhe me këtë edhe forcimi i vlerave euroatlantike në rajonin e Evropës Juglindore." Këtë e theksoi ministri i Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski, në fjalën e tij para pjesëtarëve të pranishëm të shkollës së avancuar të NATO-s kushtuar luftës kundër ISIS-it nëpërmjet hapësirës kibernetike, e cila u hap në 3 prill 2017 në Ohër.

Profesori inordinar Zllatorog Mincev nga Akademia e Shkencave Bullgare e cila bashkë me Akademinë Ushtarake „Gjeneral Mihailo Apostollski" bashkëorganizojnë këtë ngjarje e cila është nën patronazhin e NATO-s, theksoi se ky është aktiviteti i tretë me rradhë kushtuar sigurisë kibernetike, por këtë rradhë, ligjeratat janë direkt të lidhura me radikalizimin e hapësirës kibernetike, sfidë kjo me rëndësi të veçantë për rajonin, por edhe më gjerë.

Në shkollën e avancuar morën pjesë mbi 45 pjesëmarrës nga vendet e rajonit, ndërsa ligjerues ishin mbi 20 profesionistë nga NATO,SHBA, Izraeli dhe shtete të tjera. Gjatë pesë ditëve të punës, pjesëmarrësit në shkollë u njohën me trendet globale lidhur me përdorimin e hapësirës kibernetike dhe teknologjive nga ana e organizatave terroriste, ndërsa bënë edhe analiza të hollësishme të këtyre trendeve në rajon dhe Evropën Juglindore. Gjithashtu, pjesëmarrësit patën mundësi të ndërtojnë bashkëpunimin rajonal, i cili është edhe komponenti thelbësor i ndërtimit të rezistencës kundër përdorimit të hapësirës kibernetike nga ana e organizatave terroriste.

SHBA-NATO

Jens Stoltenberg-Donald Trump: Asgjë nuk na ndan

Më 12 prill 2017, u zhvillua Konferenca e përbashkët për shtyp e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg.

Presidenti amerikan Donald Trump:

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, është një kënaqësi për t'ju mirëpritur në Shtëpinë e Bardhë, sidomos në një moment kaq të rëndësishëm në aleancën tonë të madhe. Unë gjithashtu dua të pranoj punën e madhe që po bëhet nga Sekretari ynë i shtetit, Rex Tillerson, për të forcuar aleancën e NATO-s, si dhe udhëtimin e Sekretarit në Moskë për të promovuar interesat e sigurisë së Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj. Ai bëri një punë të shkëlqyer. Sapo pashë disa pjesë të kësaj pune, ai bëri një punë absolutisht të shkëlqyer.

Presidenti amerikan Donald Trump:

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, është një kënaqësi për t'ju mirëpritur në Shtëpinë e Bardhë, sidomos në një moment kaq të rëndësishëm në aleancën tonë të madhe. Unë gjithashtu dua të pranoj punën e madhe që po bëhet nga Sekretari ynë i shtetit, Rex Tillerson, për të forcuar aleancën e NATO-s, si dhe udhëtimin e Sekretarit në Moskë për të promovuar interesat e sigurisë së Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj. Ai bëri një punë të shkëlqyer. Sapo pashë disa pjesë të kësaj pune, ai bëri një punë absolutisht të shkëlqyer.

Gjashtëdhjetë e tetë vjet më parë këtë muaj, jo larg nga ku ne jemi mbledhur sot, Presidenti Harry Truman foli në nënshkrimin e Traktatit të Atlantikut të Veriut. Gati shtatë dekada që nga koha kur Harry Truman tha këto fjalë, aleanca e NATO-s ka qenë mburojë e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

Aleatët e NATO-s mundën komunizmin dhe çliruan kombet rob të Luftës së Ftohtë. Ata siguruan periudhën më të gjatë të pathyer të paqes që Evropa ka njohur ndonjëherë. Ky partneritet i qëndrueshëm është i rrënjosur nga kaq shumë gjëra të ndryshme, por siguria jonë e përbashkët është gjithmonë numër një, dhe përkushtimi ynë i përbashkët i dinjitetit dhe lirisë njerëzore.

Që nga viti 1949, shtetet anëtare të NATO-s janë më shumë se dyfishuar, duke u rritur nga 12 në 28.Të hënën, (datë 10prill 2017) kam nënshkruar protokollin për miratimin e vendit të 29-të, Malit të Zi. Në muajt dhe vitet që vijnë, unë do të punoj ngushtë me të gjithë aleatët tanë të NATO-s për të rritur këtë partneritet dhe të përshtatemi me sfidat e së ardhmes, të cilat do të jenë të shumta.Kjo përfshin përmirësimin në fokusin e tyre në sigurinë më të ngutshme të sotme dhe gjithë sfidat e saj, duke përfshirë migracionin dhe terrorizmin.

Ne duhet të punojmë së bashku për të zgjidhur katastrofën që aktualisht po ndodh në Siri. Ne jemi mirënjohës për mbështetjen e anëtarëve dhe partnerëve të



NATO-s në dënimin e sulmit vrasës të Asadit duke përdorur armët më të tmerrshme. Masakrat vicioze të civilëve të pafajshëm me armë kimike, duke përfshirë vrasjen barbare të fëmijëve të vegjël dhe të pafuqishëm dhe foshnjat, duhet të hidhet poshtë me forcë nga çdo popull që e vlerëson jetën e njeriut. Është koha për t'i dhënë fund kësaj lufte brutale civile, të mposhtim terroristët, dhe do të lejojmë refugjatët të kthehen në shtëpi.

Në përballimin e sfidave tona të përbashkëta, ne duhet gjithashtu të sigurojmë që anëtarët e NATO-s të përmbushin detyrimet e tyre financiare dhe të paguajnë atë që ata detyrohen. Shumë prej tyre nuk e kanë bërë atë. Sekretari i Përgjithshëm dhe unë jemi dakord, që të tjerë anëtarë të Kombeve duhet të përmbushin përgjegjësinë e tyre për të kontribuar 2 për qind të GDP-së për mbrojtjen. Nëse vendet e tjera do të paguajnë pjesën e tyre të drejtë, në vend që të mbështeten te Shtetet e Bashkuara, për të bërë diferencën, ne të gjithë do të jemi shumë më të sigurt, dhe partneriteti ynë do të bëhet shumë më i fortë.

Kemi pasur një diskutim produktiv me Sekretarin e Përgjithshëm për atë që NATO mund të bëjë më shumë në luftën kundër terrorizmit. Unë u ankova për këtë shumë kohë më parë dhe ata bënë një ndryshim dhe tani ata e luftojnë terrorizmin. Unë kam thënë se ishte vjetruar. Ajo nuk është më e vjetruara. Shpresa ime është se NATO do të marrë një rol më të madh në mbështetjen e partnerëve tanë irakianë në betejën e tyre kundër ISIS. Unë jam gjithashtu duke dërguar gjeneralin McMaster në Afganistan për të gjetur se si ne mund të bëjmë përparim së bashku me partnerët tanë afganë dhe aleatët e NATO-s.

Çdo brez është përpjekur për të përshtatur aleancën e NATO-s për të përmbushur sfidat e kohës së tyre. Dhe

gjatë vizitës sime në Bruksel këtë pranverë, të cilën unë mezi po e pres, ne do të punojmë së bashku për të bërë të njëjtën gjë. Ne nuk duhet të jemi të bllokuar nga të menduarit e lodhur që shumë e kanë, por të zbatojmë zgjidhje të reja për t'u përballur me rrethanat e reja, dhe kjo vlen në të gjithë botën. Ne nuk jemi këtu për të qënë ceremonialë, por për të zhvilluar strategji reale për arritjen e sigurisë, sigurisë dhe paqes. Ne jemi këtu për të mbrojtur lirinë dhe prosperitetin e qytetarëve tanë dhe për t'i dhënë atyre tërësisht një të ardhme që ata meritojnë.

Sekretari i Përgjithshëm, unë jam i nderuar që ju kemi këtu sot dhe për të rikonfirmuar përkushtimin tonë për këtë aleancë dhe të vlerave të qëndrueshëm që ne me krenari, dhe unë do të thoja me shumë krenari, ndajmë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg:

Ne kemi pasur një takim të shkëlqyer dhe shumë produktiv dhe ky është me të vërtetë një nder që u njohëm për herë të parë, këtu në Shtëpinë e Bardhë.

Ne jemi dakord se NATO është një themel i sigurisë si për Evropën dhe për Shtetet e Bashkuara.

Përvoja e të dy luftërave botërore dhe e Luftës së Ftohtë na kanë mësuar të gjithëve se paqja në Evropë nuk është e rëndësishme vetëm për evropianët, por është gjithashtu e rëndësishme për prosperitetin dhe sigurinë e Amerikës së Veriut.

Pra, një NATO e fortë është e mirë për Europën, por një NATO e fortë është gjithashtu e mirë për Shtetet e Bashkuara dhe për këtë arsye unë mirëpres angazhimin shumë të fortë të Shteteve të Bashkuara për sigurinë e Evropës. Ne e shohim këtë angazhim jo vetëm me fjalë por edhe me vepra. Gjatë muajve të fundit, mijëra trupa amerikane janë vendosur në Evropë. Një demonstrim i qartë se Amerika qëndron me aleatët për të mbrojtur paqen dhe për të mbrojtur lirinë tonë.

Dhe dje ju njoftuat përfundimin e ratifikimit të anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, një shprehje e angazhimit tuaj të fortë në Evropë dhe e lidhjes transatlantike, dhe ne ju falënderojmë për këtë.

Në një botë më të rrezikshme dhe më të paparashikueshme, është e rëndësishme që të ketë miq dhe aleatë. Dhe në NATO, Amerika ka miqtë më të mirë dhe aleatët më të mirë në botë.

Së bashku, ne përfaqësojmë gjysmën e fuqisë ekonomike dhe ushtarake në botë. Asnjë superfuqi tjetër nuk ka pasur një avantazh të tillë strategjik. Kjo i bën Shtetet e Bashkuara të forta dhe më të sigurt. Ne pamë se pas sulmeve 11 shtatorit në Shtetet e Bashkuara , ishte hera e parë që NATO thirri artikullin tonë 5, klauzolën e mbrojtjes kolektive. Aleatët dërguan aeroplanë vëzhgimit AWACS për të ndihmuar dhe për të patrulluar qiellin amerikan dhe ne kemi nisur operacionin më të madh ushtarak të NATO-s ndonjëherë, në Afganistan.



Qindra mijëra evropianë dhe ushtarë kanadezë kanë shërbyer krah për krah me trupat amerikane. Më shumë se një mijë kanë paguar çmimin përfundimtar.

Sot, më parë, unë vendosa një kurorë në Varrezat Kombëtare të Arlingtonit, në nderim të të rënëve. Kjo ishte një përvojë shumë prekëse. Ne iu detyrohemi ushtarakëve tanë dhe grave për të ruajtur fitoret e arritura me vështirësi që kemi bërë së bashku në Afganistan. Ne na u kujtua sakrifica e tyre pikërisht këtë javë, kur një ushtar amerikan u vra duke luftuar kundër ISIS. Misioni ynë në Afganistan është një kontribut i madh në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar.

NATO luan një rol kyç në shumë mënyra të tjera gjithashtu. Të gjithë aleatët e NATO-s janë pjesë e Koalicionit Global për të luftuar ISIS.

Dhe NATO ofron mbështetje të drejtpërdrejtë në koalicion. Me trajnim për forcat irakiane në luftën e tyre kundër terroristëve dhe më shumë ndarje të inteligjencës. Dhe ju keni të drejtë, ne kemi krijuar një ndarje të re për inteligjencën e cila rrit aftësinë tonë për të luftuar terrorizmin dhe punuar së bashku në Aleancë për të luftuar terrorizmin në një mënyrë edhe më efektive.

Por, ne kemi rënë dakord sot, ju dhe unë, se NATO mund, dhe duhet, të bëjë më shumë në luftën globale kundër terrorizmit.

Në luftën kundër terrorizmit, trajnimin e forcave vendore është një nga armët më të mira që kemi.

NATO ka përvojën, ekspertizën dhe forcën e qëndrueshme për të bërë një ndryshim të vërtetë. Dhe lufta kundër terrorizmit do të jetë një temë e rëndësishme, kur udhëheqësit e NATO-s të takohen në Bruksel në maj.

Tema të tjera e madhe do të jetë ndarja më e drejtë e barrës në Aleancën tonë. Dhe kemi pasur një diskutim të plotë për këtë çështje sot, dhe z. President, unë ju falënderoj për vëmendjen tuaj për këtë çështje. Ne tashmë jemi duke parë efektin e fokusit tuaj të fortë për rëndësinë e ndarjes së drejtë të barrës në Aleancë. Ne jemi dakord se aleatët duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të përmbushur premtimin që ne të gjithë bëmë në vitin 2014 për të investuar më shumë në Aleancën tonë. Ai është rreth shpenzimit më shumë në mbrojtje. Ai ka të bëjë me dhënien e aftësive që ne kemi nevojë. Dhe kjo është për të kontribuar me forca në misionet dhe operacionet e NATO-s. Kjo do të thotë të holla, aftësi dhe kontribute.

Ndarja e drejtë e barrës ka qenë prioriteti im i lartë që prej marrjes së detyrës. Ne tani kemi kthyer një qoshe. Në vitin 2016, për herë të parë në shumë vite, ne pamë një rritje në shpenzimet e mbrojtjes të të gjithë Aleatëve evropianë dhe Kanadasë. Një rritje reale prej 3.8%. Apo dhjetë miliardë dollarë më shumë për mbrojtjen tonë. Ne jemi tani duke punuar për të mbajtur vrullin. Duke përfshirë zhvillimin e planeve kombëtare, që përshkruhet se si për të bërë mirë në atë që ne kemi rënë dakord në vitin 2014. Ne e dimë se ne të gjithë duhet të kontribuojmë drejt në pjesën tonë. Sepse ne kemi nevojë për të mbajtur kombet tona të sigurta në një botë më të rrezikshme.

Kemi diskutuar tema të ndryshme gjatë takimit tonë sot, duke përfshirë përdorimin e tmerrshëm të armëve kimike në Siri. Çdo përdorim i armëve kimike është i papranueshëm, nuk mund të shkojë pa përgjigje, dhe ata që janë përgjegjës duhet të mbajnë përgjegjësi. Pra Z. President, ju faleminderit edhe njëherë. Unë pres që të punojmë me ju për të mbajtur Aleancën të fortë.

Dhe unë pres për tju përshëndetur ju në Bruksel në maj, kur Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Aleancën të takohen atje për të adresuar sfidat dhe ata, duhet të vazhdojnë për tu përshtatur me Aleancën për një mjedis më të vështirë të sigurisë dhe për t'iu përgjigjur edhe për nevojën për ndarjen më të drejtë të barrës dhe rritur përpjekjet tona për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar.

Reportazh nga Brigjet e Jonit

Fuqia akademike e diturisë në Akademinë e Forcave të Armatosura



(Praktikë ndërkombëtare e gjykimit dhe ringritja e skenarit të Gjyqit të Hagës për Incidentin e Kanalit të Korfuzit nga akademistët e KKSHP-së në Akademinë e Forcave të Armatosura)

Kolonel Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI
Shef Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
Major Msc Mevlan Gaxhaj & Major Msc Ajet Jata
Akademistë në KKSHP në AFA

Akademia e Forcave të Armatosura është vetvendosur përballë sfidave të konsolidimit të sistemit arsimor ushtarak. Këtë e provojnë jo vetëm programet mësimorë të hartuar në detaje në interes të përgatitjes cilësore të ushtarakëve të të gjithë niveleve, por edhe dhjetra dokumente cilësorë që janë hartuar në vetëm gjashtë muaj dhe është e gatshme të presë përfaqësues të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL) për vlerësimin institucional dhe që mbështetet nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë (QAA). Programi mësimor është sfida e parë me të cilin ndeshet çdo student/kursant i AFA-së në të pesë kurset institucionale si dhe në katër programet e studimit akademik në fushën e sigurisë dhe të Mbrojtjes. Ushtarakë dhe civilë, kursantë e student që studiojnë në AFA, apo ata që e aspirojnë atë, do të ndeshen me sfidën e fuqisë akademike të diturisë, me "dijen si fuqi dhe pushtet të mendimit, gjykimit e të veprimit". Këtu në auditoret e mbyllura por edhe në "auditoret" e hapura, në të gjithë territorin administrative shqiptar, dija është ajo çfarë na shenjon se çfarë është e vërtetë dhe e pavërtetë, që e bën objektin dhe subjektin akademik kaq të lidhur me librin, me leximin dhe me angazhimin akademik në funksion të realizimit të misionit të shenjtëruar. Misioni drejt librit është mission i vështirë dhe i bukur sepse, libri është porta e spikatur e diturisë, një element themelor i formimit dhe burim i pashterur i diturisë që ju shërben ushtarakëve tanë edhe në përfitimin e niveleve më të larta të gradave ushtarake. Dija nuk qëndron vetëm në themel të arsimit të lartë, por edhe në të gjithë nivelet e kurseve institucionale që për AFA-në kanë ardhur gjithmonë e në ngritje e perfeksion në interest ë përgatitjes cilësore të shërbimit në Forcat e Armatosura si dhe në shtabet, komandat e strukturat euroatlantike të NATO-s.

Akademia e Forcave të Armatosura 59 vjeçare…

Pas pak ditësh AFA-ja ka ditëlindjen. Ajo ka arritur të sfidojë kohën dhe duke "përbuzur" vitet, është rritur, burrëruar e fisnikëruar, ka krijuar histori suksesi dhe ka përgatitur në gati gjashtë dekada rreth 7500 ushtarakë e civilë të niveleve më të larta në interes të plotësimit të misionit fisnik. Aktualisht misioni nuk është tjetërsuar veçse është kompletuar. AFA-ja është vendi ku teknikat e ndriçimit mendor kanë ardhur gjithmonë në evoluim. Nëse hedhim një vështrim në fokusin historik, "Me vendimin e 10 majit 1958, ngrihet "Shkolla e Naltë Ushtarake", me numër "Reparti Ushtarak Nr. 2002", ku komandanti i parë ishte koloneli gjirokastrit Thoma Xhixho, që kishte studiuar në ish-Bashkimin Sovjektik dhe që hodhi themelet e Akademisë që aktualisht ka moshën 59 vjeçare. Stafi pedagogjik i atëhershëm kishte studiuar në akademitë ushtarake më të njohura sovjetike, që sollën një përvojë për ngritjen e Shkollës së Lartë Ushtarake shqiptare. Fakt është se që nga Shkolla e Lartë Ushtarake me 14 pedagogë, aktualisht ka 60 pedagogë profesionistë në Fakultetin e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Akademia fillimisht u vendos në godinat tek vendi i quajtur "Rrapi i Treshit" në Tiranë dhe funksionoi nga 10.5.1958 deri më 30.6.1966. Veprimtaria e parë mësimore ushtar-



ake ishte hapja e Kursit të Parë Përgatitor që filloi më 3 janar 1959, kurs që u drejtua nga ushtarakë të përzgjedhur mësimdhënës, që hodhën themelet të parët, me kulturë të gjerë ushtarake si dhe kulture të përgjithshme. Programi i parë mësimor i Akademisë përfshinte lëndë të grupit të shkencave shoqërore dhe të natyrës, por vecanërisht lëndë të formimit profesional ushtarak trevjeçar. Më 15 shtator 1961, me vendim të Këshillit të Ministrave, Shkolla e Lartë e vitit 1958 emërtohet në Akademi Ushtarake, që çoi në rrugën e ndryshimeve dhe të rritjes cilësore, të jetës e të veprimtarisë akademike, që në vendimin e Këshillit të Ministrave vlerësohej "...arsim i lartë ushtarak", dhe që u reflektua me rritje në formën organizative me plane e programe mësimore, me kërkesa në rritje ndaj formave të mësimdhënies, të aplikimit të kritereve bashkëkohore. Për disa vite akademia vijoi zbatimin e programit trevjeçar, me një vit kurs përgatitor, skemë kjo që ruajti përmasat e sistemit 3 vjeçar, deri në janar 1966, kur Akademia Ushtarake kaloi në një system të ri cilësor, gjë që tregonte se tashmë koha e kurseve përgatitor ishte kapërcyer dhe se paskësaj rëndësi i jepej kulturës profesionale dhe cilësisë së përgatitjes të oficerëve. Nga fundi i viteve '70 e deri më sot, AFA-ja ka dhënë 147 grada shkencore "Dr", 11 Prof. Asoc., 10 Prof. Dr.; ndërsa në dekada u diplomuan mbi 7500 oficerë, të cilët drejtuan repartet, njësitë e strukturat e FASH. Aktualisht, Akademia e Forcave të Armatosura është institucioni më i lartë dhe i vetmi në sistemin arsimor të Forcave të Armatosura si institucion i arsimit të lartë, që vijon të ketë të njëjtin status, bazuar nëLigjin e Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 21.09.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë". Janë trupa pedagogjike akademike dhe mbështetëse, janë kursantët e akademistët e saj që i shtojnë vlera institucionit akademik ushtarak.

Me Akademistët-udhëtim
në historinë tonë kombëtare


Njohjen me vlerat e historisë sonë kombëtare dhe traditat luftarake në të gjitha zonat e vendit, akademistët e kanë detyrim në programin akademik. Prandaj, Departamenti i Strategjisë dhe Historisë ka bërë një udhëtim në histori, përmes programit mësimor. Pasi lëmë pas Tiranën, Durrësin e antikitetit, Lushnjën e Kongresit që shpalli Tiranën kryeqytet (më 1920-tën), Lushnjën e zhvillimeve të vrullshme të shekullit të XX, Apoloninë e njohur për antikitetin dhe zhvillimet në shekuj, Fierin qyteti i dytë për bumin ekonomik në vend, Mallakastrën e trimërisë dhe heroizmit në shekuj, Tepelenën-një grusht me trimëri e patriotizëm dhe për tu ndalur përtej Ujit të Ftohtë në Tepelenë, ku përpara të shfaqet një luginë e shndritshme në të gjitha kohrat.

Moti kish shkundur supet e vesuar dhe kish hedhur vellon e jeshiltë. Malet kishin "veshur" e "hequr" qeleshen e bardhë të dëborës. Në këmbët e tyre jeta rrjedhte e qetë. Zhurmojnë veç rrugët nacionale e qendrat urbane. Fshatrat presin udhët që të "zgjohen". Pasi kalon ujin e Ftohtë të Tepelenës dhe Shkallën e Zezë përhapet një dritë e ndritshme e luginës së Drinos. Në të majtë Hormova e kapedanëve dhe historisë. Kthehemi djathtas në rrugën që gjarpëron drejt Shtëpëzit, vendi ku u mbajt kuvendi historik i 10 prillit 1914, ku kapedanët e Jugut lidhën besën për luftë ndaj andartëve. Ka kaluar një shekull dhe Shtëpëzi është mes gjelbërimit me kokën "pështetur" në faqe të malit. Ai ngjason me bedenat e një kalaje të stërlashtë. Vellua e jeshile e hijeshisë e qetësisë, na fton si në një ballkon të luginës së Drinos. Pushteti i dukshmërisë është si në pëllëmbë të dorës, nga Lekëli në Kakavijë. Përballë tij, hijerëndë manastiri i Cepos, vendi i Zotave, një karakoll mijravjeçar i ngjarjeve heroike, me kuvende, ku "shkruhej" e ardhmja labe e shqiptare. Në të djathtë lugina e lumit të Kardhiqit kullon bardhësi dhe që përfundon me qafën e Skërficës dhe atë të Shtufit. Mali i Gjerë, i Lucës, i Pusit mbyllnin horizontin me rryma të freskëta mëngjesi, që pasojnë me ditë të shndritshme të mbushur me diell.

Fshatrat e Labërisë në shekuj kishin qenë gjerdan në kuvende. Sa herë binte briri i luftës lebrit, gjirokastritët, lunxhiotët, tepelenasit e përmetarët ishin bashkë, sikurse thotë polifonia, lidhur "si fishekë gjerdani,/kush na prek i humbet nishani". Kështu ishin mbledhur dhe para një shekulli, në fillim të prillit 1914 paria e kuvendi të kapedanëve dhe prijësave. Nga Fushëbardha Halil Sullo, legjenda e pushkës, burrërisë dhe mendjemprehtësisë së bashku me katër djem fushëbardhas: Dalip Kondi, Surja Tefa, Rizal Muho e Sejdi Baho. Nga Golëmi ishte kordinatori i katër çetave Solo Beqiri, luftëtar trim dhe i mençur. Nga Zhulati Hazhi Zeman Muxhai, luftëtari kombëtar Çerçiz Topulli, trimi dhe luftëtari i paepur Hasan Xhiku, legjenda e të gjithë luftrave me osmanët, grekun e italianin e 20-tës, Selam Musa Salaria etj. Prijësa e kapedanë të tjerë shkuan në kuvendin e Shtëpëzit, nga Kurveleshi i sipërm dhe Kardhiqi.

Në takim ishin edhe kapiteni holandez De Waal, lejtnanti Juljus Sonne dhe ekipi mjekësor i përbërë nga ushtarakët Tido Reddinguis, Van Vliet dhe civili De Groot. Takimi i Shtëpëzit u inicua nga hollandezët mbështetur nga një batalion xhandarmërisë shqiptare. Qëllimi ishte që të vëzhgohej nga afër tërheqja e ushtrisë greke dhe rivendosja e autoritetit të shtetit shqiptar nën drejtimin e V.Vidit. Në fakt ishte direktiva e Fuqive të mëdha. Ushtria andarte po tërhiqej nga Picari, Fushëbardha e Kardhiqi. Urdhëri i fuqive të Mëdha ishte që ata të dilnin jashtë kufirit të njohur të "Shqipërisë londineze" të miratuar nga Konferenca e Ambasadorëve. Takimi i Shtëpëzit ishte përzgjedhur në kohën e vendin e duhur. Shtëpëzi ishte si një "vendkomandë lufte në faqe të malit", që priste e përcillte kapedanë, ku lidhej besa si gjerdan i gatshëm për beteja. Kuvendi i Shtëpëzit ishte besë për lirinë. Burrat e bashkuar në idealin e lirisë lidhën besë që do të zinin pikësëpari të pesë shtigjet e Labërisë por shtegu i parë ishte qafa e Skërficës. Ata u bashkuan kundër synimeve të qeverisë autonomiste të Vorio-epirit

me seli në Gjirokastër, ku kapedani i çetës së Fushëbardhës Halil Sullo kërkoi nga hollandezët armë dhe municion. Gjithë burrat e fshatit ishin të gatshëm për luftë. Kishin vetëm pak mauxer, maliher e disa nagantë, një pjesë e tyre të fshehur në Qafë Dardhë që të mos i gjenin ushtarët e Xhavarrës (komandant i postës andarte në 1914). Këto anë nuk kishin pasur ndonjëherë ndihmë shteti deri në këtë periudhë. Për herë të parë shikonin dhe mjekë hollandezë në Labëri. Personel mjekësor tradicional kanë qenë nënat labe dhe ilaçet popullore si melhem për plagët si dhe shehlerët, hoxhallarët e ca "doktorë" pleq e plaka që mjekonin me mjete rrethanore. Foli Sulo Beqiri, Kapedan Çerçizi, Xhaferi nga Gusmari, Latifi nga Progonati... "Fermani i kuvendit të Shtëpëzit" ishte i qartë: "...të mbyllet me çdo kusht e me çdo sakërficë Skërfica, porta malore e moçme e Labërisë nga kapedan Halil Sullo dhe burrat e Fushëbardhës, Zhulatit e Rrëzomës, si dhe luftëtarë të tjerë. Kapedan Sulo Beqiri me çetat e tij u vendos nga Manastiri i Cepos, Qafa e Shtufit, Gryka e Kaparielit dhe Rehovës, Jomenin dhe me radhë.. gjithë shtigjet e Kurveleshit dhe të Labërisë". Krismat për lirinë përcjellin historinë në një krahinë e treve luftarake të pa nënshtruar ndaj çdo pushtuesi. Ishin këta prijësa dhe çetat e tyre që përbaltën akademikët ushtarakë fqinjë, që hodhën në koshin e plehrave të historisë strategjitë e tyre, përfshi edhe ata ushtarakë grekë që kishin studiuar në akademitë gjermane. Kishin kaluar gjithë jetën me armë në dorë. Takimi pati dhe romuze, kur oficerët hollandezë kërkonin t'u më- sonin lebërve artin e luftës dhe armët. Nuk e dinin se shqiptarët kishin lindur me armë. Lebërit ishin mjeshtra kur merrnin nishan në zemër dhe dinin t'i dërgonin plumbat në lule të ballit.



Skema e vendosjes së minave në gjirin e Sarandës

Djalëria e labërisë këpuste dhe fijën e gjalmit me plumb. Dyfekun e kishin zanat. "Stërvitja fushore" dhe "mësimi" i armëve në Shtëpëz nga lejtnanti hollandez Juljus Sonne i njohu me arsenalin e armëve të andartëve që pothuaj ishin që të gjitha i markave bavareze gjermane me pushkë gjysmëautomatike, mitroloza e armë artilerie, topa të kalibrave të lehtë e të mesëm, por dhe thikat (bajonetat). Depërtojmë në gojëdhënën popullore, në këtë arkivë të përjetshme të shqiptarit, por dhe në fondet dokumentare ku gjejmë ende krismën e betejave popullore të 120 burrave në Fushëbardhë, 60 burrave në Zhulat, 170 luftëtarëve të Golemit, 100 vetë të Lekëdushit, 80 vetë të Gusmarit, 46 burra të Rexhinit, 110 burra të Nivicës dhe çdo fshati të Labërisë.

Udha me Kursantë të Akademisë së Forcave të Armatosura na çon përtej Urës së Kardhiqit të mbingarkuar me ngjarje historike veçanërisht Kuvende si ai i Cepos më 1911, Kuvendi i Rrepeve të Agait më 1773, Kuvendi i Besës në Senicë më 1770 e dhjetra e qindra beteja të historisë që rruga e tyre nis pikërisht në këto gjurmë historie nga kalojnë kurantet tanë. Pak kilometra më tutje hauri historik ku Çerçiz Topulli me çetën tij më 18 mars 1908 gozhdoi qindra trupa të osmanëve që ju vërsulën Mashkullorës për ta shuar nga faqja e dheut por dështuan përballë një grusht burrash. Jo më kot thuhët në zhargonin popullor se, "Çdo betejë në Labëri është një epope".

Në qytetin-kështjellë, në Gjirokastrën mikpritëse

Autobuzi me ushtarakët e AFA-së hyri në "portat" e Gjirokastrës. Në të djathtë madhështore "Varrezat e Dëshmorëve". Ashtu siç e meritojnë për ata që derdhën gjakun për Atdhe. Ndalesa e parë në sheshin "Çerçiz Topulli" përballë monumentit historik. Një qytet vital i mencurisë, dijes, dritës së kulturës, një trashimtar i trimërisë e guximit popullor për të qenë ashtu sikurse kënga që na shoqëron në sfond "..po the Gjirokastra i ke thënë të tyre...". Gjirokastër është qytet i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan të qyteteve tregtare të stilit ottoman. Rrëza dhe faqja e malit ku ndodhet është pothuajse e zhveshur, pa bimësi, ku në dimër kur rreshjet s'kanë të sosur, nëpër pjerrësi lëshohen përrenj të rrëmbyer me ujëra të shumta. Vetë qyteti ka shumë përrenj dhe çdo lagje ndahet nga njëra-tjetra me një të tillë. Gjirokastra vazhdon të mbetet një nga qendrat kryesore të pjesës jugore të Shqipërisë. Ajo ka pasur lidhje jugore me Janinën, me bregdetin shqiptar, Vlorën dhe pellgun e Delvinës e Sarandës. Është e lidhur me Kurveleshin e Sipërm dhe të Poshtëm, me Lunxhërinë, Dropullin e Poshtëm, Pogonin, Zagorinë etj. Mali i Gjerë në rrëzë të së cilit është vendosur Gjirokastra, e ndan qytetin nga bregdeti. Akademistët janë të interesuar për kalanë, Obeliskun, monumentet, kulturën traditat, për emrin "Gjirokastër" që ka një shpjegim mitik e historik. Sipas legjendës, gjatë rrethimit përfundimtar të qytetit nga turqit, Princesha Argjiro, motra e zotit të qytetit u hodh nga muret e kalasë bashkë me djalin e saj për të mos rënë e gjallë në duart e armikut. Që këtu rrodhi edhe emri "kalaja e Argjirosë". Edhe pse kjo duket e pamundur pasi emri i qytetit përmendet që në kohën e Bizantit, para pushtimit Osman; sipas një shpjegimi tjetër më pak poetik, qyteti e ka marrë emrin sipas fjalës "argjend", që lidhet me ngjyrën e përhime të mureve, rrugëve dhe çative prej guri, të cilat vezullojnë si argjend kur lagen nga shiu. Një shpjegim tjetër lidhet me emrin e një fisi vendas që jetonte pranë Gjirokastrës: "Argjirët". Për herë të parë emri i Gjirokastrës përmendet në shek. XIII dhe fillimet e qytetit mendohet të jenë nga prijësi shqiptar Gjin Bue Shpata, i cili i dha emrin qytetit Gjinokastër, që është edhe version më i besueshëm për historianët.

Kalaja ka pasur gjithnjë para së gjithash funksion ushtarak. Megjithëse kishte banesa brenda mureve, ato ishin të paracaktuara për garnizonin dhe dinjitarët e rëndësishëm. Ndërkohë gjatë Mesjetës, qyteti u zhvillua jashtë mureve të saj. Në shekujt XVI dhe XVII qyteti, si qendër kryesore e Sanxhakut të Shqipërisë si njësi kryesore administrative turke në periudhën e hershme të Perandorisë Osmane, qyteti lulëzoi dhe, si rezultat, lagjet e tij u zgjeruan me 434 shtëpi më 1583, që shënon pothuaj dyfishim brenda një shekulli. Rritja vazhdoi edhe kur qendra rajonale administrative kaloi nëDelvinë, në kohën e Sulltan Sulejmanit të madhënishëm (1520-1566). Në nëntor të vitit 1670, udhëtari turk, Evlia Çelebiu, pas një udhëtimi nëpër Kosovë në dhjetor të vitit 1660, dhe një udhëtimi në Shqipërinë e Veriut dhe në Malin e Zi në shkurt të vitit 1662, filloi udhëtimin e tij të tretë dhe më të gjatë në trevat shqiptare. Kësaj radhe ai hyri në Shqipëri nga jugu. Pas një qëndrimi të shkurtër në Delvinë, Zhulat dhe Kardhiq, ai erdhi në qytetin "Ergiri", ku u habit shumë nga zakonet e gjirokastritëve: "... Qyteti i hapur është vendosur mbi 8 kodra dhe luginat nga të gjitha anët e kalasë, me shtëpi shumëkatëshe, me çati


prej guri dhe të rrethuara nga kopshte dhe hardhi. Secila nga këto shtëpi të ndërtuara mirë ka një kullë. Muret rrethuese të oborreve janë të ndërtuara me një lloj graniti të bardhë, punuar nga mjeshtra gurgdhendës, sikur të ishin tulla Ankaraje prej balte. Mure të tilla kanë si të pasurit ashtu edhe të varfrit. Gurë të prerë në formë katrore nuk gjenden veçse në qytetet e Tirit dhe Manisës në Anadoll... Mënyra e ndërtimit të mureve të jashtme të shtëpive nuk ka shoqe në botë. Ato janë të gjitha 20 inç të larta, të bëra me blloqe guri ranor të kuq, thjesht të vendosura gur mbi gur, pa baltë, gëlqere apo llaç për t'i lidhur. Muret dhe shtëpitë janë qindravjeçare. Qyteti ka një klimë shumë të mirë dhe për këtë arsye, banorët kanë fizik të shëndetshëm... Gjirokastritët mbajnë zi për të afërmit e vdekur për 40-50 e deri ne 80 vjet... për këtë arsye unë e quajta Gjirokastrën "qyteti i vajtimit". Është çudi e madhe se si vajtojcat profesioniste vajtojnë me kaq ndjenjë...". Është një përshkrim që ka kapërcyer kufijtë kombëtarë dhe vetëm në disa orë akademistët nuk mund të zbulojnë historinë e një mbi një dritareve të qytetit të gurtë të "Kronikës në gur", të autorit të madh Kadare. Ai nuk mund të mësojë më shumë për vitin 1811, kur qyteti ra në duart e Ali Pashë Tepelenës, ku u rifortifikua kalaja, u ndërtua një ujësjellës 12 km, që merrte ujë nga mali i Sopotit, ujësjellës që edhe është vizatuar nga piktori i famshëm britanik Eduard Lear. Ujësjellësi u shemb më 1932, por mbi lagjen "Dunavat" ka mbetur ende një hark i tij, që njihet me emrin "Ura e Ali Pashës". Më tej Obelisku dhe shkolla shqipe e vitit 1908 qëndrojnë krenare si për të dëshmuar historinë e dijes të një qyteti që ka rrezatuar e rrezaton dritë nëpër shekuj. Akademistët do të tejkalonin pritshmëritë me vizitën mësimore në fushën e aviacionit të Valarersë, Arshi Lengos dhe Asim Zenelit këtij heroi luftëtar të LIIB dhe zonat përreth, nga ku nesër portat e Gjirokastrës do të presin një komunitet më të gjerë vizitorësh nga e gjithë bota.

Shenjtëria, magjia dhe misteri
në një monument kulture

Ishte buzëmbrëmje, kur propozimi për të parë nga afër Syrin e kaltër ishte i dy djemve të "Shqipërisë matanë Drinit", dy djemve që dje ishin luftëtarë të vijës së parë të UÇK-së dhe sot janë pjesë e auditoreve shqiptare. Dhe ja dëshira e tyre u realizua me një të kthyer të timonit të autobuzit djathtas dhe grupi i kursantëve dhe pedagogëve të AFA-së u gjendën në një mugëtirë mbrëmjeje të qetë atje ku buron vrullshëm uji i "Syrit të Kaltër", që del vrullshëm nga thellësia prej 45 metrash, nga ku uji ngjitet lart si në një kazan që sapo ka filluar të vlalojë. Studiuesit kanë hedhur ngjyrë të kuqe në shpellën e Gurancisë si dhe tek "Mëma" e Viroit në Gjirokastër dhe uji ka dalë pikërisht në Syrin e Kaltër çka vërteton lidhjen nëntokësore të këtyre tre burimeve që janë njëherësh edhe monument kulture. Syri i Kaltër është një vënd turistik në fshatin Muzinë të Delvinës, pranë rrugës kombëtare Gjirokastër-Sarandë, një pikë piktoreske ku një burim i kaltër nga Mali i Gjerë del një ujë i kristaltë, nga thellesia e burimit me ngjyrë të kaltër, një monument natyre me formë ovale e ngjashme me formën e një syri. I vendosur përballë fshatit Krongj, 45 m nën nivelin e luginës së Drinos është bukuria mbresëlënëse me diametër afro dhjetë metra, me ujëra të freskëta i rrethuar me gjelbërim të larmishëm e të përhershëm. Çdokush që vjen për herë të parë në një bukuri të tillë do të kërkonte të njihej me legjendën: "Syri i Kaltër është zona ku sundonte një kuçeder, një krijesë madhështore që rrëmbente vajzat, ndalte ujin dhe ua kishte bërë tejet të vështirë jetën banorëve. Një trip i këtyre anëve guxoi dhe u ndesh me të, derisa më në fund e vrau. Kur kuçedra u vra, nga syri i buroi ky ujë i kulluar që vazhdon të rrjedhë teposhtë në formën e lumit të Bistricës duke ushqyer një bimësi të rrallë për nga dendësia e forca dhe duke dhënë më tej dritën që ndriçon qytetet dhe fshatrat e Jugut". Kuptimi i kësaj legjende, ishte simbolika e përpjekjeve të njeriut për të mposhtur të keqen, apo forcat e verbëra të natyrës dhe për t'i hapur rrugën jetës; por edhe varësinë e tij prej natyrës. Këtu në "Syrin e Kaltër", në tempulln natyror, ku në vend të kolonave prej guri, rreth altarit (syrit), ngrihen rrepët e lartë qindravjeçare që e marrin fuqinë nga uji. Mes shenjtërisë, magjisë dhe misterit akademistët kaluan një mbasdite çlodhëse dhe argëtuese. Ishte një vizitë tek bukuri shqiptare e pakrahasueshme e jugut të vendit. Ja pra pse nuk duhej të mungohej në këtë perlë që vazhdimisht vetëm të fton ta ndajë bukurinë e freskinë e përjetshme me vizitorët.

Mësim teoriko-praktik
me Departamentin e Lidershipit

Qafën e Gjashtës e ngjitëm me "një frymë". U ndalëm për të vëzhguar dhe për të "prekur" Jonin. Edhe pse mbasdite e thellë dhe e përflakur nga rrezet e diellit që binin mbi Jon, grupi i Akademistëve nën drejtimin e Departamentit të Lidershipit dhe shkencës shoqërore të FSM-së u ndal përbri kodrës historike të Lëkurësit për tu njohur dhe detajuar në terren ngjarjen që në historinë tonë kombëtare ka hyrë si "Incidenti i kanalit të Korfuzit", i ndodhur 71 vjet më parë, më 15 maj 1946 dhe 22 tetor 1946. Fakt është se dy destrojerë britanikë ndeshën në mina në detin territorial të Shqipërisë në Gjirin e Sarandës, ku Marina Britanike humbi 45 oficerë dhe



Anijet angleze kanali i Korfuziut-1946

detarë dhe 42 të tjerë u plagosën. Ngjarja është trajtuar nga historianë, ushtarakë, politikanë, jurist etj, dhe sot pas shtatë dekadash mbi këtë incident është hedhur më shumë dritë, mbi të vërtetat dhe të fshehtat. Incidenti ishte i planëzuar, i urdhëruar, por edhe i justifikuar. Aktorë ishin nivelet më të larta politike të të dy shteteve. Minimi i Gjirit të Sarandës u realizua i miratuar nga niveli më i lartë politico-ushtarak i vendit, me propozim të palës jugosllave. Kryeministri shqiptar në Shqipëri dhe Kryeministri Britanik Clement Attlee ishin plotësisht të mirëinformuar mbi ngjarjen dhe krejt veprimtarinë që çoi deri në incidentin tashmë të njohur. Dr. Zini Goxhaj bëri të njohur për akademistët e KKSHP-së gjithë ngjarjen në terren, sikurse kishte ndodhur dhe që është e njohur përmes disa librave nga autorë britanikë, shqiptarë e më gjerë si dhe nga veprimtaria e zhvilluar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë. Shefi i Departamentit të Lidershipit Kolonel Agim Sula e hedh vështrimin përtej mbrëmjes sarandiote që sapo ka rënë dhe sjell në vëmëndje pas njohjes historike të problemit, edhe ringritjen e një situate origjinale të mësimit praktik të së nesërmes që do të sjellë grupet e punës së akademistëve pikërisht në rolet e gjyqtarëve të GJND të Hagës, të palës Britanike dhe të palës shqiptare në gjyqin e parë në historinë e Gjykatës së Hagës sepse pikërisht me këtë gjykim fillon edhe funksionimi për herë të parë i kësaj gjykate të OKB-së. Mbrëmja kishte rënë. Trupa pedagogjike dhe akademistët stacionohen tek hotel "Nertil", buzë ujit në Sarandën e bukur në këtë perlë turistike.

Akademistët bashkë me
Universitarët e filialit të Sarandës

Kushdo që zgjohet në bregun jonian nuk ka se si të mos shijojë erën dehëse të limonave e portokalleve dhe të detit Jon, këtij flladi mëngjesor që të fton në një ditë të re k ursantët e KKSHP, të drejtuar nga Departamenti i Lidershipit të Fakultetit të Sigurisë dhe të Mbrojtjes në AFA. Nën dritën e diellit Saranda njihet edhe më mirë: Saranda është "perla turistike shqiptare", jo vetëm për vizitorët shqiptarë. Për herë të parë emri i Sarandës përmendet në vitin 1412. Deri në shekullin IV pas Krishtit ishte nën perandorinë Romake. Kjo vërtetohet nga rrënojat e mureve rrethuese, që ndodhen edhe në shetitoren e qytetit. Nga shek. i 4 deri ne shekullin e 6, Saranda ishte nen perandorinë Bizantine. Saranda është qytet buzë bregdetit jonian. Historia e emrit "Saranda" vjen nga një manastir i hershëm kristian që i kushtohet Dyzet Shenjtorëve/"Ágii Saranda". Në lashtësi Saranda është përmendur nga Straboni, Ptolemeu, Ciceroni etj por që njihej me emërtimin: "Onhezmi", që sipas latinishtes "Onhezi" ishte një erë juglindore e cila frynte dhe lehtesonte udhetimet dhe kuptimi i dytë sipas legjendave "Onkizi" ishte babai i Eneas. Gjatë pushtimit fashist italian të Shqipërisë më 1939, u quajt Porto Eda për nder të vajzës së madhe të Benito Mussolinit. Onhezmi/ Saranda në lashtë ishte një qytet port. Ajo ishte një nga portat, e cila bënte lidhjen e Ballkanit perendimor me vendet e Europes lindore, dhe një pike strategjike ekonomike shumë e favorshme për ilirët. Saranda, ky qytet 2000 vjeçar ka avantazhin se ka 300 ditë diell, më shumë se çdo qytet i Europës. Saranda para vitit 1992, kishte vetëm dy lagje: Limani ose edhe Limjoni si dhe Butrinti. Saranda ka një trashëgimi të pasur arkeologjike e gërshetuar me bukuritë e natyrës, si dhe portin e saj natyral, dhe përbën bazën më të rëndësishme për të promovuar zhvillimin e imazhit aktual si një destinacion i turizmit klasik botëror, si dhe për të tërhequr tregun e turizmit të veçantë. Saranda është atraktive për pushuesit vendas dhe të huaj. Vitet e fundit vihet re një "boom", i industrisë së ndërtimit.

Aktualisht, Parku Kombëtar Arkeologjik i Butrintit është gjeneruesi parësor i turistëve ndërkombëtarë, të cilët vijnë kryesisht si vizitorë ditorë nga ishulli i Korfuzit, pas një udhëtimi të shkurtër me anije.

Ora 09.00. Një ditë bashkë në auditorët e Filialit Ekonomik të Fakultetit Ekonomik të Tiranës, për epopenë e "Incidentit" të Kanalit të Korfuzit dhe të arit shqiptar, tema kaq të prekshme e komplekse për të gjithë shqiptarët. Fakt është se tre herë shqiptarët përgjatë një shekulli i Shën Naumit u përfshi me kërkesën e Jugosllavisë në arenën diplomatike më 9 nëntor 1921 - pikërisht atëherë kur nga pikëpamja juridike çështja ishte mbyllur, pasi atë ditë, Konferenca e Ambasadorëve miratoi vendimin me të cilin njihej përfundimisht Pavarësia e Shqipërisë, së bashku me kufijtë e saj politikë të vendosur në parim më 1913. Në GJND viti 1924 ka hyrë në histori si viti i një "revolucioni", i tërë për të humbur Shën Naumin dhe Vermoshin. Qeveria shqiptare, më 21 shkurt 1923 përmes ministrit të Punëve të Jashtme, Pandeli Evangjeli pranonte propozimin jugosllav që Shën Naumi dhe Vermoshi t'i ngeleshin Jugosllavisë dhe kjo e fundit t'i lëshonte Shqipërisë rrafshet e Sanishtës të Dibrës dhe të Rrafshit të Hasit në drejtimin e Prizrenit. Por nga ana tjetër edhe Lidhja e Kombeve dhe Gjykata e Hagës si dhe Konferenca e Ambasadorëve nuk mundën ta ushtronin autoritetin deri në shuarjen e institucioneve dhe fillimin e LIIB. E dyta ishte Incidenti i Kanalit të Korfuzit në mesin e shekullit të kaluar për të cilën do të pasojë analiza si dhe Çështja e tretë ishte ajo që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e Hagës "noterizon" pavarësinë e Kosovës me "Mendimin këshillimor të GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës", duke u deklaruar më 22 korrik 2010 se "Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 nuk bie në kundërshtim me normat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".

Incidenti i Kanalit të Korfuzit dhe ari
shqiptar-episode tragjike të Luftës së Ftohtë

Fakulteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes po shkelte në rrugë të pa shkelura. Në udhët e zbatimit të një mësimi praktik që kalonte përmes programit mësimor të DLSHSH u veprua për herë të parë në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik, Filiali i Sarandës, ku mikëpritëse ishte e këtij filiali Dr.Ornela Shalari, petagoge për Statistikën pranë Fakultetit të Ekonomisë Filiali Sarandë dhe Dr.Vasilika Rraku, Petagoge për Gjuhët e Huaja si dhe 50 studentë të këtij Filiali. Për FSM-në ishte sinjifikative që ky mësim asistohej drejtpërdrejtë nga Rektori i AFA-së Kol. Ruxhdi Kuçi. Hapja e mësimit, "Praktikë ndërkombëtare e gjykimitsipas skenarit të Gjyqit të Hagës-rast studimor" me kursantë të KKSHP-së u bë nga Kol. Prof. As. Agim Sula, që përmbledhas solli në vëmëndje piketat kryesore të zhvillimit të ngjarjeve në rolin e gjykatësve të Hagës të para rreth shtatë dekadash. Drejtimi i mëtejshëm i mësimit me kopetencë profesionale u realizua nga Kol ® Dr. Zini Goxhaj, i cili dha detaje të skenarit të gjyqit ndërkombëtar me lirshmëri e kopetencë si të ishte një proces real gjyqësor i kategorisë ndërkombëtare, me synime dhe mënyrë organizimi të përafërta me ato të reales. Edhe pse "gjykimi ishte me drejtësi" të fituar nga ky "gjykim" sigurisht ishin anglezët. Një auditor me rreth 80 studentë të përbashkuar në një auditor të KKSHP-së dhe student të filialit të Sarandës ndogjën gjithë "sy e veshë" paraqitjen pothuaj spektakolare të "gjykatësve të Hagës" si dhe të "palës shqiptare" dhe "palës angleze" në një çështje që ka determinuar në dekada. Qëllimi ishte i detajuar dhe i menduar mirë mbi "Njohjen e së Drejtës Ndërkombëtare, dhe konflikteve ndërkombëtare; Rëndësia e organeve ndërkombëtare (KS OKB); Zhvillimi historik i Gjykatës Ndërkombëtare dhe rastet studimore; Incidenti i Kanalit Korfuzit i 22 tetorit 1946 si rasti parë i gjykimit nga GJND pas Luftës II Botërore. Përvoja e Shqipërisë në përballje në Gjykatën Ndërkombëtare". Auditori "u fut në situatë" duke u njohur me ngjarjen: 15.5.1946: "Dy kryqëzorë britanikë H.M.S. "Orion" dhe "H.M.S. Superb", në orën 20:30, ndërsa po kalonin nëpër Kanalin e Korfuzit në përputhje me regjimin e kalimit paqësor nëpër rrugëkalimin MEDRI, sipas versionit britanik, një bateri e artilerisë bregdetare shqiptare në Kepin Paladha hapi zjarr për rreth 7 minuta dhe u hodhën 18 predha 100 mm, të gjitha mosmbritëse. Anijet britanike nuk iu kundërpërgjigjën kanë qenë të detyruar të kërkojnë drejtësi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë: e para ishte Çështja e Shën Naumit dhe e Vermoshit është çështja e parë gjyqësore në arenën diplomatike, ku Anglezët i dhuronin Shën Naumin e Vermoshin Serbisë; ndërkohë që Italianët dhe francezët ishin kundër anglezve. Çështja se kujt i përkiste Manastiri



Anijet angleze kanali i Korfuziut-1946

zjarrit të baterive bregdetare shqiptare".

22.10.1946: "H.M.S. Mauritius, H.M.S. Saumarez, H.M.S. Volage dhe H.M.S. Leander lundronin në formacion kolonë sipas drejtimit jug-veri. Përballë Sarandës, në orën 14: 53 minuta, destrojeri H.M.S. Saumarez ndeshi në mine dhe u dëmtua rëndë. Kryqëzori H.M.S. Mauritius vazhdoi lundrimin në drejtim të Kepit të Qefalit, ndërsa Kryqëzori H.M.S. Leander u urdhërua të kthehej në drejtim të Korfuzit. Destrojeri H.M.S. Volage u dërgua për të ndihmuar destrojerin H.M.S. Saumarez dhe gjatë lundrimit (ndërsa H.M.S. Volage rimorkionte H.M.S. Saumarez), në orën 16:25 u ndesh në minë. Për shkak të rënies në minë të dy destrojerëve, marina britanike humbi 45 oficerë dhe marinarë (1 oficer dhe 44 marinarë), 42 të tjerë u plagosën (3 oficerë dhe 39 marinarë)". Njoftimi nga Agjencia e lajmeve "Reuters".



KKSHP në Sarandë me studentë të ekonomikut

Prezantimi fillestar u bë nga grupi i monitorimit: "Major A. Jata; Sh. Llagaçi; K. Ndoci; D. Sopi; P. Basha; O.Mitre". Në prezantimet akademike merr rëndësi shfrytëzimi i literaturës dhe përzgjedhja e literaturës. Studimet për "Incidenti në Kanalin e Korfuzit" në një IAL, nuk konceptohen pa studimin e literaturës dhe arkivave dhe këtu qëndron edh emerita e Departamentit në udhëheqjen drejt studimit të ngjarjes dhe fenomenti përmes autorëve shqiptarë: "Arben Puto, "E drejta ndërkombëtare publike" dhe "Nëpër analet e diplomacisë angleze"; "Kapiten Rangut I-rë Artur Meçollari "Incidenti i Kanalit të Korfuzit, drejtësi e anuar"; "Paskal Milo "Të vërtetat e fshehura-Incidenti i Kanalit të Korfuzit", Tiranë, 2010; "Auron Tare, Ato mina në Korfuz, Revista Klan Dossier, 18 nëntor 2001"; "Ksenofon Kristafi, "në kërkim të arit, Botimet Dita 2000, UET"; Behar Shtylla, "Kronika diplomatike", Arkivi personal, pronë e familjes Shtylla"; Ndreci Plasari, Rreth incidentit të Kanalit të Korfuzit, Studime historike, 3-4/199; "Maxhun Peka, Incidenti i Korfuzit dhe pasojat e tij në politikën shqiptare, "Minerva", 20-26 tetor 27 tetor 2 nëntor 2002". Vlerë merr gjithashtu studimi i literaturës së huaj sidomos anëtarëve të ekuipazhit të anijeve britanike, Eric Legget ka shkruar ngjarjen tek "The Corfu Incident";"Rexhinald Pol Komandanti i anijes "Volage" përshkrim të ngjarjes menjëherë pas shpërthimit.."; Anthony Carty, The corfu Channel Case- and the missing Admirality Orders..."; "Leslie Gardiner, The eagle spreads his claws. A history of the Corfu Channel dispute and of Albania's Relations with the West, 1945-1965", "Il Yung Chung, Legal Problems involved in the Corfu Channel Incident.."; "Woodrorow Wilson Center for Scholars "Burning Secrets of the Corfu Channel Incident" September 2014" etj.

Pikëpamja britanike: "kalimi paqësor nëpër ngushtica është i njohur nga e drejta zakonore ndërkombëtare e detit".Pikëpamja shqiptare: "anijet luftarake dhe tregëtare të huaja nuk mund të kalojne nëpër detin territorial shqiptar pa autorizim paraprak".Konkluzioni juridik kaloi në procedurë standard: "Meqënëse palët britanike dhe shqiptare nuk arritën kompromis në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, çështja shkon për shqyrtim në Gjykatën Ndërkombëtaretë Drejtësisë në Hagë. "Loja" juridike kishte filluar. Ballafaqimi me të "drejtën zgjati shumë dhe në fakt vërtetohet maksima e popullit tonë se, "e drejta zhytet por nuk mbytet", edhe pse haka nuk shkon gjithmonë tek i zoti. Prezantimet e Major Ajet Jata në rolin e kreut të Grupit të Monitorimit solli detaje e fakte sesi ka ndodhur incidenti. Major Mevlan Gaxhaj që përfaqësonte "Perandorinë e deteve" prezantoi pikëpamjet e Qeverisë Britanike; Major L. Qyra prezantoi pikëpamjet e një qeverie mjaft të re dhe pa përvojë të lëmin e gjyqeve dhe juridiksionit ndërkombëtar siç ishte Qeveria Shqiptare. Major Gazmend Kulejmani prezantoi Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë në rolin e Jose Gustav Guerrero në rolin e "Kryetarit të GJND-së".Mësimi i "Lojës" juridike të Hagës ndoqi veprimtarinë paraprake në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe më pas në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar, ku akademistët përcollën për audiencën emocione gjyqësore, por edhe profesonalizëm në trajtimin e çështjes së Incidentit të Kanali i Korfuzit që shënonte faktikisht çështjen e parë që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka gjykuar që nga krijimi i saj. Incidenti ishte indikacioni që menjëherë pas LIIB ka ndikuar në ndarjen ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Organizatorët DLSHSH në FSM sollën në fund të prezantimeve edhe një reportazh audio-video të përgatitur nga akademistët e KKSHP-së. Pas përfundimit të flimit studentet e Filialit Sarandë dhe të pranishëm shtruan diskutuan dhe shtruan pyetje me interes rreth tematikës së prezantuar, të Incidentit të Kanalit të Korfuzit si dhe arit shqiptar të bllokuar për më shumë se gjysëm shekulli. Ndërkohë që nga gjithë sasia prej 2454 kilogram e 874,5 gram të konfiskuar nga britanikët në kriporen Merkers të Gjermanisë pas mbarimit të LIIB Shqipëria me marrëveshjen e datës 29.10.1996 duhej të merrte 1574 kg. Ari jonë në Londër përbëhej nga 198 kallëpe ari, 7 copë thupra, 2 copa ari, 22 qese monedha ari. Të gjitha sasitë ishin në flori aliazh dhe flori safi e vendosur në 55 arka të fashuara me çelik. Pra 880 kg ar ose 843.947 lira-stërlina do ti kushtonte Shqipërisë vlera e dëmeve të shkaktuara anijeve "Saumarez" e "Volage" më 22.10.1946. Fakt historik është se: "GJND me 11 vota pro dhe 5 kundër, konkludoi: "Shqipëria ishte përgjegjëse për shpërthimin e minave në zonën e Kanalit të Korfuzit më 22 tetor 1946 dhe, për pasojë, edhe për dëmtimet dhe humbjet e jetëve të njerëzve". GjND konkludoi gjithashtu: "Kanali i Korfuzit është një ngushticë e tillë që përdoret për lundrim ndërkombëtar dhe se lundrimi i anijeve britanike më 22 tetor 1946 ishte paqësor" dhe me 14 vota pro

dhe 2 kundër, arriti në përfundim: "më 22 tetor 1946 Britania e Madhe nuk kishte shkelur sovranitetin e shtetit shqiptar" dhe së treti: "me 12 vota pro e 2 kundër, GjND vendosi se shuma e kompensimit që Shqipëria duhej t'i paguante Britanisë së Madhe për incidentin e 22 tetorit 1946 ishte 843 947 paund".

Disa fakte kokëfortë mbi ngjarjen: "5 versione të mundshme të minimit: se minat mund të ishin vendosur nga Gjermania? Shqipëria? Britania e Madhe? Greqia? Ose Jugosllavia?". Avokatët francezë Pjerr Kot dhe Xho Nordman u zhgënjyen nga bojkotimi shqiptar i procesit të tretë të Kanalit të Korfuzit, atë të vlerësimit të shumës që duhej t'i paguhej si dëmshpërblim palës britanike, duke dëmtuar kështu vetë interesat e shtetit shqiptar. Edhe pse Pjerr Kot është dekoruar pas vdekjes në vitin 1982 nga shteti shqiptar. Debati mbi mundësinë e rihapjes së çështjes së Incidentit të Kanalit të Korfuzit në GJND ekziston sepse në afërsi të bregdetit shqiptar janë gjetur disa mbetje të bashit të anijes "Volazh", të dëmtuar në incidentin e 22 tetorit 1946 dhe që u nxorrën nga fundi i detit në vitin 2010 nga një anije amerikane që bëri kërkime për objekte arkeologjike. Por në pikëpamje juridike në bazë të nenit 61 të Statutit të GJND-së, rishikimi i një vendimi mund të bëhet kur zbulohet një fakt i ri shumë i rëndësishëm për çështjen dhe që nuk njihej nga pala që pretendon, para dhënies së vendimit nga gjykata. Bazuar në pikavt 4 dhe 5 të këtij neni, kërkesa për rishikim duhet të paraqitet jo më vonë së gjashtë muaj pas zbulimit të faktit të ri, por në asnjë rast jo më vonë se pas 10 vjetëve nga dhënia e vendimit të gjykatës…".

Konkluzionet ishin të shkurtëra e të prera: "..u arrit të nxjerrin përfundime në fushën juridike të të Drejtës Ndërkombëtare nëpërmjet prezantimeve të lidhur ngushtë me historikun e zgjidhjes së konfliktit ndërkombtar duke luajtur role të palëve "gjyqëtarë", "palë angleze", "palë shqiptare". Rektori i AFA-së Kol. Dr. (në proc) Ruzhdi Kuçi bëri një përmbledhje të këtij aktiviteti mësimor si dhe falënderoi mikëpritësit duke ju dorëzuar edhe një çertifikatë mirënjohjeje për Rektorin e Filialit të Sarandës Prof. Dhonat Kule, që varet nga Fakulteti i Ekonomisë në Tiranë. Dhe sigurisht në fund të aktivitetit nuk do të mungonte edhe një foto e përbashkët të ushtarakëve student dhe studentëve të Sarandës bashkë me trupën pedagogjike të të dy institucioneve të arsimit të lartë.



Në himarë me kryetarin e Bashkisë

"Tokë e ndaluar" e bukurive, ku ngrihej baza e fuqishme ushtarake

Një ndalesë e shkurtër sipër "hotelit të kinezëve" pranë kalasë së Ali Pashë Tepelenës dhe kishës së Vasiliqisë. Këtu në këtë rrugë, për dy dekada rresht në këtë perlë të bukurive nuk mund të kalohej nga askush. Rruga ishte bllokuar dhe gjithë transporti civil i udhëtarëve dhe mallrave bëhej nga "Rruga e kapedanëve" të malit, pra nga Qeparoi në Kudhës, në Vumlo pranë Pilurit dhe prej andej rruga gjarpëronte e zbriste në Himarë. Zotër të saj ishin vetëm një grusht shqiptarësh dhe specialistësh kinezë që ndërtonin një ndër bunkerët më të kushtueshëm nënujor, një tunel për të cilin u punua dy dekada dhe nuk u përdor asnjë ditë. Në këto punime fortifikuese që përfshinin 54 objekte ndërtimore rreth 15 ushtarakë e specialist civilë humbën jetën në mënyrë të mistershme dhe kurrë nuk u publikuan, për arsye të ndërtimeve tepër sekrete të rëndësisë së veçantë. Por këtu çelësat e sekreteve të bukurisë qëndrojnë tek kalaja e vogël e vendosur në një pozicion mjaft të bukur në një gadishull në gjirin e vogël të Porto Palermos, që në antikitet njihej si "Gjiri i Panormës". Kalaja ndodhet jo larg fshatit Qeparo me formë trekëndore, me përmasat 150 m x 400 m. Lartësia e mureve arrin në 20 metra. Kalaja ndodhet mbi një ishull rreth 30 m larg bregut ku rripi i ngushtë ujor midis bregut dhe ishullit është mbushur me dhe e gurë për të realizuar një lidhje tokësore me të. Kalaja në formë trapezi është rrethuar me mure guri të pajisura me frëngji. Pjesa tjetër e kështjellës përbëhet nga një numër i madh ambientesh të mbuluara me qemerë të cilat përfundojnë në pjesën e sipërme me një tarracë të përbashkët. Ambientet shërbenin për strehimin e garnizonit, ndërsa njeri prej tyre shërbente si burg. Kalaja e Porto Palermos është një nga sarajet e shumta të Ali Pashë Tepelenës. Kështjella qëndron në mes të detit dhe legjendës. Ajo është ndërtuar nga Ali Pasha si një dhuratë për një nga gratë e tij, Vasiliqinë. Bukuria dhe madhështia e kësaj kështjelle ka zënë vend në shumë libra kushtuar Ali Pashës. Një ndër ta është Aleksandër Dyma, autori i Konti Monte Kristos.

Kalaja shumë interesantë për turistët e turizmin ka statusin "Monument Kulture". Kështjellu u ndërtua nën kujdesin e arkitektit Petro Përmetari dhe të një arkitekti Italian. Sapo kalon Qeparoin ose Himarën, përballesh me një panoramë të mrekullueshme të detit dhe në mes si një ishull i vogël duket vendi ku është ndërtuar kështjella e Porto Palermos. Ky emër i ka mbetur këtij gjiri nga koha e pushtimit të italianëve, të cilëve u kujtonte vendin e tyre, qytetin e Palermos në jug të Italisë. Kështjella ngrihet madhështore në ishullin e mbushur me një bimësi të ulët. Një rrugicë e ngushtë, ndërmjet kësaj bimësie të ulët nëpër gurë gëlqerorë, që të shpien në derën e dhuratës së Pashait të Madh për të shoqen. Dikur aty ka qenë një pllakë guri ku shkruhej: "Unë Pashai i Madh, Aliu e ndërtova këtë kështjellë..". Një vepër e pa përsëritëshme e histories…Në dhomat ku ka dritare drita e diellit të tregon perlat e kështjellës. Ashtu në errësirë me pak imagjinatë mund të hysh në botën antike të Ali Pashë Tepelenës dhe njerëzve të tij. Aty ndodhet dhoma e Vasiliqisë, të shoqes së Ali Pashës, dhoma e

vetë pashait por dhe dhomat e njerëzve të tij të afërm. Në krahun e majtë ndodhet dhoma ku një herë e një kohë gjendej pusi. Një burim me ujë të ëmbël ka ekzistuar kohë më parë në këtë kështjellë por tashmë ka mbetur vetëm forma e pusit ku janë thyer disa gurë. Nga ana tjetër, janë shkallët për tu ngjitur në bedena, nëpërmjet një rruge të ngushtë nga ku hyn ajri i pastër i detit. Pamja që shfaqet nga bedenat e kështjellës është e rrallë. Prej aty duket i gjithë bregdeti si dhe Gjiri i nuseve, në të cilin, sipas legjendës, lahej vetëm nusja e Ali Pashës, Vasiliqia. Aty ndodheshin topat luftarakë të Ali Pashë Tepelenës si dhe vendet ku qendronin ushtarët. Bedenat bien menjëherë mbi det, si thikë, dhe legjenda thotë se aty përfundonin armiqtë e Pashait të Madh. Dhjetëra burra trima që kishin guxuar të sfidonin Ali Pashë Tepelenën kanë përfunduar në det ose janë përplasur në shkëmbinjtë që ndodhen poshtë bedenave. Forma e tyre tregon se ka qënë shumë e vështirë për ti pushtuar nga ana e detit. Përballë kalasë një kishëz e vogël si një dhuratë vetëm për të shoqen e Pashait, Vasiliqinë, sipas legjendës e ngritur për një ditë buzë detit dhe e provuar për qëndresë me një të shtënë topi, ku gjylja e saj duket edhe sot në murin e përparmë të kishës si dëshmi e kohës që godinat provoheshin duke i gjuajtur me top, por me një kusht që brenda saj të ishin arkitektët. Pas provës mund të merrnin ose qesen me flori ose me ndëshkim.

Akademistët - mysafirë në Bashkinë e Himarës

Takim i ushtarakëve me përfaqësues të pushtetit vendor është një ndër kërkesat kryesore programore të Departamentit të Lidershipit në FSM në AFA. Për këtë arsye Akademistët e AFA-së bashkë me Kryetarin e Bashkisë Gjergj Goro, zv/kryetarin Irakli Gjiçari drejtues të FSM-së dhe Departamentit të Lidershipit të drejtuar me kopetencë nga colonel Prof. As. Agim Sula, ishin në një bashkëbisedim të hapur në "auditorin" me pisha, në bulevardin e ri të Himarës.Thonë se rasti është mbreti i botës. Pse? Kryetari që na priti është një ish-ushtarak i sukseshëm, që kishte shërbyer me dinjitet në radhët e ushtarakëve aktivë të FA-së në ish Shkollën e e mesme ushtarake "Skënderbej". Sot po kaq i sukseshëm është edhe në fushën e drejtimit dhe organizimit të pushtetit vendor dhe pikërisht në brigjet e Himarës së bukur, ku deti takohet me fushën e me mallet, ku njerëzit i "pjek" vapa dhe i "djeg" dielli, i freskon mali dhe ku kënga e valëve piluriote takohet me valët e detit të Joint, me malet e Vetëtimës/Agrekerauneve, me valët që rrahin brigjet e thepisura e shkëmbore dhe që kanë se çfarë të tregojnë në histori. Kryetari Gjergj Goro dhe zv/kryetari Irakli Gjiçari erdhën në një takim të hapur me të gjithë kursantët dhe drejtuesit më të lartë në Fakultet dhe Departamentin e Lidershipit dhe shkencës shoqërore. Mikpritësi himariot zoti Goro foli shtruar dhe qetë në shetitoren e re "tek klubi i Bebit", ndër klubet më të vjetra gati një shekullor të Himarës aty ku për ish-Mbretin Zog I u shtruan çiltetë për të biseduar me popullin rebel të Himarës dhe për t'u ofruar dashuri dhe mbështetje edhe me një "grusht flori të derdhur atje buzë detit në një ditë pranverore në fillim të viteve '30-të. Zoti Goro u shpreh për Himarësn se, "Himara ka shtatë fshatra: Palasa, Dhërmiu ose "Dhëri im", nga shqipja e vjeter; Vuno/"Vëne", Qeparo/"Që parë", Kudhës /"Kudhra", Pilur/"Pi Ujë Ulur"), dhe Ilias/Ilia/Ilir". Por sot me organizimin e ri territorial Himara ka njësitë administrative: Himarë, Lukovë dhe Horë-Vranisht. Bazuar në Censusin e vitit 2011 Himara ka 7818 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 27,049 banorë. Me sipërfaqe prej 571.94 km2, densiteti i popullsisë në bazë të censusit rezulton vetëm 13.7 banorë/ km2 ndërsa sipas regjistrit civil, densiteti është 47 banorë/km2. Himara si krahinë shtrihet në jugperëndim të Shqipërisë në anë të bregdetit të detit Jon, ku ka rreth 600 km2 me popullsi rreth 30 mijë vetë; ka një vijë bregdetare rreth 100 km, ku 30 km janë të përshtatshme për plazhe. Himara është vend kodrinor dhe malor dhe karakterizohet nga male e kodrina që thepisën drejtpërdrejt në një det të kristaltë, dhe është një vend detar me klimë mesdhetare.

Himara është një qytet me kështjellë. Qyteti i vjetër i Himarës, dhe kalaja në vetvete janë monumente të rëndësishme që kanë nevojë për mbrojtje që të mos pësojnë dëme të pandreqshme. Në kështjellë ekzistojnë shenja të pranisë së pandërprerë të banorëve vendorë Iliro-Shqiptarë për më shumë se 3500 vjet. Kursantët e KKSHP-së e vendosën kryetarin e Bashkisë përballë një rrebeshi pyetjesh që lidheshin me Himarën plazhet, turizmin, perspektivën, investimet etj. Por kryetar Gjergji i kishte përgjigjet gjithmonë të gatshme: "Himara shquhet për plazhet e saj shumë të bukur, shumica me zalle por edhe me rërë te bardhë e të imët. Spilea, është plazhi qëndror i Himarës, me shumë vizitore në verë, më tutje janë Prino, Potami, Filikuri, më në Jug Llamani, Qeparoi, Borshi, brigjet e Piqerasit/Buneci, Sasaj, Lukova, Shuvasia, Nivica, Kakomea. Poshtë kalasë së Himarës ndodhet Livadhi dhe në veri Jali, Gjipea, Karkaniqi, Dhërmiu, Palasa, Dhralea, Rrugët e Bardha, Grama.. Në shumë vende në brigjet e Himarës, uji është shumë i ftohtë, për shkak të ujërave nëntokësore. Po të largohesh disa dhjetra metra nga këto pika temperatura e detit merr vlerat fiziologjike. Në muajt e verës, afrohen barkat e shpejta për të bërë shëtitje në brigjet që ndodhen afër me Spilenë. Investimet janë kryefjala e ditës, edhe bulevardi i ri i rilindjes urbane, edhe investimet e shumta janë perspektivë e madhe e krejt zonës bregdetare...".


Kalaja e Ali Pashë Tepelenës
në Porto Palermo

Grupi i akademistëve të KKSHP-së si dhe pedagogët e tyre u larguan nga Himara për tu "takuar" në aktivitete të tjera, ndoshta më të rritur e më të lartësuar, pse jo edhe të graduar një shkallë më të lartë të karrierës për t'u rikthyer në auditoret e Akademisë në kursin e radhës drejt gradës së radhës atë të "kolonelit". Kursantët/Akademistët do të vijojnë të përballen me sfidat për të qenë nesër të gatshëm për të shërbyer brenda dhe jashtë vendit në strukturat në NATO, në themelin e sigurisë Euroatlantike.

Ilirët dhe Thrakët dy popujt e lashtë të Ballkanit



MSC. ALBERT HABAZAJ
Biblioteka "Nermin Vlora Falaschi",
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë

Ballkani ka qenë një nyje ku kontaktonin etnitë e vjetra autoktone, modeli latin perandorak, destinacionin e një fluksi masiv të sllavëve paganë, një zonë ku takoheshin ortodoksët dhe katolikët, si edhe pika e takimit mes Islamit dhe Krishtërimit. Qytetërimi ballkanik u zhvillua si një amalgamë e çuditshme e së vjetrës me të renë, pasi katër qytetërimet e mëdha e tronditëse, treguan paaftësi mbizotërimi në gadishull e rajon si kulturë e qytetërim në Europën JL.

Në periudhën arkaike dhe antikitetit, rajoni i Ballkanit të Jugut, ishte shtëpia e përbashkët për Ilirët, Thrakët, Grekët, Epiriotët, etj. Popujt që u bënë më të njohur në historinë e lashtë të Ballkanit, përveç Helenëve, ishin dhe Thrakët e Ilirët. Po të kthehemi në tejlashtësi, Ilirët dhe Thrakasit, nuk bënin përjashtim nga civilizimet e vjetra të Mesdheut qyterimformues (Hamendësimet romantike të pasionantëve na i shpien rrënjët tona në Pellazgjì si farë të Pellazgut Yjnor, por opinioni shkencor ende nuk është shprehur).

Thrakët dhe Ilirët

Në një kontakt të gjatë mes tyre, thrakët dhe ilirët, si dy vëllezër binjakë, me një gjuhë të njëjtë indoeuropiane, por dialekte te ndryshme, i kanë dhënë Ballkanit kulturë materiale dhe jomateriale (shpirtërore) të vetën, me shumë elementë të përbashkët kulturorë, kultik e gjuhësor. Kultura Ézero (e thrakëve) në Bullgarinë Jugore dhe kultura e Devollit (ilire) në Shqipërinë Juglindore, janë një dëshmi e procesit të ngjizjes etnike të këtyre dy popujve të lashtë, bartës të individualitetit dhe vlerave të përbashkëta, me veçoritë etnopërbashkuese dhe etnopërveçuese. Duke lexuar shkrimet e gjeografit të antikitetit, Strabonit, vërehet se ai e ka të vështirë diferencimin midis fiseve ilire, thrake dhe epirote. Kështu ai, fiset paione i konsideronte në atë kohë, herë si ilirë, herë si thrakë, herë si epiriotë.

Thrakët e lashtë ishin një grup i fiseve indoeuropiane, të cilët flisnin gjuhën thrake. Këta shtriheshin në pjesën lindore, qendrore dhe jugore të Gadishullit Ballkanik. Ata përhapeshin në jug deri në Thesalinë greke, dhe ishin të përzier me fiset maqedone, siç pohon Straboni kur thotë, se matanë maleve të Pindit në Maqedoni jetonin dhe epirotë dhe "malësorë thrakë".

Cili është opinioni shkencor?

Është pohuar se Thrakasit janë të një gjaku e të një gjuhe me Ilirët dhe e adhuronin Diellin. Ribezzo, Mustilli etj, kanë nxjerrë prova të shumta për të vërtetuar se Thrakas e Ilirë, në kohën romake, kanë banuar në territore përbri njëri - tjetrit, se "kanë folur një gjuhë të vetme" (Ribezzo, Francesco: "Premesse storico-linguistiche sull' autoctonia ilirica degli Albanesi": Rivista d'Albania, Viti 1940, f. 139-140), se "Thrakët edhe Ilirët përfaqësojnë dy emra të një ethnosi të vetëm të ndarë dysh vetëm politikisht dhe gjeografikisht" (Mustilli: "L'iliriccità del popolo Albanese", Rivista d'Albania, Viti 1942, f. 31).

Vladimir I. Georgiev (linguist bullgar) e fut gjuhën ilire dhe shqipen në relacion të ngushtë me thrakishten. Çabej besonte se thrakishtja dhe ilirishtja ishin të ngjashme në strukturë dhe leksik.

Arshi Pipa thotë se në Toskëri kishte më shumë komponente thrakase, ndërsa Gegëria ishte kryesisht ilire. Herodoti dhe historianë të tjerë të lashtë, tregonin se Ilirët dhe Thrakët pa dallim, bënin tatuazhe në trup, flijonin njerëz për nder të perëndive, gruaja luante rol në shoqërinë fisnore patriarkale, në ndryshim nga helenët ku gruaja shihej si robinë. Gjithashtu dhe mitologjia e tyre përputhet në disa aspekte. Kështu Sabazi ka qënë perëndi thrake, gjithashtu dhe ilire. Bindi po ashtu. Në shqip, emri i Bindit vazhdon të kujtohet në fjalën "përbindësh".

Ndër popujt e parë paleoballkanas, Thrakët dhe Ilirët kanë qenë shumë të afërt me njëri - tjetrin dhe një ndarje e prerë midis tyre ka qenë e vështirë për studiuesit e lashtë dhe të sotëm. "Barinjtë shqiptarë, njësoj si barinjtë e famshëm vllehë, përmenden nga gjysma e shek. XIII" (Milaj, Jakov, "Raca shqiptare- studim anthropologjik e historik", bot. 2, Tiranë, Eurorilondja, 1995, f. 69). Sot aktualisht ruhen shumë fjalë thrake në dialektin tosk. Antropologjikisht, me një krahasim më lokal, Shqiptarët dhe Bullgarët ngjajnë, si brenda nesh, Gegët e Toskët,

banorët e dy grupeve më të mëdha të krahinave etnografike të popullit shqiptar. E theksojmë këtë, sepse nga pikëpamja historike - etnografike, vetëm një nëndarje e madhe njihet në gji të popullit shqiptar: Veriu i Shqipërisë, që quhet "Gegni" ose "Gegëri" dhe Jugu i saj që quhet "Toskni" ose "Toskëri", si dy grupe të mëdha krahinash etnografike shqiptare (Zojzi, Rrok, "Etnografia shqiptare, I", Tiranë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Sektori i Etnografisë, 1962, f. 19, 21, 47, 62). Thrakët dhe Ilirët janë dy margaritarë të çmuar në mozaikun ylberor shumëngjyrësh të kulturave në gadishullin (ujdhesën) e quajtur Ballkan. Qytetërimet tona nuk e kanë ulur kurrizin, se nuk kanë patur popuj të mundur. Në kontekst, duke mos e harruar historinë dhe me vështrim përpara, vlen ta flakim mosnjohjen, shpërfilljen, përbuzjen, urrejtjen e tjetrit dhe të përparojmë duke u përmirësuar në sakrifica, "rrezatim, grumbullim të mirash kulturore, trashëgimi inteligjence"(Braudel, Fernand, "Mesdheu, hapësira, historia, njerëzit dhe traditat", Tiranë, Botimet IDK, f. 98).

Thrakët dhe Ilirët dhe, në vijim, Bullgarët e Shqiptarët janë të mbrujtur me gurra historike, siç pohojnë dhe shumë studime të historianit të madh francez Frenand Braudel (1902-1985), ndër më kryesorët dhe në mbarë botën gjatë shek. XX. Bullgaria dhe Shqipëria përbëjnë një afresk të shkëlqyer në këtë djep qytetërimesh të mëdha, siç është Ballkani ynë, ku për shekuj me radhë historia e njerëzimit ka shkruajtur disa nga faqet e saj më emocionuese. Popullsia autoktone ilire dhe trake e këtyre krahinave me kalimin e kohës u asimilua nga bota sllave (vitet '80 të shek. VI-mes shekullin VII). Vëllezërit Kirili dhe Metodi për ta janë si dy korifej, sepse hartuan Fjalorin e parë të sllavishtes. Gjuhët sllave "u bënë gjuhë ballkanike, Ilirishtja dhe trakishtja edhe pse u zhdukën në këto vise, kanë lënë gjurmët e tyre me anë të emrave tipikë të burimit ilir e trak… "(Murzaku, Thoma; Mullai, Abaz; "Historia e Ballkanit - nga antikiteti i vonë deri në shek. XVII", Tiranë, SHBLU, 2002, f. 55). Qëndrimi i Bullgarëve në Shqipëri prej shek. VII-X, që jetuan në paqe, por edhe në shek. XI, XII, XIII ka lënë shumë fjalë në gjuhë e sidomos shumë emra në toponomastikë. Në territoret shqiptare, qysh nga fundi i shek. X regjistrohen edhe toponime, emërtime të vendeve, fshatrave etj. me origjinë bullgare.

Rrjedhave të kohës

Ballkani multietnik, ky gadishull i mbushur edhe me tragjedi njerëzore, jo rrallë herë ka qenë i paragjykuar pikërisht nga europianët, që e pagëzuan me këtë emër (shtysa nga malet Ballkan në Bullgari?!). "Shtetet bymeheshin e tkurreshin, dhe popullsitë e tyre bëheshin, zyrtarisht të paktën, nënshtetas të një sundimtari të ndryshëm nga i mëparshmi"(Wachtel, Andrew Baruch; "Ballkani në historinë botërore" Tiranë, Toena, 2012, f. 54).

Ka qarkulluar një shprehje këto shekujt e fundit: "Ballkani është fuçi baroti", e cila nuk duhet të trashëgohet brezave që vijnë. Për këtë çdo qytetar i Ballkanit duhet të punojë, të kontribuojë, që Ballkani të mos jetë fuçi zjarri, por një vazo me lule të bukura në kopështin e botës njerëzore. Të mos jetë Ballkani një fuçi baroti, por një pikël e kaltër n ë g l o b.



Të mos ketë Ballkani njerëz që e urrejnë njëri tjetrin, por të ketë burra me dinjitet, zonja aristokrate, dhëndurrë hyjnorë e nuse bregdeti. Për këtë synim human e altruist, në traditat më të mira të të parëve tanë, mbështetur në Etnologjinë dhe Folkorin e dy popujve tanë, me afritë në jetën ekonomike (me ushqimet, mënyrën e të ushqyerit, traditat bujqësore e blegtorare, veshjet popullore, banesat tradicionale e artin e të ndërtuarit), në kulturën shoqërore e shpirtërore (me familjen, lidhjet e afërisë së gjakut, farefisin, të drejtën dokesore, migrimet e formimet e diasporave, mitet, ritet e besimet popullore) me artet popullore të aplikuara dhe me thesaret e folklorit, si krijimtari artistike specifike, bullgarët dhe shqiptarët mund ta japin fisnikërisht kontributin e tyre qytetar, që mozaiku ylberor i kulturave të këtij qytetërimi të pasur, të feks bukurisht në qiellin e ballkanasve me emër. Cilësojmë se, mbi këtë lidhje të lashtë nëpër mijëravjeçarë e shekuj dhe në rrjedhat bashkëkohore, sot, shqiptarët e bullgarët kanë ura të forta komunikimi.

Hristo Botev është poeti kombëtar i Bullgarisë, sjellë në shqip nga i madhi Fatos Arapi dhe shumë i pëlqyer nga letrësidashësit shqiptarë dhe nga gjithë liridashësit me dinjitet.

Letërsia e Elin Pelinit është e ngrohtë, e dashur, e pëlqyeshme edhe nga shqiptarët, sepse është letërsi e vërtetë dhe në shërbim të edukimit estetik e arrtistik të të gjithë njerëzve, jo vetëm Bullgarëve.

Bullgarët e shqiptarët kanë karakteristikat e tyre e tashmë dallohen nga gjuha, por veshjet, poezinë popullore, muzikën, instrumentet, vallëzimin popullore e kanë burimor, të bukur, brilant. Bartësit, interpretuesit dhe përhapësit e folklorit janë konsujt vullnetarë të dashurisë mes popujve tanë.

Edhe pse "është tjetër gjë lashtësia e një populli dhe tjetër niveli kulturor që ai arrin në një periudhë të caktuar historike të tij" (Korkuti, Myzafer, "Parailirët, Ilirët, Arbërit, histori e shkurtër", Tiranë, Toena, 2003, f. 54.), sqaron prof, Korkuti dhe, se patjetër "të gjithë duan të dinë kush ishin stërgjyshërit e shqiptarëve, ç'lidhje kishin me arbërit, me ilirët dhe më lashtë me parailirët (pellazgët?)" (Korkuti, Myzafer, "Parailirët…", vep. e cit. f.9). Po kështu gjykojmë për banorët e sotëm të krahinave që trajtuam, se për çështje madhore për historinë e shqiptarëve dhe bullgarëve, siç është etnogjeneza e tyre, duhet të sinkronizohen me atë të banorëve të tjerë të Europës JL.

Kultura paleoballkanike thrake dhe ilire, jo vetëm për thrakologët dhe ilirologët, mendojmë se duhet të jetë objekt studimi me gjuhët përkatëse, letërsinë, historinë, fenë, artin, ekonominë dhe etikën, sepse udhën e kanë çelur Wilhelm Tomaschek etj. në fund të shekullit të 19-të për thrakologjinë apo Hahn, S. Frashëri, Jokli, Çabej, Hasan Ceka, Frano Prendi, Skënder Anamali, Jakov Milaj, Buda, A. Stipceviq etj. për ilirinë.

Vlorë, 7 Mars 2017
Mbajtur në Universitetin "Islmail Qemali", konferenca me rastin e 139 vjetorit të Pavarësisë së Bullgarisë

FORCA AJRORE



Forcat e Armatosura të Shqipërisë kremtojnë 66 vjetorin e themelimit të Aviacionit luftarak, premisat e të cilit u ngjizën më 1914